



**SHËRBIM KONSULENCE,
PËR HARTIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME
VENDORE,
PËR KATËR BASHKI, VLORË, SARANDË,
HIMARË, KONISPOL**

Vlerësimi Strategjik Mjedisor
(Raporti Paraprak)

HIMARË

Data: ... Nëntor 2016

(DRAFT COPY)

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	7
1.1 Qëllimi i Raportit te VSM	7
1.2 Autoritetet Përgjegjëse	9
1.3 Ekipi Konsulent	9
1.4 Përshkrim i përgjithshëm i përmbajtjes së Planit	9
1.5 Metodologjia, baza ligjore dhe përmbajtja e Raportit Mjedisor të VSM	11
2. ANALIZA E KUSHTEVE TË SOTME KRYESORE MJEDISORE	15
2.1 Sistemi Urban	15
2.1.1 Demografia dhe Shpërndarja Hapësinore e Popullsisë	15
2.1.2 Ekonomia dhe punësimi	17
2.1.3 Perdorimi i tokes	20
2.2 Zonat e mbrojtura arkeologjike	30
2.2.1 Qendra Historike dhe Trashëgimia kulturore në Himarë	33
2.2.2 Trashëgimia kulturore në njësite administrative përbërëse	35
2.3 Sistemi ujor	39
2.3.1 Trupat ujore dhe deti	55;
2.3.2 Lumenjtë dhe përrenjtë	64
2.3.3 Mjedisi detar	67
2.4 Sistem natyror	47
2.4.1 Biodiversiteti, Fauna & Flora, Pyjet dhe Natyra	47
2.4.2 Pyjet dhe natyra	49
2.4.3 Zonat e mbrojtura	51
2.4.4 Klima dhe cilësia e Ajrit	56
2.5 Sistemi bujqësor	61
2.5.1 Boniteti i tokës	61
2.5.2 Ekonomia bujqësore	64
2.6 Sistemi infrastrukturor	65
2.6.1 Menaxhimi i mbetjeve dhe infrastruktura mjedisore	65
2.6.2 Aksesit dhe rrjeti i transportit	67
2.6.3 Rrjeti Infrastrukturor rrugor	71
2.6.4 Energjia dhe Telekomunikacioni	75
3. OBJEKTIVAT KOMBETARE DHE NDERKOMBETARE PER NJE ZHVILLIM TE QENDRUESHEM - PERFSHIRJA E OBJEKTIVAVE NE PLAN	78
3.1 Hyrja	78
3.2 Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar	79
3.2.1 Objektivat kombëtare të mjedisit	79
3.2.2 Objektivat kombëtare të planifikimit të territorit (Ligji 107/2014)	93
3.3 Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar	97
3.1.1 Politikat ndërkombëtare	97
3.4 Përmbledhje e objektivave	109
3.5 Objektivat e veçanta të VSM-se	112
4. SKENARËT / ZGJIDHJET ALTERNATIVE	119
4.1 Hyrje - Metodologjia	119
4.2 Vleresimi i Skenareve	121
Skenari 1: Skenari zero	121

<u>Skenari 2: Tërheqja e investimeve të jashtme nëpërmjet zhvillimit të ndërtimit rezidencial</u>	126
<u>Skenari 3: Zhvillimi i një forme te zbutur te turizmit masiv.....</u>	131
<u>Skenari 4: Zhvillimi i zonës si një destinacion turistik kulturor dhe natyror ..</u>	136
4.3 Performanca e përgjithshme e skenarë alternative	141
4.4 Skenari i Zgjedhur: Drejt formulimit të Turizmit të Qëndrueshëm.....	141
5. VLERESIMI DETAJUAR MJEDISOR I PLAN IT LOKAL DHE EFEKTET S HENDETESORE – PARANDALIMI D HE MASAT ZBUTESE	144
5.1 Metoda e realizimit te vleresimit	144
5.2 Vlerësim i detajuar i Planit të Përgjithshëm Vendor të Himares.....	000036; "
6. VLERËSIMI I P ËRGJITHSHËMI SIS TEMIT TË PLAN MONITORIMIT	195
6.1 Vlerësim i përgjithshëm	195
6.2 Sistemi i monitorimit.....	196
6.2.1 Normat për parametrat e ujit të pijshëm	197
6.2.2 Monitorimi i ujit të detit	000.. 199
6.2.3 Cilësia e ajrit dhe standardet.....	000. 199
6.2.4 Ndotja akustike	201
6.2.5 Synimet për mbetjet.....	201
6.2.6 Ujërat e ndotura	203
6.2.7 Monitorimi i pyjeve, hapësirave të gjelbra dhe të mbrojtura	204
6.2.8 Guroret dhe industria e vajit	204
6.2.9 Monitorimi i tokës bujqësore.....	205
6.3 Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Himares	206
7. STUDIMET REFERUESE KRYESORE.....	217
8. VËSHITËSITË E HASURA.....	218
9. PERMBLEDHJA JOTEKNIKE	220
9.1 Hyrje	220
9.2 Konteksti i Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit.....	220
9.3 Sfidat kryesore mjedisore te zones se studimit.....	221
9.4 Objektivat e vecanta te VSM-se	221
9.5 Skenarët Alternative	222
9.6 Vlerësimi i Planit Vendor	222
9.7 Masat zbutëse Mjedisore	222
9.8 Monitorimi.....	223
9.9 Konkluzioni i Raportit	223
10. BIBLIOGRAFIA.....	224

TABELA E HARTAVE

Harta 1: Pëdorimi ekzistues i tokës	25
Harta 2: Harta hidrogeologjike	36
Harta 3: Harta hidrografike.....	38
Harta 4: Harta e burimeve natyrore	40
Harta 5: Harta e zonës RAMSAR Butrint sipas VKM 134.....	42
Harta 6: Harta Gjeologjike-inxhinierike e zones së studimit	47
Harta 7: Harta e rrezikut gjeologjik Konispol	49

<u>Harta 8: Harta e bonitetit të tokës Konispol</u>	56
<u>Harta 9: Harta e furnizimit me ujë të pijshëm</u>	61
<u>Harta 10: Rrjeti KUZ</u>	65

TABELA E FIGURAVE

<u>Fig. 1: Analizë e nivelit Makro të territorit të Konispolit</u>	22
<u>Fig. 2: Sistemi i ujitjes në luginën e Vrinës dhe kufijtë e mbrojtura të parkut arkeologjik</u>	23
<u>Fig. 3: Kanali ujitës që ndan sistemin e ujit të detit nga ujërat e ëmbël</u>	23
<u>Fig. 4: Kultivimet me pemë frutore dhe Kullota kafshësh</u>	23
<u>Fig. 5: Lugina e Konispolit</u>	26
<u>Fig. 6: Kalivo</u>	29
<u>Fig. 7: Qendra dhe Pazari i Konispolit</u>	29
<u>Fig. 8: Shpella e Kreshmoit nga jashtë; Shpella e Kreshmoit nga Brenda</u>	30
<u>Fig. 9: Foto e fillimshekullit të XX: rrapi dhe pazari</u>	31
<u>Fig. 10: Harta skematike e trashëgimisë së Konispolit</u>	31
<u>Fig. 11: Gurorja, Shkallë, Xarrë</u>	32
<u>Fig. 12: Harta skematike e trashëgimisë së Konispolit</u>	33
<u>Fig. 13: Kalaja e Malathresë, Mursi, Xarrë</u>	34
<u>Fig. 14: Pamje e përgjithshme e banesës tipike Monumentet, 1985</u>	35
<u>Fig. 15: Vendodhja e disa prej trupave ujore të Konispolit</u>	37
<u>Fig. 16: Shpella e Konispolit dhe Kanali i Vivarit</u>	43
<u>Fig. 17: Skema tektonike e zonës në studim dhe e Shqipërisë</u>	45
<u>Fig. 18: Harta Gjeotermale dhe e izoseisteve të tërmeteve të Bashkisë Konispol dhe më gjerë</u>	46
<u>Fig. 19: Epiqendrat e tërmeteve dhe; harta e zonave sizmogene me potencial sizmik të pritshëm</u>	48
<u>Fig. 20: Rreziku sizmik për bashkinë Konispol dhe më gjerë</u>	49
<u>Fig. 21: Harta me zonat dhe nënzonat klimatike e Shqipërisë</u>	50
<u>Fig. 22: Shpërndarja territoriale e sasisë vjetore të orëve me erë; dhe Harta territoriale e orëve me diell në territorin e zonës në studim</u>	51
<u>Fig. 23: Hartat e shpërndarjes vjetore të reshjeve dhe rajonizimi i Shqipërisë sipas rreshjeve</u>	52
<u>Fig. 24: Harta e kategorive të tokave në bashkinë Konispol dhe më gjerë</u>	57
<u>Fig. 25: Planimetria e Pergjithshme e Ujesjellesit Konispol</u>	62
<u>Fig. 26: Rikonstruksioni i Kanalit Vadites, zonat te ujitjes</u>	63
<u>Fig. 27: Vendndodhja e aeroportit të Sarandës</u>	66
<u>Fig. 28: Zonat e mundshme për zhvillimin e një aeroporti civil në Sarandë, Instituti i Studimeve te Transportit</u>	67
<u>Fig. 29: Varesia ndërmjet mënyrës së preferuar për të udhëtuar dhe distancës së udhëtimit</u>	67
<u>Fig. 30: Vendndodhja e aeroportit të Vlorës</u>	68
<u>Fig. 31: Rrjeti Rrugor Markat dhe Konispol</u>	69
<u>Fig. 32: Rrjeti Rrugor i Luginës së Vrinës</u>	70
<u>Fig. 33: Vizioni për zhvillimin e shëtitores buzë liqenit të Mursit</u>	127
<u>Fig. 34: Vizioni i rikualifikimit të qendrës historike të Konispolit</u>	128
<u>Fig. 35: Vizioni i rikualifikimit dhe konsolidimit të qendrës së Markatit</u>	129
<u>Fig. 36: Harta e vizionit strategjik të zhvillimit të territorit</u>	130

TABELAT

Tabela 1: Popullsia rezidente në Bashkinë e re Konispol për vitet 1989,2001,2011 .	14
Tabela 2: Struktura e popullsisë së Bashkisë Konispol sipas gjinisë, 2011	15
Tabela 3: Dendësiteti i popullsisë Bashkia Konispol	16
Tabela 4: Ndërmarrjet aktive në njësitë administrative të Bashkisë Konispol, 2013,2014	17
Tabela 5: Ndërmarrjet aktive në Konispol sipas aktivitetit ekonomik, 2014.....	18
Tabela 6: Ndërmarrjet aktive sipas formës ligjore, Bashkia Konispol.....	19
Tabela 7: Shpërndarja e të punësuarve sipas sektorve prodhues, Bashkia Konispol ..	19
Tabela 8: Niveli i papunësisë në total dhe për të rinjtë Bashkia Konispol.....	20
Tabela 9: Shpërndarja e të papunëve sipas gjinisë në Bashkinë Konispol.....	21
Tabela 10: Lista e monumenteve të natyrës dhe e zonave të mbrojtura në Bashkinë Konispol	43
Tabela 11: Sipërfaqja e tokës pyjore dhe kullotave.....	44
Tabela 12: Temperaturat në Bashkinë Konispol (°C)	52
Tabela 13: Numri i familjeve fermerët në Bashkinë Konispol.....	59
Tabela 14: Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm - Njësia administrative Xarrë	62
Tabela 15: Radio-Antenat dhe Operatorët Celularë	71
Tabela 16: Sfidat kryesore mjedisore dhe Objektivat e VSM.....	72
Tabela 17: Përmbledhje e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar	77
Tabela 18: Përmbledhje e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të vendosura në nivel Evropian	83
Tabela 19: Masat përparësore për mbrojtjen e Biodiversitetit	86
Tabela 20: Objektivat paraprake të strategjisë së burimeve ujore.....	87
Tabela 21: Objektivat për Mbrojtjen e Tokës.....	89
Tabela 22: Cilësia e Ajrit.....	92
Tabela 23: Nivelet normale Kombëtare të elementeve të cilësisë së ajrit.....	93
Tabela 24: Ndryshimi i Klimës	95
Tabela 25: Objektivat Kombëtare në Menaxhimin e Mbeturinave	97
Tabela 26: Objektivat për ndotjen akustike	98
Tabela 27: Planifikimi i Territorit	99
Tabela 28: Përmbledhja e objektivave të Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin (PINS) është si më poshtë:.....	102
Tabela 29: Lidhja e Objektivave të VSM me objektivat ndërkombëtare dhe ato kombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm si dhe kërkesave të legjislacionit të VSM-së	103
Tabela 30: Përshkrimi i Objektivave të VSM-së.....	106

TABELAT E VLERËSIMIT

Tabela 31: Vlerësimi i Skenarit 1: Skenari egzistues (zero)	113
Tabela 32: Vlerësimi i Skenarit 2: Zhvillimi i sektorit bujqësor.....	117
Tabela 33: Vlerësimi i Skenarit 3: Përmirësimi i cilësisë së prodhimeve dhe promovimi i turizmit të veçantë	120

<u>Tabela 34: Vlerësim krahasues i skenarëve alternativë</u>	123
<u>Tabela 35: Tabela tip e vlerësimit të komponentëve të PPV</u>	135
<u>Tabela 36: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Vendor të Konispolit / Komponenti 1: OS1OB1</u>	137
<u>Tabela 37: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Vendor të Konispolit / Komponenti 2: OS1OB2</u>	140
<u>Tabela 38: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Vendor të Konispolit / Komponenti 3: OS1OB3</u>	143
<u>Tabela 39: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Vendor të Konispolit / Komponenti 4: OS2OB1</u>	146
<u>Tabela 40: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Vendor të Konispolit / Komponenti 5 Zhvillimi i infrastrukturës dhe identitetit turistike të Murrsit, Konispolit dhe Markatit: OS2OB1</u>	149
<u>Tabela 41: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Vendor të Konispolit / Komponenti 5 Zhvillimi i infrastrukturës dhe identitetit turistike të Murrsit, Konispolit dhe Markatit: OS2OB1</u>	153
<u>Tabela 42: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Vendor të Konispolit / Komponenti 5 Zhvillimi i infrastrukturës dhe identitetit turistike të Murrsit, Konispolit dhe Markatit: OS2OB1</u>	156
<u>Tabela 43: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Vendor të Konispolit / Komponenti 6: OS2OB2</u>	159
<u>Tabela 44: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Vendor të Konispolit / Komponenti 7: OS2OB3</u>	162
<u>Tabela 45: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Vendor të Konispolit / Komponenti 8: OS3OB1</u>	165
<u>Tabela 46: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Vendor të Konispolit / Komponenti 9: OS3OB2</u>	168
<u>Tabela 47: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Vendor të Konispolit / Komponenti 10: OS3OB3</u>	171

TABELAT E MONITORIMIT

<u>M.1: Treguesit fiziko-kimike të ujit të pijshëm të Bashkisë Konispol dhe Objektivat</u>	176
<u>M.2: Treguesit mikrobiologjike të ujit të pijshëm të Bashkisë Konispol (burimi ISHP) dhe objektiva</u>	177
<u>M.3: Kërkesat Cilësore të ujërave të plazheve në përputhje me BE</u>	177
<u>M.4: Vlerat e kufi të ndotësve (burimi ISHP)</u>	178
<u>M.5: Niveli i kufi i ndotësve të ajrit për tu monitoruar në Bashkinë Konispol</u>	178
<u>M.6: Objektivat për reduktimi e mbetjeve</u>	181
<u>M.7: Reduktimi i objektivave te ndotjes se ujit</u>	182
<u>M.8: Monitorimi i pyjeve dhe zonave te mbrojtura dhe te gjelbra</u>	182
<u>M.9: Monitorimi i guroreve dhe rehabilitimi</u>	183
<u>M.10: Monitorimi i tokës bujqësore</u>	184
<u>M.11: Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Konispolit</u>	185

SHPJEGUESIT E TERMAVE

AKPT (NATP)	Agjencia Kombëtare e Planifikimit te Territorit
BE	Bashkimi Evropian
BSAP	Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin
CRD	Qendra për Kërkim dhe Zhvillim (Tirane, Shqipëri)
EIMS	Sistemit Të Menaxhimit Te Informacionit Mjedisor
GIS	Sistemi Gjeografik i Informacionit
GoA	Qeveria e Shqipërisë
KE	Këshilli i Evropës
KKE	Komisioni i Këshillit te Evropës
ME	Mjedisi Evropian
INSTAT	Instituti i Statistikës- Republika e Shqipërisë
MPËTT	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
NGO	Organizata Jo-Qeveritare
NGPTP	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Planifikimit te Territorit
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
PMP	Plan ii Menaxhimit te Pyjeve
PVM	Plani Veprimit Mesdhetar
PMZIB (ICZMP)	Projekti i Menaxhimit te Zonës se Integruar te Bregdetit
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor (i Bashkisë Konispol)
PZHB	Plani i zhvillimit te bregdetit jugor
SBZHQ	Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm
SMM	Statusi i Mjedisit te Mire
SNT	Studimi i Ndikimit te Trafikut
SKM (NES)	Strategjia Kombëtare Mjedisore
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SKZHT	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit
SËOT	Pikat e Forta, Pikat e Dobëta, Mundësitë dhe Rreziqet
ToR	Termet e Referencës
TPA	Thymio Papayannis & Associates (Athens, Greece)
USAID	Ndihma e Shteteve te Bashkuara
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësim Strategjik Mjedisor
WSSD	Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm

1. HYRJE

1.1 Qëllimi i Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)

Është metoda sistematike për të vlerësuar efektet potenciale të rëndësishme të planeve dhe programeve strategjike si edhe për zbutjen e presioneve ekzistuese në fushat ku këto plane janë të aplikueshme.

Hartimi i këtij raporti është që të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis në hapsirën e kësaj bashkie. VSM mund të konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për arritjen e vendimeve të drejta të planifikimit në lidhje me çështje të tilla si:

- Integrimin e vlerësimeve mjedisore në planifikimin strategjik/urban dhe vendimmarrjen e planifikimit të investimeve në zonën e studimit.
- Vlerësimin e alternativave të planifikimit të zhvillimit, orientimin e zhvillimit, përdorimit të tokës dhe zgjedhjeve për investime në infrastrukturë.
- Përmirësimin komponentëve të mbrojtjes mjedisore të planeve.
- Ndikimi i cilësisë dhe sasisë në pasuritë natyrore dhe kapacitetet e këtyre burimeve për të pranuar zbatimin e qëndrueshëm të planit.

Sipas kërkesave të Ligjit Nr.107/2014 për “Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, miratimi i çdo plani të ri territorial në Shqipëri i nënshtrohet procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), sipas specifikimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 91/2013 për "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor".

Ligji Nr. 91/2013 është përafuar plotësisht me direktivën 2001/42/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Europian, datë 27 qershor 2001 “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara”, (*Numri CELEX: 32001L0042, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 197, datë 21.7.2001, faqe 30 – 37*) e njohur ndryshe si "Direktiva VSM", e cila kërkon që planet dhe programet duhet t'i nënshtrohen një procesi vlerësimi mjedisor në nivel strategjik. Qëllimet e përgjithshme të këtij procesi janë për integrimin e vlerësimeve mjedisore në përgatitjen e planit dhe vendim-marrjeve, për të përmirësuar planet dhe për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit si dhe për të rritur pjesëmarrjen publike në vendim-marrjen mjedisore. Ky proces përfshin përgatitjen e Raportit Mjedisor.

Ky raport është **Raporti Mjedisor** i përgatitur për të vlerësuar efektet mjedisore dhe ato mbi shëndetin publik të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkise së Himarës.

Raporti Mjedisor është përgatitur duke marrë në konsideratë kërkesat e parashikuara në nenin 10 të Ligjit 91/2013 dhe përmban të gjithë informacionin e specifikuar në këtë Ligj. Ky informacion përfshin:

a) përshkrimin e qëllimit dhe objektivave kryesore të planit ose programit dhe të përputhjes së tij me plane ose programe të tjera që lidhen me të, fazën e vendimmarrjes dhe sqarimet nëse disa çështje janë vlerësuar ose do të vlerësohen në nivele dhe procese të tjera planifikimi;

b) përshkrimin e metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të VSM-së, përfshirë vështirësitë e hasura gjatë përgatitjes së tij, dhe burimet e informacionit ekzistues, që përdoren për qëllim të hartimit të raportit;

c) përshkrimin e alternativave të konsideruara gjatë hartimit, rishikimit, ndryshimit apo modifikimit të planit ose programit të propozuar, përfshi edhe alternativën e mosplanifikimit (alternativa zero), si dhe arsyetimet përkatëse;

ç) objektivat për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në shkallë ndërkombëtare, nivel kombëtar, rajonal apo lokal, të cilat lidhen me planin ose programin dhe mënyra në të cilën këta objektiva janë marrë në konsideratë në propozim;

d) përshkrimin e përbërësve të mjedisit në zonën e shtrirjes të planit ose programit të propozuar;

dh) përshkrimin e cilësisë së elementeve të mjedisit në zonën ku propozohet plani apo programi, të cilat mund të ndikohen nga zbatimi i planit ose programit të propozuar;

e) ndërveprimet e mundshme me mjedisin të planit ose programit të propozuar, duke përfshirë në veçanti problemet që lidhen me zona të një rëndësie të veçantë mjedisore, si zonat e mbrojtura;

ë) pasojat e mundshme negative në mjedis, duke përfshirë ndikimet në biodiversitetin, në shëndetin e njerëzve, në tokë, në ujë, në ajër, faktorët klimaterikë, trashëgiminë kulturore dhe arkeologjike, peizazhin apo dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve;

f) pasojat e mundshme negative në mjedisin ndërkufitar, në rast të zbatimit të nenit 17 të këtij ligji;

g) masat e parashikuara për të shmangur apo zbutur sa më shumë të jetë e mundur pasojat e ndikimeve në mjedis, gjatë zbatimit të planit ose programit;

gj) identifikimin e investimeve apo të infrastrukturës mjedisore të nevojshme, në kuadër të planit apo programit të propozuar;

h) përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e pasojave në mjedis gjatë zbatimit të propozimit;

i) përmbledhjen në gjuhë joteknike të raportit paraprak të VSM-së.

Ky studim i VSM analizon një territori që shtrihet përgjatë bregdetit duke mbuluar një sipërfaqe prej 616.85 km² me gjatësi rreth 50 km dhe gjërësi 15 km që i korrespondon një popullsi aktuale prej afro 8.000 banorësh dhe adreson një periudhë prej minimumi 10 vitesh në përputhje me dokumentin e planifikimit të propozuar.

1.2 Autoritetet Përgjegjëse

Autoriteti propozues për raportin mjedisor të VSM-se të Planit të Himarës është Bashkia e Himarës. Raporti është përgatitur në kuadrin e studimit “*Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë*” i cili është përcaktuar të kryhet me firmat konsulente “DEA Grup” dhe “*Thymio Papayannis Inc*” Athinë, të mbështetur nga “*Kompania Nënkontraktore*” Tiranë. Studimi është ndjekur dhe mbikëqyrur nga përfaqësuesi i AKPT.

1.3 Ekipi Konsulent

Realizimi i këtij raporti mjedisor është realizuar nga konsulentë dhe specialistët që kanë përgatitur studimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarës, si dhe plane të tjera territoriale dhe studime të VSM në Greqi dhe në Shqipëri. Ekspertët, (lokal dhe të huaj) të kombinuar me përvoja ndërkombëtare dhe lokale, me reputacion të fortë në fushën e mjedisit. Dr. Athanasios Pagonis – Planifikues Urban, Eirini Tsakiropoulou – Planifikuese Urbane, Dimitris Poulis GIS ekspert, Thymio Dimoupoulos Urbanist për zonat e mbrojtura, Emil Xhuvani Ekspert i licensuar në Mjedis, Mirlinda Rusi eksperte e licensuar në Mjedis, Kostantinos Zekkos Ing transporti, Ivy Nanopoulou Arkitekthe- Peisazhiste, Altin Tçi Urbanist, Altin Kokaj Arkitekt, Genti Qiriazhi Ing Gjeodet (GIS), Albert Gajo Ekonomist dhe Ela Tqllku Eksperte Sociale. Ky ekip përbën një garanci për një punë të kualifikuar ku një rendësi të madhe merr të kuptuarit e proceseve të zbatimit dhe monitorimit të VSM.

1.4 Përshkrim i përgjithshëm i përmbajtjes së Planit

Ky projekt përfshin përgatitjen e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit të Bashkisë Himarë (PPVTB) sipas ndarjes së re territoriale, sipas përcaktimeve të kuadrit të ri ligjor të planifikimit të territorit (të Ligjit Nr.107/2014 për “Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”) dhe në përputhje me Planet PPK e dhe PINS Bregdeti. Kjo e fundit siguron një kuadër gjithë-përfshirës për përgatitjen e planeve vendore. Koncepti kyç i Planit të Përgjithshëm Vendor të Himarës është promovimi i **zhvillimit dhe turizmit të qëndrueshëm** në zonë, i cili adreson nevojën për të mbrojtur burimet e vlefshme dhe për të promovuar menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke minimizuar ndikimet negative në mjedis të zhvillimit lokal dhe të infrastrukturës.

Zona bregdetare Himarë, e cila përbën pjesën më të madhe dhe më tërheqëse të Rivierës shqiptare, është një rast unik i njësisë territoriale me karakteristika të

dallueshme, që aktualisht përballet me një dilemë të madhe në lidhje me zhvillimin e saj të ardhshëm. Pavarësisht se cilësia e rrugëve në vitet e fundit është përmirësuar ndjeshëm dhe shpejtësia mesatare e vozitjes është rritur, koha e mbërritjes në qendrën administrative është relativisht e gjatë (rreth 4 orë nga Tirana dhe 2 orë nga Vlora) megjse distancat nuk janë të konsiderueshme. Kjo ka sjellë izolimin e zonës për pjesën më të madhe të vitit (me përjashtim të sezonit veror), izolim i cili ka ruajtur deri më tani karakteristikat e saj dhe identitetin e peizazhit të veçantë me dëme të kufizuara në fshatra dhe në vijën bregdetare, duke lënë mundësi të mëdha të rigjernerimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, moszbatimi i deri në fund i planeve të mëparshme të zhvillimit bën që aktualisht të këtë një mungesë vizioni dhe rregullash konkrete për ndërtim dhe zhvillim të qëndrueshëm urban. Ndërkohë potenciali për zhvillimin e turizmit duket se ka kapacitete që mund të sjellin përmirësime rrënjësore të kapitalit vendas dhe të cilësisë së jetës së popullatës lokale.

Sipas metodologjisë teknike së propozuar, Konsulenti duhet të përgatisë produktet e mëposhtme të strukturuar sipas fazave nëplanin e aktiviteteve:

- Një vlerësim i plotë i gjendjes ekzistuese të bashkisë duke identifikuar tendencat ekzistuese, problemet kryesore dhe mundësitë për zhvillimin e ardhshëm të turizmit që do të përdoret si bazë për hartimin e planit urbanistik.
- Hartimi i një vizioni të qartë në të ardhmen dhe strategjinë e zhvillimit duke u fokusuar në aspektin e turizmit që do të bazohet në të dhënat nga konsultimi me publikun duke vlerësuar skenarët alternativë.
- Përgatitja e Planit të Përdorimit të Tokës që do të përcaktojë kategoritë kryesore të përdorimit të tokës dhe rrjetin kryesor të infrastrukturës në të gjithë territorin bashkiak, bazuar në strategjinë e zhvillimit të përzgjedhur dhe duke ndjekur parashikimet reale ekonomike dhe demografike.
- Përgatitja në përputhje me planin e rregulloreve të kontrollit të zhvillimit (të tilla si, të zonimit, raporteve ne parcelat për ndërtim, limitet e lartësisë, sipërfaqes së tokës), të shoqëruara me hartat përkatëse të detajuara të zonimit për çdo zonë të banuar dhe ne zhvillim, në përputhje me specifikimet e legjislacioni kombëtar mbi planifikimin territorial.
- Përgatitja e një Dokumenti të Konsoliduar, i cili do të strukturohet si një version draft projekt për Planin Lokal të Territorit që do të paraqitet për komente ne publik në përputhje me kërkesat e ligjit të mëparshëm të miratuar si dokument zyrtar i planifikimit bashkiak.

Finalizimi i planit është zhvilluar dhe bazuar në procesin e konsultimit në publik, që ka ndodhur gjatë fazave të ndryshme të planit të punës.

1.5 Metodologjia, baza ligjore dhe përbajtja e Raportit Mjedisor të VSM

Metodologjia për përgatitjen e këtij Raporti Mjedisor është zhvilluar pas një studimi të hollësishëm ligjit Nr.91/2013, ligjit Nr.111/2012, ligjit Nr.10 431/2011, ligjit Nr.107/2014 dhe ndryshimeve si dhe të dokumenteve udhëzuese bazë të BE¹ dhe VKM-ve. Kjo ka për qëllim që të sigurojë një kuadër të plotë të vlerësimit dhe të identifikimit të çështjeve kritike dhe të konsiderueshme që duhet të adresohen në vlerësimin e mjedisit dhe ndikimet e tij në shëndetin e popullatës, reflektuar në Planin Vendor të Himarës. Për këtë qëllim, synimi kryesor i Raportit Mjedisor ka qenë :

- të skicojë në mënyrë efektive fushën e veprimit dhe kontekstin e PPVTB të Himarës;
- të sigurojë një vlerësim shumë-nivelesh të PPVTB Himarë në drejtim të:
qëllimet dhe objektivave;
politikat e përgjithshme;
propozimet e veçanta të zhvillimit;
- të shmangë dhënien e informacionit të tepërt që është jashtë fushës
- të sigurojë një prezantim direkt për palët respektive të interesuara të PPVTB; përfundimisht, me qëllim që të sigurojë Planin si një mjet të dobishëm që mund të kuptohet lehtësisht nga publiku dhe autoritetet, **në përputhje me p arimet e t ransparencës dhe konsultimeve efektive publike në vendim-marrje**, të cilat janë mbrojtur në Ligjin 91/2013 dhe Direktivën e BE-së 2001/42/KE.


Parametrat e mjedisit dhe shëndetit që duhet të merren parasysh nga Raporti Mjedisor i VSM-së në bazë të Ligjit 91/2013 janë grupuar, kur ka qenë e nevojshme, në kategori të mëdha sipas çështjeve); ose në kategori paralele ku disa nga parametrat janë nën-ndarë, në mënyrë që të përshtatet më mirë me strukturën dhe përbajtjen e PPVTB të Himarës. E njëjta strukturë është ndjekur në të gjithë Raportin e Mjedisit, në mënyrë që të lehtësojë të kuptuarit dhe rishikimin e vlerësimit aktual nga ana e publikut dhe autoriteteve. Baza e metodologjisë janë objektivat e VSM-së, që rrjedhin nga vlerësimet mjedisore dhe janë përdorur për të:

¹Tregues:

- *Manual për VSM për politikën e kohezionit 2007-2013*, Rrjeti i Programeve të zhvillimit të Gjellbërimit Rajonal, 2006.
- *Zbatimi i Direktivës 2001/42 mbi Vlerësimin e Efekteve të Planeve të Caktuara dhe Programeve për Mjedisin*, Komisioni Evropian, QZH të Mjedisit.
- *Lidhja ndërmjet direktivave të VNM dhe VSM*, Kolegjit Imperial të Londrës, Raporti përfundimtar për Komisionin Evropian, 2005.
- *Metodat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis*, botuar nga Peter Morris dhe Riki Therivel, Vëllimi III, 2009.

- vlerësuar ndikimet e pritura mjedisore dhe shëndetit të skenarëve alternativë (Kapitulli 4);
- vlerësuar në detaje rreziqet e pritura mjedisore dhe shëndetësore, ndikimet e politikave të planit vendor dhe projekteve dhe të propozojë masa lehtësuese (Kapitulli 5.
- formuar bazën për formulimin e listës së treguesve për sistemin e monitorimit të propozuar të PPVTB (kapitulli 6).

Metodologjia e hartimit të raportit për VSM-në Himarë është i bazuar në skemën e mëposhtme:



VLERËSIMI I DETAJUAR I PPV (Kapitulli 5)

- Vlerësimi i ndikimeve te pritshme mjedisore dhe shendetesore te PPV në lidhje me objektivat e VSM-se
- Masat e propozuara dhe veprimet për të parandaluar dhe / ose për të zbutur ndikimet e pritshme
- Përzgjedhja e zhvillimit lokal
 - Planit Urbanistik
 - Projektet strategjike të infrastrukturës

Figura 1: Metodologjia për hartimin e raportit të VSM-se në lidhje me specifikat e Planit Lokal të Vlorë dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar të VSM-se

1. Analiza e kushteve të sotme kryesore mjedisore

2.1 Sistemi Urban

2.1.1 Demografia dhe Shpërndarja Hapësinore e Popullsisë

Në vitet 1990 Shqipëria u karakterizua nga një tranzicion i gjerë ekonomiko-politik shoqëruar me një lëvizshmëri të lartë demografike të popullsisë vendase. Në këtë kuadër edhe popullsia e Bashkisë Himarë, sikundër gjithë Shqipëria, u karakterizua nga ndryshime të karakterit migrator, por edhe të ndarjeve të shpeshta territoriale. Kështu, me reformën e re territoriale të bazuar në ligjin Nr. 115/2014, "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia e Himarës e zgjeroi shtrirjen e saj duke u përbërë tashmë nga tre njësi administrative: Njësia Administrative Himarë, Njësia Administrative Lukovë, Njësia Administrative Horë-Vranisht.

Sipas të dhënave të Tabelës 1, regjistrimi i popullsisë për vitin 1989, tregon një popullsi rezidente prej 21403 banorësh që përfaqson rreth 0,7 % të popullsisë së Shqipërisë në këtë periudhë².

Tabela 1: Popullsia rezidente në Bashkinë e re Himarë për vitet 1989, 2001, 2011					
Popullsia sipas vitit				Diferenca 2001-1989	Diferenca 2011-2001
Njësi Administrative	1989	2001	2011		
Lukovë	6523	3149	2916	-3374	-233
Horë-Vranisht	5539	3556	2080	-1983	-1476
Himarë	9341	3278	2822	-6063	-456
Bashkia Himarë	21403	9983	7818	-11420	-2165

Burimi: INSTAT, Census, 2011

Sipas regjistrimit të vitit 2001 popullsia e Bashkisë Himarë bie në 9983 banorë ose me gati 53% në krahasim me vitin 1989 duke shënuar kështu një rënie drastike prej 11420 banorësh brenda këtyre 12 viteve. Kjo rënie e popullsisë rezuton e madhe edhe nëse krahasojmë popullinë rezidente të Bashkisë Himarë për vitin 2001 me totalin e popullsisë për gjithë Shqipërinë. Popullsia e bashkisë Himarë rezulton rreth 0.3 % e totalit të popullsisë së gjithë Shqipërisë për vitin 2001³ duke shënuar një diferencë me 0,4% në krahasim me të njëjtin raport për vitin 1989.

Censusi i fundit i vitit 2011 shënon një popullsi rezidente në bashkinë Himarë prej 7818 banorësh duke shënuar sërish një rënie prej 2165 banoresh në krahasim me vitin 2001, ose rreth 21,7% të popullsisë. Kjo rënie vazhdon të jetë e konsiderueshme dhe shkon në të njëjtin drejtim me tendencën e popullsisë së Shqipërisë nga viti 2001 në vitin 2011⁴ e cila shënon një rënie për rreth 8%.

² Popullsia e Shqipërisë sipas regjistrimit të vitit 1989 është 3,182,400 banorë

³ Popullsia e Shqipërisë sipas regjistrimit të vitit 2001 është 3,069,275 banorë

⁴ Popullsia e Shqipërisë sipas regjistrimit të vitit 2011 është 2,831,741 banorë

Po të shihen të dhënat e ndryshimeve sipas njësive administrative vihet re se njësia administrative Himarë ka pësuar rrënie më të konsiderueshme të popullsisë me 6063 banorë në vitin 2001 në krahasim me 1989 duke u ndjekur më pas nga njësia administrative e Lukovës dhe në fund nga Horë-Vranishti. Në vitet në vijim për këtë njësi administrative, edhe pse popullsia vazhdon të jetë në rënie, vihet re një reduktim i ndjeshëm në vlerën e këtij fenomeni duke e renditur Himarën të dytën pas njësisë administrative të Horë-Vranishtit me 1476 banorë më pak në krahasim me vitin 2001. Njësia administrative e Himarës dhe ajo e Lukovës karakterizohen nga reduktimi i ndjeshëm i rënies së popullsië përgjatë harkut të viteve 2001-2011 aspekt ky që e karakterizon njësinë administrative të Horë-Vranishtit e cila vazhdon të mbajë thyajse të njëjtat ritme të reduktimit të popullsisë.

Tabela 2 tregon strukturën e popullsisë meshkuj-femra për të gjitha njësitë përberëse të Bashkisë Himarë.

Tabela 2: Struktura e popullsisë së Bashkisë Himarë sipas gjinisë, 2011			
Bashki	Popullsia	Meshkuj	Femra
Himare	2822	1467	1355
Lukove	2916	1499	1417
Vranisht	2080	1031	1049
Total	7818	3997	3821

Burimi: INSTAT, Census 2011

Siç shihet nga Tabela e mësipërme Bashkia Himarë ka në total një shpërndarje pothuajse të barabartë meshkuj-femra të popullsisë rezidente, gjë që tregon se flukset migratore tashmë janë stabilizuar duke mos krijuar një shpërndarje jo të rregullt në popullsi sipas gjinisë. Po të njëjtën rregullsi në shpërndarje ka edhe brenda njësive administrative të Bashkisë Himarë. Po ti referohemi regjistrin të gjendjes civile për Bashkinë Himarë, rezulton se totali i popullsisë për vitin 2015 është 13.328 banorë. Siç shihet vlerat paraqiten të ndryshme dhe të shumëfishuara në krahasim me të dhënat e marra nga INSTAT gjatë censusit të vitit 2011.

Duke ditur se Bashkia Himare shtrihet në një territor të përafërt me 571.94 km², si dhe duke patur parasysh popullsinë e saj sipas Censusit 2011 e cila rezulton në 7818 banorë, mund të themi se se dendësia e Bashkisë së Himares është afërsisht 14 banorë për km².

Tabela 3: Dendësia e popullsisë Bashkia Himarë			
Njësi Administrative	Sipërfaqja km²	Popullsia 2011	Dendësia
Lukovë	202	2916	14.4
Horë-Vranisht	234	2080	8.9
Himarë	135.94	2822	20.8
Bashkia Himarë	571.94	7818	13.7
Shqipëria	28.748	2831741	99

Burimi: INSTAT, Cencus 2011

Dendësia e popullsisë së Bashkisë Himarë është gati 7 herë më e ulët se dendësia e popullsisë në nivel kombëtar, e cila sipas të dhënave të Censurit të vitit 2011 është 99 banorë për km².

Në këtë kuadër të ndryshimeve të sjella në të gjithë territorin e Shqipërisë nga ndarja e re administrative, edhe Bashkia e Himarës e zgjeroi shtrirjen e saj duke përfshirë, përveç njësisë administrative të Himarës edhe njësinë e Horë-Vranishtit dhe atë të Lukovës.

Vlerësimet e perafërta tregojnë se nga rajoni i Himarës kanë emigruar deri në vitin 2001 rreth gjysma e popullsisë, e përbërë nga 11,420 persona, pjesa më e madhe e të cilëve presupozohen të jenë të moshës së punës 15-65 vjec. Pas vitit 2001 trendi i emigracionit ndryshoi në kah të kundërt, që do të thotë një pjesë e vogël e kësaj popullsie filloje të kthehet në Himarë, duke filluar aktivitetet private kryesisht ato të lidhura me industrinë e turizmit.

2.1.2 Ekonomia dhe Punësimi

Ekonomia e Bashkisë e Himarës dallon kryesisht për tiparin e saj në zhvillimin e ekonomisë të orientuar drejt turizmit, bujqësisë dhe agro-përpunimit. Këto veçanti ekonomike janë të zhvilluara sipas njësisë administrative duke ju përshtatur karakteristikave të tyre gjeografike, klimaterike dhe kulturore. Në tabelën 4 të mëposhtme tregohet numri i ndermarrjeve aktive në fund të vitit, sipas njësive administrative në Bashkinë Himarë për vitet 2013 dhe 2014 si dhe numri total i tyre në nivel kombëtar dhe në nivel Qarku.

Tabela 4: Ndërmarrjet aktive në Bashkinë Himarë, 2013, 2014				
	Viti			
	2013		2014	
Komunë / Bashki	Në vlerë	Në %	Në vlerë	Në %
Total Shqipëria	111,083	0.5	112,537	0.5
Qarku Vlorë	9,363	5.7	9,580	6.2
Lukovë	142	26.4	126	21.3
Horë-Vranisht	23	4.3	25	4.2
Himarë Bashki e vjetër	373	69.3	441	74.5
Bashkia Himarë	538	100	592	100

Burimi: INSTAT, Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve

Në nivel kombëtar, në vitin 2014, ndërmarrjet aktive në Bashkinë Himarë zenë vetëm 0.5% të ndërmarrjeve aktive, duke mos paraqitur asnjë ndryshim në krahasim me vitin 2013 për të cilin kjo vlerë është po ashtu 0.5%. Në nivel Qarku ka një rritje të peshës specifike të ndërmarrjeve aktive ku në vitin 2014 arrihet në 6.2% nga 5.7% për vitin 2013, gjë që tregon se përgjithësisht rajoni i Bashkisë Himarë po karakterizohet me një rritje në drejtim të zhvillimit të biznesit.

Po të shihet struktura e ndërmarrjeve aktive brenda njësisive administrative të Bashkisë Himarë vihet re se pjesa më e madhe e këtyre ndërmarrjeve ndodhen në ish bashkinë e vjetër Himarë. Në vitin 2014 numërohen 441 ndërmarrje aktive nga 592 të tilla për gjithë Bashkinë, ose 74.5% të totalit të ndërmarrjeve aktive. Ndërsa në njësitë e tjera administrative ky numër është më i vogël, duke variuar në 21.3% në Lukovë dhe akoma dhe më pak ose 4.2% në rastin e Horë-Vranishtit.

Po kështu, duke parë ndryshimet e peshës specifike të ndërmarrjeve aktive në vitin 2013 në krahasim me 2014, vihet re një përqëndrim i peshës specifike të këtyre ndërmarrjeve gjithnjë e më shumë si aktivitete prodhuese në zonën e ish Bashkisë Himarë, pavarësisht se kjo bashki në tërësi është e gjitha rurale e për pasojë nuk mund të flitet për diferenca urbane-rurale. Planifikimi i zhvillimit urban duhet të marrë parasysh këto kushte që ofron bashkia Himarë për zhvillimin e njëtrajtshëm të biznesit në të gjithë territorin e saj.

Tabela 5 tregon shpërndarjen e ndërmarrjeve ekonomike aktive sipas sektorëve të ekonomisë në Qarkun e Vlorës dhe në Bashkinë e re Himarë. Të dhënat më të hollësishme, për çdo njësi territoriale, nuk qe e mundur të viheshin në dispozicion nga INSTAT për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të ndërmarrjeve. Megjithatë të dhëna më të detajuara u arritën të merreshin nëpërmjet konsulentit në Bashkinë Himarë, por në çdo rast, ky grup të dhënash nuk u vunë në përdorim për shkak të mospërputhjes së tyre si nga pikpamja numerike e ndërmarrjeve aktive ashtu në shpërndarjen e tyre sipas sektorëve të ndryshëm ekonomik.

Tabela 5: Ndërmarrjet aktive në Himarë sipas ndarjes administrative dhe aktivitetit ekonomik, 2014

Bashkia	Gjithsej	Bujqësia, pyjet, peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Transporti dhe magazinimi	Akomodi mi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikacioni	Të tjera
Qarku Vlorë	9,580	428	820	529	3,556	716	2,019	153	1,359
Himarë	592	21	44	17	151	27	281	9	42
në %		3.5	7.4	2.9	25.5	4.6	47.5	1.5	7.1

Burimi: INSTAT, Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve

Nga tabela 5 vihet re se numri më i madh i ndërmarrjeve ekonomike ndodhen në sektorin e hotelerisë dhe resoranteve (akomodimi dhe shërbim ushqimor) me 281 njësi ose 47.5 % të ndërmarrjeve aktive. Në vend të dytë me 25.5% nga pikëpamja e numrit, radhiten sektori i tregtisë me 151 ndërmarrje aktive dhe sektori i industrisë përpunuese dhe transportit me 7.4 dhe 74.6 % të totalit të ndërmarrjeve. Tabela e mësipërme paraqet në linja të përgjithshme karakterin ekonomik të rajonit të Bashkisë Himarë, pa ju referuar peshës specifike të çdo sektori në prodhimin e përgjithshëm rajonal, pasi këto të dhëna nuk u vunë dot në dispozicion si nga INSTAT-it ashtu edhe nga Bashkia Himarë.

Tabela 6: Ndërmarrjet aktive në qarkun Vlorë sipas ndarjes administrative dhe formës ligjore, 2014

Bashkia	Gjithsej	Person fizik	Person Juridik
Qarku Vlorë	2056	1801	255
Himarë	592	511	81
në %	100	86.3	13.7

Burimi: INSTAT, Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve

Nga numri total i ndërmarrjeve aktive, i barazvlefshëm me 592 në Bashkinë Himarë, 86.3% e tyre janë organizuar si person fizik (PF) dhe 13.7 % ose 81 ndërmarrje aktive janë në një prej formave të tjera të shoqërive tregtare. Kjo situatë flet përgjithësisht për një organizim jo të mirë të ndërmarrjeve aktive, pasi forma si PF nuk i lejojnë këtyre ndërmarrjeve të kenë akses shumë të madh në tregun financiar. Mungesa e aksesueshmërisë i referohet si kredimarrjes afatgjata, ashtu edhe krijimit të formave dhe sinergjive për tërheqjen e kapitaleve pranë këtyre ndërmarrjeve, në formën e kapitalit aksionar apo pjesmarrjen në shoqëri, dhe kjo nga momenti që kapitali i PF nuk është i përpjestueshëm.

Punësimi dhe shpërndarja e të punësuarve sipas tre sektorëve më të rëndësishëm, industri, bujqësi/agrikulturë dhe shërbime, na tregon jo vetëm shkallën e punësimit por dhe karakterin e çdo rajoni që përbën Bashkinë e re Himarë. Këto të dhëna paraqiten në tabelën 7.

Tabela 7: Shpërndarja e të punësuarve sipas sektorve Bashkia Himarë

Njësia Administrative	Nr total i të punësuarve- 2011	Të punësuarit në industri - 2011	Të punësuarit në agrikulturë- 2011	Të punësuarit në shërbime - 2011
Lukovë	42.3	27.5	25.7	46.8
Horë-Vranisht	18.4	9.4	64.7	25.9
Bashkia e vjeter Himarë	59.4	29.5	9.7	60.8
Bashkia Himarë				
Shqipëria	54.5	20.4	26.1	53.5

Burimi: INSTAT, Census 2011

Nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Himarë, përqindja më e lartë e punësimit është në Bashkinë e vjetër Himarë me 59.4%, e cila tejkalon edhe nivelin kombëtar prej 54.5% e popullsisë. Njësitë e tjera administrative kanë një nivel punësimi shumë të ulët gjë që flet për diferenca mjaft të mëdha sociale. Kështu niveli i punësimit në Horë-Vranisht është vetëm 18.4%, ndërsa në Lukovë 42.3%. Këto vlera rezultojnë shumë më poshtë nivelit të punësimit në nivel Kombëtar dhe aq më shumë në krahasim me Njësinë administrative të Himarës.

Siç thamë më lartë, shpërndarja e popullsisë sipas degëve paraqet karakterin e rajoneve. Në njësinë e Horë-Vranishtit pjesa më e madhe e popullsisë, 64.7% e të punësuarve janë në sektorin e agrikulturës. Më e ulët është kjo përqindje në njësinë administrative të Himarës me 9.7% por dhe në Lukovë me 25.7%. Ky aspekt flet për karakterin kryesisht rural të kësaj njësie. Ndërsa në njësinë administrative të Himarës pjesa më e madhe e të punësuarve janë në sektorin e shërbimeve me 60.8%, dhe 29.5% në industri. Gjithashtu edhe Lukova ka pjesën më të madhe të të punësuarve në shërbime me 46.8%.

2.1.3 Përdorimi i tokës

Përdorimi i tokës në NJQV-të e reja është ndarë për qëllime të planifikimit në pesë sisteme territoriale: Urban, Natyror, Bujqësor, i Ujit dhe Infrastrukturor. Analiza e sistemeve për Bashkinë e Himarës është si në vijim:

Sistemi Urban- Sistemi urban i referohet tokës tashmë të zhvilluar, e quajtur vendbanime urbane dhe rurale të Bashkisë. NJQV e re përbëhet nga 24 vendbanime shumicën e të cilave mund ti përshkruajmë si vendbanime malore, me Himarën si qytetin e vetëm të rëndësishëm bregdetar në zonë. Në njëzet vitet e fundit, presioni turistik kontriboi edhe në zhvillimin e vendbanimeve përreth bregdetit në plazhet më të rëndësishme. Megjithatë, varësia tradicionale nga aktivitetet rurale, e zvogëluar, ruan edhe sot karakterin e një sistemi urban të vendbanimeve të ulëta. Ka dy tipe kryesore të fshatrave dhe vendbanimeve:

- Vendbanimet tradicionale që flasin për një arkitekturë funksionale me cilësi të lartë dhe ndërtesa që datojnë në epokën e paraluftës si Dhërmi, Vuno, Himarë e vjetër, dhe Qeparo vjetër.
- Vendbanimet që u ndertuan kryesisht pas luftës si dhe gjatë periudhës socialiste e tej, pas vitit 1990 si në rastin e Borshit dhe Lukovës.

Sistemi urban i bashkisë është strukturuar rreth aksit Veri-Jug të bazuar në rrugën që lidh Vlorën me Himarën dhe Sarandën. Me këtë rrugë janë të lidhura shumica e vendbanimeve malore përreth Himarës dhe Lukovës. Fshatrat e ish komunës së Horë-Vranishtit janë i vetmi përjashtim. Ky grup i veçuar i vendbanimeve në luginën e Drinos ka lidhje të kufizuara me pjesën tjetër të Bashkisë së Himarës. Ata janë të arritshëm vetëm nëpërmjet një kalimi malor përmes Borshit i cili të çon në Vlorë.

Bashkia karakterizohet nga një përqindje e ulët e përdorimit urban të tokës (1.6% në Himarë dhe 1.0% në Lukovë sipas Plani i Jugut i vitit 2008 që i referohet një rrjeti vendbanimesh me densitet të ulët. Shpërndarja e zhvillimeve të tanishme me sër shumti në zhvillimin e tokës bujqësore ndryshon bilancin ndërmjet tokës urbane dhe asaj bujqësore

Sistemi Natyror- Bashkia e Himarës mbulon një zonë me shtrirje përgjatë bregdetit nga Llogaraja në Palasë e Lukovë. Kjo zonë përbën pjesën me natyrale të rivierës shqiptare dhe përfaqëson peisazhin më karakteristik të saj. Fshatrat e luginës së Drinos (Horë-Vranisht) formojnë një unitet të ndryshëm, me shumë ngjashmëri por pa pjesët dalluese midis zonave malore dhe të detit. Ky është i vetmi terren i bregdetit shqiptar ku malet kanë lidhje të drejtpërdrejtë me (prekin) detin. Kreshtat e thyer të malit gëlqeror që lëvizin përgjatë bregdetit ndahen "priten" nga një sistem luginash pasojë e erozionit, me përrenj dhe kanione.

Peizazhi karakterizohet nga toka të zhveshura me shkurre dhe pemë të shpërndara. Sipas studimit të Planit të Jugut, ai zë gati 75% të sipërfaqes së përgjithshme të tokës. Kjo tokë nuk mund të konsiderohet si tokë e papërdorshme, por mbetet e përfshirë në kategorinë e kullotave dhe livadheve. Ato janë të shpërndara përgjatë gjithë sipërfaqes së Bashkisë Himarë, në kodrinat dhe malet me lartësi mesatare, rreth tokës bujqësore dhe përgjatë qendrave të banimit. Pyjet ndodhen në zonën me lartësi më të madhe, zakonisht ndodhen në faqet e maleve në vargmalin jugor. Përveç zonës së parkut kombëtar të Llogorasë e cila përmban lloje të ndryshme pishash, fier dhe frasher, ka dhe pjesë të tjera malesh të pyllëzuara si për shembull zona drejt Pilurit me dru lisi. Këto zona kanë sipërfaqe të vogla vetëm 2.5 % të sipërfaqes së përgjithshme. Plazhet janë elementi karakteristik kryesor i Bashkisë Himarë. Ata vlerësohen në një masë të madhe si plazhe të gjata të tipit ranor, si Draleo, Perivoli, Jalë, Livadhe, Spile, Potam, Qeparo, Nivicë, Borsh, Kakome deri në plazhe të mesëm, si Jala, Limani, baza e mëparshme nënujore dhe plazhet e vogla si Filikure, Ngjipe.

Flora e zonës së studimit është shumë e pasur me pothuaj 1,400 specie bimësh vaskulare (që përfaqësojnë me shumë se 40% të florës totale në Shqipëri). Rreth 68 specie bimore, ose 21.3% e totalit të specieve të rralla dhe në rrezik të Shqipërisë (330 lloje) janë të vendosura në këtë zonë. Zona karakterizohet nga një diversitet i pasur dhe shumëllojshmëri e florës dhe faunës, si pyjet, kullotat, plazhet dhe ligatinat që ofrojnë habitate për një numër të madh të llojeve të rrezikuara. Plani i Menaxhimit të Bregdetit Shqiptar i vitit 1995 ka përcaktuar pesë zona të ndjeshme mjedisore, zona këto me bukuri natyrore, me vlera historike dhe kulturore dhe me një biodiversitet të pasur: Gadishullit të Karaburunit; Kanioni i Vunoit; Porto Palermo; Plazhi i Kakomesë dhe Butrinti. Tre prej tyre janë në bashkinë e Himarës dhe dy të tjerat janë në afërsi të saj. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin i cili është miratuar nga Qeveria Shqiptare në vitin 1999 ka përcaktuar tetë zonat e ndjeshme mjedisore, në mesin e tyre kanionin e Gjipese, Porto Palermo, lumin e Borshit, gjirin e Kakomesë dhe kepin e Qelafit në bashkinë e Himarës. Veç ketyre, ka zona me interes të veçantë, duke përfshirë ligatinat në Qeparo, dhe delta e përroit të Palasës (Strata Bianca).

Sistemi Bujqësor- Toka bujqësore zë rreth 21,4% të totalit të sipërfaqes së tokës dhe më shumë është e përbërë me plantacione ullinjsh dhe disa pemtari. Vihet re se toka bujqësore është e mirë organizuar nga koha e socializmit. Tarracat e pjerrta janë gjëresisht të përhapura dhe të mbjella me ullinj, dhe vihet re edhe sot prezenca e sistemit të kullimit përgjatë tokës bujqësore (me kanale, rezervuare etj). Tokat bujqësore në fshatrat e luginës së Drinos në jug (Vranisht, Kallarat) janë kryesisht në formën e kultivimit të organizuar. Në pjesën bregdetare të bashkisë këto zona janë më të pakta dhe në afërsi me vendbanimet, kryesisht përreth Palasë-Dhërmi dhe Himarë-Pilur.

Zona paraqitet si një sistem tarracash me pemishte, një teknikë tradicionale që është përdorur gjëresisht nga regjimi i peridhës komuniste. Këto tarraca shtrihen përgjatë zonave bregdetare përreth Himarës së vjetër dhe veçanërisht në kodrat e Piqeresit, nga Borshi në Lukovë dhe janë të pasura me ullinj dhe agrume. Po ashtu, në Pilur dhe Kudhës gjenden vreshta dhe fermat me fruta në luginën e Borshit Për shkak të emigrimit dhe rënies së prodhimit bujqësor si edhe përqëndrimit të ekonomisë lokale drejt turizmit dhe ndërtimit, një pjesë e madhe e tokës bujqësore mbetet e pashfrytëzuar, ndërsa operimi i sistemeve të ujitjes mbetet e pasigurt. Toka bujqësore pothuaj është privatizuar e gjitha gjatë vitit 1990 duke iu shpërndarë përdoruesve të saj të ardhshëm; me së shumti rezidente të Himarës dhe të ardhurve në atë kohë. Sot, pavarësisht dëmit në tokat bujqësore për shkak të zgjerimit urban dhe suburbanizimit, prodhimit të pakët dhe tokave bujqësore relativisht të kufizuara në krahasim me pjesën tjetër të Europës (24% në Shqipëri dhe 40.8% në BE), bujqësia ofron 25% të GDP e Shqipërisë (1.6 në BE). Toka, dheu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me funksionin si habitat, tërësi gjeneshe, si mjedis i aktiviteteve të ndryshme njerëzore (ndërtim, bujqësi etj), si peizazh, trashëgimi si dhe një sigures i lëndës së parë. Këto funksione janë të rëndësishme dhe duhen mbrojtur pasi ka një rëndësi të madhe për mjedisin por edhe për problemet social-ekonomike. Është e qartë se degradimi i dherave është me pasoja negative mbi shëndetin e njerëzve, ekosistemet dhe ndryshimet klimatike. Si ndërmjetës midis pjesës së brendshme të tokës, ajrit dhe ujit, dherat janë një burim i parinovueshëm që kryen funksione jetësore: ushqimi dhe prodhimi të biomasës, depozitimit, filtrimit dhe transformimit të shumë substancave duke përfshirë edhe ujin, karbonin dhe azotin. Është shumë e rëndësishme të adoptohet Direktiva Kuadër e BE për tokën me objektivat për mbrojtjen dhe ruajtjen e cilësisë në të gjithë zonën në studim.

Përqindja e tokës urbane dhe asaj bujqësore është rreth 23% e totalit të tokës dhe në përgjithësi gjendja e saj paraqitet akoma e mirë. Raporti midis tokës së përdorur ndaj asaj totale është shumë i mirë dhe përbën një thesar për këtë zonë të studimit që duhet ruajtur. Është e nevojshme rritja e sipërfaqes së pyjeve për të minimizuar efektet e erozionit, për të ruajtur dhe krijuar habitate të reja si dhe për të kontribuar në cilësinë e peizazhit.

Sipas Planit të Integruar Ndërsektorial Bregdetar (PINSB), sektorit të bujqësisë në gjithë zonën bregdetare nga Vlora deri në Sarandë i jepet një potencial i madh. Fuqizimi i sistemit të tarracave mund të luajë një rol të rëndësishëm për

qëllime turistike duke evidentuar karakterin mesdhetar të zones dhe ofrojnë produkte lokale jo vetëm për turistet por për gjithë territorin. PINSB propozon krijimin e një identitet në fushën e kulinarisë të zonës.

Bazuar në hartë e kategorive të tokave në Republikën e Shqipërisë hartuar nga Instituti i Studimit të tokave, në zonën e Bashkisë Himarë gjenden pothuajse të gjitha tipet e tyre. *Brezi i tokave të kafenjta malore* shtrihet në pjesët më të ulëta të maleve, nganjëherë fillojnë nga 300m mbi nivelin e detit dhe shfaqen në lartësi deri në 1000-1300m mbi nivelin e detit, shtrihen si në brezin e shkurreve ashtu edhe të dushkut. *Brezi i tokave të kafenjta pyjore*, shtrihet në brezin e ahut dhe të pishës, në pjesën e mesit dhe të sipërme të luginave lumore, duke zënë lartësinë nga 700-1699m mbi nivelin e detit. *Brezi i tokave kullotë malore* që rrisin dhe zhvillojnë brezin bimor të kullotave alpine, zakonisht vendosen mbi 1500-1700m dhe ndodhet nën ndikimin e një klime të ftohtë dhe të ashpër malore, të brezit të ahut, karakteristikë për pllajat malore veriore. *Brezi i toka pyjore të kafenjta është një zonë* me toka që përmbajnë më pak fosfor krahasuar me elementët e tjerë dhe kryesisht përfaqësohet nga toka pyjore të kafenjta, të cilat janë formuar sidomos nga magma ultra-alkaline TIC e shkëmbinj sedimentarë. Në bazë të strukturës kimike, tokat e zakonshme të tokave kafe pyjore kanë reagim neutral me tendencë aciditeti (pH 5,8-6,0), shkallë të lartë të ngopjes me alkaline (90-95%), përmbajtje të lartë të humusit, azotit (humus 12 - 14%, azotit 1,08-0,48) e kalium. Tokat pyjore kafe të pangopura alkaline janë formuar nga formacionet rërore dhe argjilore. Ato kanë karakteristika të përbashkëta me tokat e zakonshme pyjore, por ndryshojnë prej tyre nga aciditeti, nga shkalla më e ulët e ngopjes me alkaline (20-25%) dhe nga përmbajtja në sasi më të vogël të humusit (6-7 %) dhe azotit (0.35 %).

Shtratet e ujrave në të gjithë hapësirën në Bashkinë e Himarës dhe në zonën më gjerë bregdetare midis gadishullit të Karaburunit dhe Sarandës ndjekin rrugën përgjatë bregdetit për shkak të topografisë së rajonit. Prandaj në gjithë zonën kryqezohen lumenj dhe përrenj në drejtimin verilindje-jugperëndim që të çojnë në det. Lumenjtë janë me një regjim të përkohshëm, pra prurjet janë më të mëdha në sezonin e reshjeve (pranverë, vjeshtë dhe dimër) dhe pothuajse thahen në sezonin e verës. Por kjo nuk ndikon në furnizimin me ujë të zonës, pasi burimet ujore dhe zonat akumulimit të ujërave nëntokësore janë shumë të pasur gjatë gjithë vitit.

Pothuajse të gjithë qendrat e banimet dhe të gjithë plazhet kanë lidhje me burimet ujore. (Palasë, Dhërmi, Gjilek, Jal, Himarë, Livadhi, Potami, Spilea, Kudhës, Qeparo, Borsh, Piqeras, Lukovë). Këto shtrate uji shpesh krijojnë kanione (Gjipe, Himarë e vjeter, Borsh etj) ose delta e përroit të Palasës (Strada Bianca). Në zonën në studim nuk ka liqene me perjashtim të disa rezervuarve artificial (p.sh.i Vunoit) për qëllime ujitje. Në pjesën veriore të Bashkisë së Himarës, lumi i Shushicës krijon një peizazh karakteristik duke formuar luginën e pasur të Drinos në zonën e Horë-Vranishtit.

Trajtimi i ujit pëbën një nga problemet kryesore për të gjithë zonat e banimit dhe qytetet përgjatë bregdetit. Sipas PINSB, ky ngrihet si një problem i rëndësishëm për të gjithë Bregun e Jugut e të Shqipërisë dhe jo vetëm bashkinë e Himarës,

meqenese mostrajtimi i ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta çon në ndotje të konsiderueshme. Në bashkine e Himarës një nga faktorët kryesorë që po i ndot përrenjtë dhe lumenjtë dita ditës është derdhja e mbetjeve në shtratin e tyre. Kjo ndodh pa përjashtim në të gjitha fshatrat e zonës, por në veçanti në ato rrjedha që përfundojne në det. Arsyeja kryesore e hedhjes së mbetjeve nga ana e banorëve të këtyre fshatrave nëpër përrenj është keqmenaxhimi i mbledhjes së mbetjeve dhe mungesa e kazanëve apo koshave në fshatrat.

Aksesueshmeria e dyanshme e zonës në studim: në shkallë kombëtare, si dhe në shkallë ndërkombëtare, është me rëndësi jetike për rajonin e Himarës, për shkak të karakterit dominues të turizmit vendas dhe të huaj dhe impaktit të tij në aktivitetin ekonomik të rajonit. Nën sistemi i transportit rrugor i përbërë nga makina për udhëtarë, taksi, autobuzë dhe kamionë është pothuajse i vetmi sistem transporti i cili aktualisht shërben në zonën e studimit, për shkak të mungesës së rrjetit hekurudhor. Pra duket qarte se nuk është parashikuar për të ardhmen transport direkt hekurudhor për rajonin në fjalë, pasi aktualisht nuk ka rrjet hekurudhor të zhvilluar deri në jug të Vlorës, duke kufizuar kështu llojet e tjera të transportit duke mbetur në shërbim vetëm sistemi i transportit rrugor. Rrjeti rrugor është gjithashtu në gjendje jo të mirë. Përveç rrugës bregdetare, njësitë dhe fshatrat e bashkisë janë të lidhura me rrugë të ngushta e të pashtuara. Edhe sistemi i brendshëm rrugor i qendrave të banuara mbart një sërë problematikash.

Transporti Detar, ekziston si një lidhje detare ndërmejt Himarës dhe Korfuzit, që operon vetëm gjatë sezonit të verës (dy muaj), e cila ka rifilluar funksionimin e saj pas ndërprerjes të disa viteve më parë. Transporti detar me anije nga porti i Vlorës drejt Brindisit paraqitet shumë më i vlefshëm sesa lidhja detare Sarandë - Corfuz, si në aspektin e frekuencave dhe kapacitetit mbartes për automjete të anijeve, ashtu edhe në atë të distancës dhe kohëzgjatjes së udhëtimit. Ky i fundit është i pranueshem pasi llogarit të kapë flukset turistike ndërkombëtare sidomos nga Evropa Perëndimore që përdorin automjete për të udhëtuar, kryesisht për në Itali dhe më pas përmes Brindizi - Vlorë në destinacionin final të tyre Shqipëri dhe jugut duke përfshirë edhe Himarën, apo trajektoren Durrës - Brindizi /Bari /Ancona. Shërbimi i transportit ajror konsiderohet si shërbim indirekt dhe përdoret kryesisht për turistët ndërkombëtarë-kryesisht nëpërmjet aeroportit të Tiranës dhe së dyti nëpërmjet aeroportit të Korfuzit-Greqi. Aeroporti i Tiranës, duke qenë i vetmi aeroport ndërkombëtar në vend, është i vendosur në një distancë prej rreth 200 km. larg nga Himara, i cili nuk është konsideruar adekuat dhe i përshtatshëm për të mbuluar nevojat e udhëtimit të flukseve turistike ndërkombëtare të rajonit.

Konfliktet e përdorimit të tokës- Konflikti kryesor në përdorimin e tokës ka të bëjë me presionet e përdorura për urbanizimin e tokës bujqësore, burimeve të ujit, dhe plazheve. Tendencat drejt urbanizimit, zhvillimit informal me theks në turizëm dhe sektorin e ndërtimit kanë ndryshuar ndjeshëm ekuilibrat e përdorimit të tokës. Situata bëhet veçanërisht problematike në rastet e aktiviteteve të caktuara prodhuese që zhvillohen pranë burimeve të ujit, si dhe në rastet e zhvillimit rezidencial apo turistik brenda tokave bujqësore dhe përgjatë bregdetit.

Ndotja akustike mund të jetë shumë e dëmshme për shëndetin publik duke shkaktuar një numër të madh problemesh shëndetësore, siç po ndodh sot në një numër të madh qytetesh të zhvilluara. Këto zhurma për më tepër duhen evituar apo minimizuar në zona turistike si Himara. Efektet e zhurmave mjedisore në shëndet janë të ndryshme dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë identifikon një numër të konsiderueshëm efekteve negative shëndetësore të shkaktuara nga zhurmat mjedisore. Efektet mbi shëndetin të ndotjes nga zhurma, janë të ndara sipas efekteve specifike:

defiçiti auditiv, interferenca në komunikim, çrregullimet e gjumit, efektet psikofiziologjike, efektet mbi shëndetin mendor, efektet mbi nivelin e performancës, efektet sociale dhe turbullimet në mënyrën e sjelljes, etj. gjithashtu zhurmat mund të sjellin çorientim edhe tek zogjtë, duke dëmtuar për pasojë zinxhirin ushqimor.

Duke qenë jo vetëm një qendër rezidenciale por edhe një qendër e rëndësishme turistike, Bashkia e Himarës duhet të marrë masat e duhura për të shmangur këtë ndotje në zonë. Burimet kryesore të kësaj ndotjeje janë disko-baret në plazhe me muzikën me volum të lartë, trafiku i rënduar në periudhën e sezonit veror, parkimet në zonat rezidenciale dhe pranë plazheve etj. Kjo ndotje është edhe më e dëmshme në orët e vona të natës. Parkimi në afërsi të shëtitorës në qytetin e Himarës është një tjetër “pikë e nxehtë” e kësaj ndotjeje sidomos gjatë periudhës së verës. Institucioni i bashkisë duhet të përcaktojë zonat “zhurmshme” për të rinjtë ku brenda kushteve të ligjit për zhurmat në mjedis, ku ata të mund të kalojnë kohën e lirë dhe zonat apo plazhet e “qeta” për familjarët. Pjesa malore e bashkisë nuk ka probleme lidhur me zhurmat.

Një faktor tjetër që ndikon në biodiversitetin ujor është dhe lëvizja e anijeve në portin e Himarës dhe më gjerë të cilt me zhurmat e tyre motorrike dhe të helikave mund të dëmtojnë faunën ujore.

Masa të posaçme duhen ndërmarrë në përputhje dhe me standardet e BE në bashkinë e Himarës.

Himara është identifikuar me *Chimera*, fillimisht e përmendur nga Plini Plak në një list të qyteteve bregdetare dhe më vonë e regjistruar si *Chimaerae* nga Prokopiusi i cili e regjistron venbanimin si të rifortifikuar nga Justiniani. Pavarësisht nga ky dokument, në Kalanë e Himarës nuk janë zbuluar shenja të fortifikimit të Justinianit.

Në 1930 L. Kardini ka dokumentuar tre shpella të ndodhura pranë bregut (të njohura si Spile – që do të thotë shpellë). Kardini ka zbuluar shtresa prehistorike me depozita ku janë gjetur qeramikë, gurë stralli dhe kocka kafshësh të mëdha. Shpella e parë është më e madhja me rreth 20 metra e thellë. Në vitin 2002 dhe 2003 u kryen gërmime të cilat dhanë një stratigrafi të detajuar të depozitimeve në Shpellë që tregonin për përdorimin e saj nga Periudha e Mesme e Bronzit deri në shekullin e 20^{të}. Gërmimi në Shpellën e Himarës megjithëse nuk përfaqëson një vendbanim të mirëfilltë, por një vendqëndrim të përkohshëm të përdorur gjatë periudhave kohore të pranishme në të (mezolit, bronz, hekur, antikitet, antikitet i vonë e mesjetë), përsërit në përgjithësi të dhënat historike e kulturore që karakterizojnë trevën e bregdetit jonian nga kërkimet e studimet e deritanishme. Vendbanimet e mirëfillta prehistorike përreth shpellës gjenden më lart vijës bregdetare ku futen territori i Kalasë së Himarës, Qyteza në perëndim të saj dhe Kalaja e Armeridhës në perëndim të Gjirit të Panormit të cilave më në veri e në jug të bregdetit u korrespondojnë vendbanime të tjera të fortifikuara si: Kastri, Vlatore, Pìrg, Kolez, Karos, Kukum, Ngurë, Borsh, Badhër, Gjashnjar etj. Në antikitet nga këto vendbanime, Himara dhe Borshi do të

shndërroreshin në qendra qytetare. Kështjella e Himarës dhe Shpella e Spilesë janë monumente kulture prej vitit 1963.

Himara si qendër e banuar për shkak të pozitës gjeografike i ka dhënë emrin bashkësisë krahinore bregdetare. Ndarja e fundit administrative e ka zgjeruar Bashkinë e Himarës duke përfshirë në administrimin e saj qendrat e banimit si Himarë, Pilur, Kudhës, Qeparo fshat, Qeparo Fushë, Vuno, Iljaz, Dhërmi, Palasë, Lukovë, Borsh, Fterrë, Çorraj, Piqeras, Sasaj, Qazim Pali, Shënvasil, Nivicë, Vranisht, Kuç, Kuç Burronja, Bolenë, Kallarat, Tërbaç. Në aspektin e trashëgimisë historike kulturore Bashkia e Himarës dallohet për intensitet banimi që dallohet mirë në hartën arkeologjike të saj prej periudhës së prehistorisë (vendbanimet e shumta të fortifikuara), në atë antike ku u zhvilluan qytetet e Himarës dhe Borshit dhe gjatë mesjetës ku përsëri roli i këtyre dy qendrave mbeti qendror. Nga antikiteti ky territor i banuar qysh herët nga fiset e Kaonëve morri emrin Kaoni, ndërsa sot ai quhet Bregdeti.

Nga studimet e kërkimet arkeologjike të vendbanimeve të Kaonisë perëndimore (Himara, Karosi, Badhra, Gjashnjari, etj., të dhënat e deritanishme flasin për fortifikimin e këtyre vendbanimeve në periudhën e bronzit të vonë dhe hekurit të hershëm. Midis vendbanimeve prehistorike të Kaonisë perëndimore në fazën e hekurit të hershëm duket se ndodh një diferencim i mëtejshëm ekonomik e shoqëror, rezultat i të cilës ishte veçimi i njërit prej tyre në rolin e qendrës duke u shndërruar më pas në qendra protourbane e urbane. Të vendosura gjeografikisht nga veriu në jug ato ishin për territorin e Bashkisë: Himara dhe Borshi. Duket se faktorë të brendshëm por edhe të jashtëm kanë diktuar fortifikimin e tyre.

Në rastin e Himarës dhe Borshit, vendbanimet e periudhës bronz-hekur, në vendosjen gjeografike të tyre qarkojnë e mbyllin territore që kanë potenciale burimesh natyrore duke krijuar mikrozona. Në përputhje me potencialet natyrore më të mëdha apo më të vogla të tyre duket se i përgjigjet edhe niveli i zhvillimit të qendrave urbane.



Figura 1: Vuno , Cipi-Vendbanim i Fortifikuar
Burimi: Foto nga eksperti I. Gjipali



Figura 2: Badher, Vëndbanim i fortifikuar prehistorik
Burimi: Foto nga eksperti I. Gjipali

2.2 Zonat e Mbrojtura arkeologjike




Figura 3: Harta Arkeologjike
Burimi: Bashkia Himarë

Porto Palermo (Himarë)

Në gjirin e Palermos në bregdetin e Jonit ndërmjet Himarës dhe Qeparoit ndodhet Kështjella e periudhës së vonë otomane e Porto Palermos, në një kep të vogël shkëmbor që lidh bregun e detit me një lagunë të vogël. Kështjella është e lidhur me kohën e sundimit të Ali Pashë Tepelenës dhe ruhet në gjendje shumë të mirë. Vendbanime më të hershme që lidhen me Porto Palermon janë dy vendbanime prehistorike të fortifikuara të Kukumit dhe Armeridhës (fortifikimi i të cilës nuk ruhet nga koha e bazës ushtarake që u ndërtua aty), që e kufizojnë kështjellën nga lindja dhe perëndimi. Vetë Porto Palermo si gjë e mbrojtur ka qenë shumë i përshtatshëm për port detar. Burimet e autorëve antikë e përmendin se ka shërbyer si port për qytetin antik të Himarës me pozicionimin e saj. Nuk është kryer ndonjë ekspeditë arkeologjike për kështjellën për të hetuar a ka pasur gjurmë të tjera më të hershme në territorin e kalasë apo në lagunë, por në kështjellë është gjetur qeramikë e periudhës qytetare.

Në periudhën që shërbeu si bazë detare ushtarake u bë nga pikat më të rëndësishme për mjetet ushtarake detare.

Për vlerat arkeologjike, historike të kalasë dhe të panoramës së veçantë që prezanton e bën një pikë me shumë vlerë për turizmin kulturor. Ambientet e ruajtura të Kalasë dhe pa ndonjë funksion aktualisht, e bën atë të përshtatshme për ngritjen e një muzeu. Është shpallur monument kulture në 1948.



Figura 4: Kukum dhe Porto Palermo
Burimi: Foto nga eksperti I. Gjipali

Karos (Qeparo-Himarë)

Vendbanimi i fortifikuar i Karosit ndodhet 490 m mbi nivelin e detit në një kreshtë me drejtim veri-jug përgjatë luginës së lumit Qeparo. Pllaja e kodrës së fshatit Qeparo është 1 km e gjatë dhe vazhdon përgjatë shpatit perëndimor. Shpati ka një kreshtë të thepisur në anët veriore, perëndimore me pamje nga lugina e lumit dhe përgjatë bregut verior. Në faqen lindore shpati është i butë dhe këtu është përqendruar vendbanimi kryesor.

Janë identifikuar linja të shumëfishta mbrojtjeje në brinjën lindore. Linja kryesore e mbrojtjes ndjek konturet natyrore dhe ka një hyrje të pozicionuar në qendër (me faqe nga lindja). Ky mur është 340 m i gjatë dhe 3 m i gjerë. Lartësia më e madhe e ruajtur është 1.5 m. Hyrja ka një hapje 1.8 m të gjerë. Mbas hyrjes janë shtuar dy linja mbrojtjeje për ta rforcuar atë. E para është një linjë mbrojtjeje në formë patkoi e ndërtuar rreth hyrjes. Mbas këtij trakti dy linja të tjera muresh sugjerojnë se një zonë e gjerë ishte mbyllur në një pjerrësi më të ulët.

Borsh (Himarë)

Vendbanimi i fortifikuar i Borshit ndodhet në majë të kodrës së Sopotit, 326 m mbi nivelin e detit në veri-perëndim të fshatit të sotëm modern të Borshit. Vendbanimi zotëron pamjen mbi vijën bregdetare dhe hyrjen e rrugës tregtare Joniane nëpërmjet ngushticës së Korfuzit. Vendbanimi kontrollon gjithashtu hyrjen për në

luginat e lumenjve të Shushicës dhe Çorrajt e cila të çon për në Mavrovë (*Olympen antike*) dhe territoret e Amantias.

Vendbanimi i fortifikuar i Gjashnjarit (Kalaja e Lukovës)

Gjendet në kodrën e Gjashnjarit pranë fshatit Lukovë në anën jugperëndimore të rrugës automobilistike dhe njihet edhe me emrin Kalaja e Lukovës. Ka lartësi 80 m mbi nivelin e detit, duke u veçuar nga të gjitha kodrat përreth. Në anën jugore bie thikë mbi përroin e Hundësovës i cili e lidh këtë zonë me atë të Lukovës. Në veri kufizohet me malin e Levanit, kurse në perëndim laget nga ujërat e detit Jon. Syprina e kodrës ka shtrirje gjatësore me drejtim lindje perëndim rreth 150 m, ndërsa gjerësia rreth 60 m.



Figura 5: Lukove, Vendbanim i Fortifikuar Gjashnjar
Burimi: Foto nga eksperti I. Gjipali

Manastiret në Kakome dhe Krorëz

Të dy pikat janë gjire bregdetare që shtrihen jugperëndim të fshatit të Nivic Bubarit dhe kanë pozicionim të veçuar nga gjithë ambienti përreth. Gjiret në fjalë përfaqësojnë nga plazhet më të bukura të Bregdetit Jon. Kjo siç duket ka ndihmuar për ngritjen e dy Manastireve të Shën Mërisë si në Kakome ashtu edhe në Krorëz, që përfaqësojnë edhe vlerat historike e religjioze të tyre. Manastiri i Krorëzës mund të vizitohet vetëm nëpërmjet një rrugice (shtegu) nga fshati i Nivicës, ndërsa nga deti mund të arrihet me anije nëpërmjet Sarandës. Është shpallur monument kulture në 1963.

2.2.1 Qendra Historike dhe Trashëgimia kulturore në Himarë Monumentet e kulturës




Figura 6: Harta e Shpërndarjes së Monumenteve të Kulturës në Himarë
Burimi: IMK

Ndertimet Fortifikuese-Kalaja e Himarës (Himarë)

Kalja e Himarës ngrihet mbi një kodër 140 m të lartë. Nga verilindja dhe juglindja gremina shërben si mbrojtje natyrore. Fortifikimi antik është ngritur mbi një fortifikim prehistorik të shek. VIII p.e.s, i cili ka përcaktuar linjën e mureve të kalasë. Muret antike janë të tipit poligonal i ndërthurur me trapezoidal, i cili rrethon kodrën nga vroilinja në vriperëndim duke lënë të pa fortifikuar pjesën e greminës, që ngrihet mbi përoin e Vishës. Nga verilindja, pas një kthese të lehtë dhe një dhëmbëzimki të vogël, vijon drejt për 140 m gjatësi. Në skajin juglindor muri kthehet me kënd të fortë për të vazhduar deri tek një kullë 6.3x3.7 m dhe 4 m e lartë. Hyrja mesjetare bri saj tregon se kulla shërbente për mbrojtjen e kullës antike. Nga ana veri-lindore muri antik arin deri në 2.50 m lartësi.




Figura 7: Kalaja e Himarës
Burimi:IMK

Objektet e Kultit-Kisha e Shën Mërisë së Athalit (Himarë)

Kisha e Shën Mërisë së Athalit është ndërtuar në një kodër rreth dy orë në lindje të qytetit të Himarës. Ajo është ndërtuar në vitin 1795. Kisha është e tipit bazilikë me tre nefë, me përmasa të brendshme 10,10x5,10 m. Nefet ndahen me harkada mbi kolona, të cilat krijojnë bërthama katërkëndëshe për shkak të lidhjes së tyre me muret anësore, të cilat janë të mbuluara me qemere cilindrike, me hapje ndaj nefit qëndror. Ambjenti i altarit ndahet nga një ikonostas prej muri mjaft të lartë, me tri hyrje.



Figura 8: Pamje nga Kisha e Shën Mërisë
Burimi:IMK

2.2.2 Trashëgimia kulturore në njësite administrative përbërëse

Monumentet e kulturës




Figura 9: Harta e Shpërndarjes së Monumenteve të Kulturës në njësitë administrative
Burimi: IMK

Objektet e Kultit- Kisha e Manastirit të Panaisë në Dhërmi

Kisha është ndërtuar në pjesën më të lartë të fshatit Dhërmi, dhe dikur ka qenë pjesë e një manastiri. Ajo përbëhet nga dy pjesë që dallohen nga njëra-tjetra, një mjedis drejtkëndësh në plan në anën perëndimore që shërben sot si naosi i kishës (14.40x8.10 m), dhe një kapelë në anën lindore. Pjesa e parë është një shtesë e vonë. Kapela është kuadratike në plan dhe mbulohet me kupolë mbi tambur. Në murin lindor është absida rrethore dhe dy nike anash saj. Veçori e kësaj kishe është se tamburi nuk mbështetet drejtpërdrejt në muret anësore, sepse kjo do ta vështirësonte ekuilibrin e forcave shtytëse për shkak të trashësisë së paktë të mureve. Pikërisht kjo mënyrë ndërtimi ka bërë që nga brenda kisha të ketë një sens të theksuar vertikaliteti. Muret nga jashtë janë të rafshëta dhe përfundojnë me frontone. Pjesa e brendshme e mureve të naosit është e pikturuar me afreska.

Muret e kishës përfundojnë me korniza me radhë tullash, të vendosura në formë dhëmbësharre. Në çdo fushë frontoni, është vizatuar me tulla nga një kryq me përmasa të goditura. Tamburi cilindrik dhe i ulët përfundon dhe ai me një radhë tullash. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje. Rrallë ka dhe tulla të vendosura njëra mbi tjetrën ndërmjet gurëve.



Figura 10: Pamje nga Kisha e Manastirit ;
Burimi: IMK



Kisha e Manastirit të Shën Mitrit

Kisha e Shën Spiridhonit (Vuno)

Kisha e shënë spiridhonit është ndërtuar në vitin 1778 dhe ka përmasa të brendshme 19.80 m. Ajo ndahet me dy harkada mbi kollona guri në tre nefe gjatësore, ndërsa një harkadë tërthore në pjesën perëndimore veçon endonarteksin dykatësh. Nefet anësore të naosit janë tepër të ngushtë, duke i dhënë më shumë hapësisë nefit qendror. Nefet dhe naosi kanë qënë të mbuluara me tavane druri. Ambjenti i altarit ndahet nga naosi me anë të një ikonostasi muri. Kisha ka hyrje në anën perëndimore, jugore dhe veriore. Në anën perëndimore kisha paraprihet nga një hajat me formë katrore në plan, me përmasa 6.30x9.50 dhe lartësi 3.80 m. Hajati është i hapur në tri anë me harkada mbi kollona të holla guri. Në anën lindore bazilika përfundon me një absidë gjysmërrethore.

Muratura e kishës është ndërtuar me gurë dhe është e veshur me një shtresë të hollë suvaje, duke lënë në dukje qoshet e mureve dhe shpatullat e dyerve dhe të dritareve, të punuar me gurë të gdhendur.



Figura 11: Kisha e Shën Spiridhonit
Burimi:IMK

Kisha e Ipapandisë

Kisha ka një formë tepër të zgjatur në plan, me përmasa 12.80x3.60 m. Ambjenti i altarit ndahet nga naosi me një ikonostas muri me dy hyrje. Bema ka absidë gjysmërrethore të nxjerrë jashtë, me përmasa të mëdha. Tavani i saj është i punuar me material druri dhe i zbukuruar me rozeta dhe afreska. Me afreska janë pikturuar dhe muret e naosit, altarit dhe ikonostasit. Kisha është e mbuluar me çati dyujëse. Muratura është ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje, pa vendosje të rregullta dhe e zhveshur nga përpunimi dekorativ.




Figura 12 : Pamje nga Kisha e Ipapandisë
Burimi: IMK

Banesa e Ali Pashë Qeparo (Qeparo, Himarë)

Kulla e Ali Pashës ose kulla e vlashajve ndodhet në fshatin Qeparo rreth 1 km nëveri të tij. Kulla trekatëshe (4.8x8 m) zhvillohet përbri mesit të ndërtimit dykatsh (5.45x8.60 m). Kompleksi në katin përdhe ka tre ambjente, prej të cilëve një llojë salle ndërlidhëse ku zhvillohen shkallët për në kat, përveç atyre dykatëshe që

gjithashtu të çojnë në kat. Kati i parë i banesës është një kalim i vetëm , i cili ishte me katin e ndërmjëm të kullës. Ky i fundit me shkallë të brendshme lidhet me katin e dytë. Dyshemeja e katit të dytë të banesës mbahej nga harkada mbi kolona guri.

Ky ndërtim shquan për një përpunim të kujdësoshëm, korniza karakteristike prej guri me motivet e njohura prej harkadash, si dhe kornizimi i dritareve me gurë të latuar rrisin vlerat e pamjeve të këtij ndërtimi.




Figura 13: Banesa e Ali Pashës, Qeparo-Himarë
Burimi: IMK

Ndërtimet inxhinierike, Ujësjetllësi- Ujësjetllësi i Vranishtit

Ndodhet në fshati Vranisht të Rrethit të Vlorës. Përbëhet nga dy pjesë. Ura numër një e punuar me një hark dhe ura numër dy mbështetur në 6 harqe dhe 5 dritare lehtësuese. Është ndërtuar në periudhën e Ali Pashë Tepelenës (fillim Shek. XIX) dhe shquhet për vlerat ndërtimore të një ujësjetllësi të ndërtuar nga mjeshtra vendas. Ujësjetllësi i Vranishtit është me trase horizontale.

Ujësjetllësi është i ndërtuar me gur kave dhe zall lumi të lidhur me llacë gelqereje.



Figura 14: Pamjet aktuale të Ujësjetllësit të Vranishtit
Burimi: Foto nga eksperti I. Gjipali

2.3 Sistemi Ujor

2.3.1 Trupat ujor dhe Deti

Duke u bazuar në veçoritë gjeomorfologjike, gjeologo-strukture dhe hidrogeologjike në zonën e hapësirës bregdetare Palasë-Sarandë veçohen nën-zonat:

- Riviera e Sipërme që përfshin nën-zonën Palasë-Qeparo.
- Riviera e Poshtme që përfshin nën-zonën nga Borshi në Sarandë.
- Nën-zona e Rivierës së Sipërme (Palasë-Porto Palermos) ka formacion karbonatik (gëlqerorë dhe dolomitë). Në rivierën e sipërme shtrihen dykomplekse ujëmbajtëse:

1. Kompleksi ujëmbajtës i formacionit karbonator.
2. Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të shkruftë kuaternare.

Brenda Rivierës së Sipërme veçojmë këto sektorë:

1. Sektori Palasë-Dhërmi.
2. Sektori Vuno-Himarë.

3. Sektori Porto Palermo-Qeparo.

Në sektorin *Palasë-Dhërmi* me sipërfaqe ujëmbledhëse rreth 21 km² burimet janë më të shumta në numër. Ato dalin kryesisht në kuota të larta (nga +60m deri në +1520m) dhe kanë prurje nga 0,5 -20l/sek (ka dalje edhe të një numri të madh burimesh me prurje nga 0.007-0.5 l/sek). Burimet kanë prurje të vogla për shkak të sipërfaqeve të vogla ujëmbledhës brenda sistemit karbonatik si burimet e Palasës, Vrisit të Dhërmiut, Shën Mërisë Dhërmi etj. Në sektorin *Vuno-Himarë dhe Palermo-Qeparo* me sipërfaqe respektivisht 66 dhe 32 km², të gjithë burimet dalin në kuota të ulëta të malit të Çikës me prurje relativisht të larta si ai i Potamit (200 l/sek) apo ai i Qeparoit (200 l/sek). Ujërat nëntokësore ushqehen edhe nga uji i bollshëm i shirave në sezonin përkatës si dhe nga uji nëntokësor i masivit karstik të lindjes.

Uji i pijshëm (burimet dhe puset). Në Bashkinë Himarë burimet e ujit të pijshëm janë të origjinave të ndryshme duke filluar nga ato me origjinë karstike, nëntokësore, ujërat në mjedisin e detar, burime të pasura minerale etj. Duke u bazuar në disa studime që lidhen me zonën ujërat janë të një cilësie të mirë dhe që mund të përdoren pasi kanë marrë trajtimin e duhur. Pjesa më e madhe e këtyre burimeve të ujit të pijshëm gjenden në fshatrat Pilur, Kudhes, Dhërmi, Vuno, Qeparo-fshat, Ilias, Jal, Borsh dhe Lukove dhe që praktikisht duke u nisur nga pozicioni i tyre ato mund të quhen të mbrojtura nga ndotësit e mundshëm pasi gjenden larg zonave urbane dhe atyre në zhvillim. Sidoqoftë mungon monitorimi dhe matjet e parametrave të ndryshëm sipas ligjit në fuqi si nga ana e Bashkisë ashtu edhe nga institucionet përgjegjëse. Analiza sporadike janë kryer për disa nga parametrat fiziko-kimik të burimeve të mësipërme, por që janë krejtësisht të pamjaftueshme për ta bërë ujin e këtyre fshatrave të pijshëm. Vetëm shtatë parametra janë matur nga 48 të tilla që duhen monitoruar në bazë të normave kombëtare dhe ndërkombëtare. Situata paraqitet më shqetësuese në burimet që ndodhen në Himarë, Livadh, Porto Palermo dhe Qeparo-fushë, pasi ato nuk plotësojnë kushtet e zonës sanitare. Furnizimi i rregull me ujë të pijshëm në të gjitha zonat paraqet vështirësi sidomos në sezonin veror. Në fshatin e Jalës nuk ka asnjë metër tubacion për ujin e pijshëm dhe çdo shtëpi e merr atë nëpërmjet puseve individualisht. Situata e furnizimit me ujë në qytetin e Himarës është e pakënaqshme si në cilësi ashtu edhe në sasi. Ujërat në zonë janë të rrezikuar edhe nga kripëzimi. Një burim uJOR i kërcënuar është ai që gjendet në pjesën veriore të Himarës, i cili gjendet në fushën e fshatit Livadh, në zonën e ullishtës ku uji ka një shije lehtësisht të kripur (efekti Venturi), pa erë dhe transparent. Ngarkesa mikrobike e tij mbetet për tu analizuar. Zona përreth ka ndërtime (kryesisht vila një dhe dy katërshe) në një distance rreth 100 metra larg. Ujërat e zeza të këtyre shtëpive derdhen në gropa septike të ndërtuara jo sipas standardeve ndërkombëtare, pa kurrfarë trajtimi paraprak. Në pjesën jugore të tij qyteti furnizohej nga pusi, i cili gjendej në Potam. Uji i pompuar ishte transparent, pa erë dhe me shije kripe (efekti Venturi) nga uji i detit. Ngarkesa mikrobike e tij mbetet për tu analizuar. Pranë këtij pusi, gjendja e

ndërtimeve (shumëkatëshe), e gropave septike të ndërtimeve të reja ishte edhe më e rëndë se ajo e pusit tjetër në Spile.



Figura 15: Puse në Potam dhe Livadh
Burimi: Foto nga Ekspertet

Përdorimi i detergjenteve nga hotelet dhe banoret, prania e mbetjeve të hedhura kudo, ekzistenca e disa fabrikave të vajit, asfaltit dhe të betonit (Pilur, Qeparo i Ri), etj. rrisin rrezikun e ndotjes jo vetëm të ujërave sipërfaqësor por edhe të atyre nëntokësore në territorin e Bashkisë Himarë. Gjithashtu mungesa e një rrjeti të veçantë të ujërave të zeza nga ato të bardha është një faktor që çon në mos funksionimin e mire të sistemit të ujërave të ndotura.




Figura 16: Shembuj të situatës mjedisore Bashkia Himarë; (Sipër/Majtas, Gropë septike), (Sipër/Djathtas, Humbje teknike e ujit), (Poshtë/Majtas, Plantacioni i ullinjve afër Pilurit), (Poshtë/Djathtas, Hedhja e mbeturinave afër lumit në Ilias)

Burimi: Foto nga Ekspertet

2.3.2 Lumenjtë dhe përrenjtë.

Lumenjtë dhe përrenjtë e zonës në përgjithësi burojnë nga malet dhe furnizohen edhe nga reshjet, pra shërbejnë edhe si ujëmbledhës, janë me një regjim të përkohshëm, pra prurjet janë më të mëdha në sezonin e reshjeve (pranverë, vjeshtë dhe dimër) dhe pothuajse thahen në sezonin e verës. Si të tillë mund të përmendim Përroin e Mollës që kalon pranë Pilurit dhe që përfundon në lumin e Kudhësit, lumin apo përroin e Kudhësit, i cili kalon pranë Kudhësit dhe përfundon në Qeparo-fushë dhe më pas përfundon në det në formën e deltës, duke sjellë mbetje urbane dhe aluvione. Gjithashtu mund të përmendim përroin e Koramit, në afërsi të Himarës i cili derdhet në det, Spile pranë portit. Përroi i Vishës krijon një luginë e cila kalon në anën veriore të Himarës Fshat dhe derdhet edhe ky në det. Po ashtu mund të përmendim përroin e Dhërmiut dhe atë të Ngjipesë; i pari përfundon në plazhin e Dhërmiut, të cilin e kanë devijuar nga shtrati i tij natyror duke u derdhur mbi rrugën që të çon në anën jugore të këtij plazhi, shkak i këtij devijimi janë ndërtimet e shumta dhe pa kriter në zonën e Dhërmiut; i dyti ai i Ngjipesë derdhet në gjirin me të njëjtin emër që ndodhet në veri të Plazhit të Jalit ku përfundon në formën e një delte duke sjellë edhe atje aluvione dhe edhe mbetjet urbane. Në zonën e Borshit gjendet përroi i Borshit i cili buron nga pjesa lindore e fshatit dhe derdhet në detin Jon. Ky përrua sikurse edhe të tjerët e kësaj zone është me më shumë uji në periudhën e dimrit dhe me më pak në verë. Përrenjtë e tjerë që gjenden larg fshatrave të banuar janë në gjendje natyrale të mirë dhe të pacenuar. Ekzistenca e këtyre përrenjve si dhe të tjerëve në hapësirën e bashkisë Himarë, ka pasur një impakt pozitiv mbi habitatet, ekosistemet, biodiversitetin dhe erozionin. Në ditët e sotme ata janë të kërcënuar nga shumë faktorë. Një nga faktorët kryesorë që po i ndot ata dita ditës është derdhja e plehrave në shtratin e tyre. Kjo ndodh pa përjashtim në të gjitha fshatrat e zonës por në mënyrë të veçantë në ato larg bregut të detit. Arsyeja kryesore e hedhjes së plehrave nga ana e banorëve të këtyre fshatrave nëpër përrenj është keq-menaxhimi i mbledhjes së këtyre plehrave nëpër këto fshatra.



Një faktor tjetër është se shpesh në shtratin e tyre apo shumë pranë janë ngritur gurore (Iljas, Vishë). Shfrytëzimi i shtratit jashtë kriterëve nga ana e kompanive që menaxhojnë guroret po i dëmton ato dhe ekosistemin (copëzim i habitateve) përreth tyre. Rasti i ish gurores në përroin e Qeparo-fushë mund të shërbejë si shembull i keq shfrytëzimit të luginave të këtyre lumenjve dhe sidomos të mënyrës së braktisjes së gurores pas përfundimit të punimeve nga ana e kompanisë së ndërtimit. (iii) Në disa fshatra (Kudhës, Qeparo fushë) disa fabrika të vogla vaji i derdhen mbetjet e tyre në shtratin e këtyre përrenjve ose shumë pranë tyre (Lumi i Kudhësit, përroi i Koramit). Rrezik tjetër është ndotja e mjedisit detar, pasi në ditët me reshje të rrëmbyeshme të gjitha këto mbetje urbane përfundojnë në det. Rrezik i mundshëm është edhe dëmtimi i biodiversitetit dhe në veçanti avifauna që e përdor ujën e këtyre përrenjve për të pirë. Ndërhyrjet e pa studiuar dhe ndotja e ujit mund të sjellë për një kohë të shkurtër edhe largimin dhe deri zhdukjen e disa zogjve.



Figura 17: Lumi i Kudhësit
Burimi: Foto nga Ekspertet



2.3.3 Mjedisi detar

Mjedisi detar përbëhet nga disa element të cilët duhen marrë në konsideratë për ta ruajtur atë. Qeveria Shqiptare përmes rregullore Nr.177 te 31.03.2005, përcakton qartë rregullat për ruajtjen e këtij mjedisi të rëndësishëm. Po kështu direktiva për detet (91/271/KKE; 98/15/KE e BE, ka përcaktuar qartë 11 deskriptorëve cilësie përmes të cilëve përshkruhet si duhet te jete gjendja e mjedisit te mire detar (SMM). Këta deskriptorë (*shkalla e mbrojtjes së biodiversiteti; prania e llojeve jo-indigjene që nuk e ndryshojnë forcërisht ekosistemin; masa e peshqve që tregtohen; masa e elementeve ushqyes të zinxhirit ushqimor që sigurojnë bollëk dhe riprodhim; shkalla e eutrofikimi; integriteti i fundit të detit siguron funksionimin e ekosistemit; ndryshimet e vazhdueshme të konditave hidrografike që nuk ndikojnë forcërisht mbi ekosistemin; përqendrimet e ndotësve që nuk sjellin efekt; niveli i ndotjes tek peshqit dhe prodhimet e tjera detare është të jetë në nivelin e lejuar; hedhja e mbeturinave në det nuk shkakton dëm*) mungon informacioni dhe të dhënat për pjesën më të madhe të duke e bërë të pamundur përcaktimin e gjendjes së këtij mjedisi të rëndësishëm. Sipas raportit të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2014 mjedisi detar dhe cilësia e disa prej plazheve në bashkinë Himarë paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Kategoria	Dhërmi(%)	Himarë(%)	Borsh(%)	Qeparoi(%)
A-cilësi e shkëlqyer	100	100	100	0
B-cilësi e mirë	0	0	0	0
C- cilësi e mjaftueshme	0	0	0	0
D- cilësi e keqe	0	0	0	100

Burimi : Raporti i mjedisit 2014

Monitorimi i plazheve të Qeparoit është bërë në dy pika dhe ka rezultuar cilësia D. Kjo për shkak të derdhjeve të ujrave të ndotura dhe të zeza të bizneseve dhe familjeve. Mjedisi detar është i lidhur ngushtë me turizmin, peshkimin, burimet ujore, lojërat e ujit dhe transporti




Figura 18: Rozeta disavjecare e dallgëzimit

Burimi: Instituti i Hidrologjisë

2.4 Sistem natyror

2.4.1 Biodiversiteti, Fauna & Flora, Pyjet dhe Natyra

Biodiversiteti detar- Mjedisi detar luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e bashkisë Himarë. Ky rol është i lidhur ngushtë me turizmin, peshkimin, burimet ujore, lojërat e ujit dhe transportin. Zhvillimi i zonës duhet të marrë parasysh rëndësinë e tij me qëllim që biodiversiteti dhe mjedisi të ruhen. Mjedisi detar në Bashkinë Himarë ka tre zona kryesore: a. *litorali i sipërm*; b. *litorali i mesëm*; c. *litorali i poshtëm*. *Litorali i sipërm* ndodhet mbi nivelin e baticës dhe dallohet një ngjyrë e errët nga Cyanobacteria dhe shtrihet vertikalisht nga 1m deri në 6m. Speciet karakteristike të saj janë; *Cyanophyceae sp.*, Gastropods *Littorina sp.* dhe Cirripeds *Chtamalus depressus*. *Litorali i mesëm* shtrihet rreth 1m vertikalisht midis vijës së baticës dhe zbaticës. Karakteristika kryesore e ujërave është prania e Coralligenous algae(*Lithophyllum sp*), të cilat shtrihen më shumë se 1m gjerësi. Ky formacion biogjenik është gjetur në Rrëza e Kanalit. Ato janë indikatorë të mirë biologjik për ndotjen sipërfaqësore dhe luhatjen e nivelit të detit, për këtë arsye për *Lithophyllum sp* kërkohet marrja e masave për mbrojtjen si një monument natyror. Specie të tjera interesante të kësaj zone janë *Lithophyllum lichenoides* që ushqehen me *Patella sp.* **Litorali i poshtëm** shtrihet deri në 45 m thellësi. Biocenoza më e rëndësishme e kësaj zone janë livadhet nënujore të barishtes detare *Poseidonia oceanica*. Livadhet me *Poseidonia* janë burimi ushqimor primar i litoralit(pra edhe i prodhimit të oksigjenit) dhe i biomasës si dhe një nga komunitetet detare më të larmishme me më shumë se 1000 specie algash, invertebrorësh dhe peshqish. Gjithashtu ato kontrollojnë edhe rrjedhjen e sedimentit detar duke dobësuar përmes rrënjëve të tyre fuqinë e dallgëve. Në këtë mënyrë livadhet e *Poseidonias* kontribuojnë jo vetëm në mbrojtjen nga erozioni detar por edhe në mbrojtjen e biodiversitetit detar. Prania apo mungesa e *Poseidonia oceanica* pasqyron cilësinë e ujërave të zonës. Duke pasur parasysh rëndësinë e saj, kjo specie mbrohet në shumë shtete të Mesdheut nga direktiva e BE për habitatet si një bio-indikator për ujërat e pandotura. Zhdukja e kësaj specie nga ujërat detare do të konsiderohej si një tragjedi ekologjike. Monitorimi i vazhdueshëm i livadheve të *Poseidonia oceanica* është mjaft i rëndësishëm për mjedisin detar.

Fauna- Bregu jugor Shqiptar ka po ashtu edhe një shumëllojshmëri e pasur faune ku ndër më kryesorët dallojmë:

Invertebrorët: Të dhënat për invertebrorët nuk janë të plota por sidoqoftë rreth 150 lloje insektesh (rreth 151 lloje të rendit Coleoptera dhe 93 lloje të rendit Lepidoptera);

Amfibët dhe reptilët: Në këtë zonë ka rreth 11 lloje Amfibesh (nga 15 që njihen në tërë vendin) dhe rreth 30 lloje Reptilësh (nga 37 lloje që njihen në vend). Kjo pasuri vjen nga shumëllojshmëria e habitateve në zonë dhe kushtet atmosferike. *Caretta caretta viziton shpesh bregun jugor*. Si lloje endemike mund të përmendim *Testudo marginata* dhe *Rana epeirotica*. Zogjtë, rreth 250 lloje zogjsh gjenden në këtë

zonë nga 330 të tillë në të gjithë vendin. Këtu gjejmë qukapik, mëllenja etj, pra lloje të zogjve të pyllit por edhe të livadheve;

Gjitarët: rreth 55 lloje nga 71 të tilla gjenden në këtë zonë, pavarësisht se mungojnë të dhënat e plota. Lakuriqë shpellash, mishngrënës dhe gjitarë të mëdhenj, gjitarë deti janë të pranishëm në zonë. (*Lutra lutra*, *Monachus monachus* dhe delfinët). 17 lloje gjitarësh i përkasin Listës së Kuqe të Gjitarëve të Kërcënuar në mbarë botën.

Flora- Bimësia në ultësira ose në pyjet gjithnjë të gjelbra dhe në shkurre, që shtrihet nga bregu deri në lartësinë 900 m. (mali Rrëza e Kanalit, Palasë-Himarë). (Assoc. Orno – *Quercetum ilicis*). Pyjet mesdhetare me pisha (Asoc. *Pistacio- Pinetum halepensis*), që nuk janë vendase për këtë zonë, (Assoc. *Pistacio- Pinetum halepensis*), që shtrihen nga Parku kombëtar i Llogorasë deri në lartësinë 400-500 nga niveli i detit(*Pinus halepensis*dhe më rrallë *Pinus pinea*). Komunitete bimore të dominuar nga *Euphorbia dendroides*, *Pistacia lentiscus* – *Allianca Oleo* – *Ceratonion* (Asoc. *Pistacxio* – *Euphorbietum dendroides*), *Ceratonion* (Assoc. *Pistacxio* – *Euphorbietum dendroides*). Kjo lloj bimësie gjendet vende-vende përgjatë Rreza e Kanalit- Porto Palermo pranë detit në lartësinë 50-100 m. Bimësia e ulet malore me lartësi 100 cm (Assoc. *Chrysopogono* – *Phlometum fruticosae*, Assoc. *Ericetum manipuliflorae*), që rritet mbi tokë të thatë dhe gëlqerore deri në lartësinë 900 m mbi nivelin e detit. Bimësia e gjendur nëpër rrëpira(pseudo-stepa) e dominuar nga *Brachypodium ramosum* (Asoc. *Brachypodium ramosi*), kjo bimësi është në degradim nga mbikullotja. Zonat me livadhe gjenden deri në lartësinë 900 m. (Dhërmi, Vuno, Ilias, Himarë, Qeparo etj). Zonat pyjore me lis gjetherënës (Asoc. *Quercetum frainetto*), që gjendet në faqen perëndimore të malit rrëza e Kanalit, Vuno-Himarë, nga 300 deri 500. Zona pyjore që mbizotëron *Quercus ithaburensis* subsp. *macrolepis* (që njihet edhe si lisi i Vlorës) dhe që mbulon 60-70% të sipërfaqes, me larësi 7 m; shkurre që mbulojnë 60%, dhe me lartësi 1-2 m; shtresë bari që mbulon 30% të sipërfaqes me lartësi 0,3 m; ky tip pylli gjendet në Himarë, Porto Palermo, në lartësinë 0-800 m. Pyjet me konifere malore (Asoc. *Pineto* – *Abietetum borissi-regis*), ku pemët mbulojnë 80-90% të sipërfaqes, shkurret 50-60% dhe bari 20%. Në lartësinë nga 750-1,300 m, *Quercus ithaburensis* subsp. *macrolepis* janë zëvendësuar nga Asoc. *Pineto* – *Abietetum borissi-regis*. Pyje të dominuar nga *Pinus leucodermis* (Asoc. *Pinetum leucodermis typicum*). Ky pyll dominohet nga *Pinus leucodermis* që shtrihen në lartësinë 1300-1,700 m.

2.4.2 Pyjet dhe natyra

Pyjet njësia administrative e Horë-Vranishtit ka sipërfaqen më të dendur me pyje kurse Lukova karakterizohet më shumë nga sipërfaqja e kullotave. Ky fenomen lidhet së shumëti me çështjen e legjislacionit për parandalimin e dëmtimeve të pyjeve, ku edhe pse ky legjislacion është në fuqi, vazhdon të mbetet mos zbatimi i këtij legjislacioni dhe gjithashtu niveli i ulët i ndërgjegjesimit të banorëve vendas. Përsa i përket sipërfaqes së pyjeve vihet re se pjesa më dërrmuese e përqëndruar në njësinë

administrative Horë-Vranisht përbëhet nga 8774 ha pyje dhe 1494 ha kullota. Pas njësisë Horë Vranisht vendine dytë për nga sipërfaqja e pyjeve e zë Himara me 7107 ha pyje. Shqipëria jugperëndimore është një zonë e traditave të qëndrueshme, mjedisi natyror me nje bukuri të madhe dhe një histori të gjatë që daton që nga kohët parahistorike, e cila është e dukshme përmes mbetjeve arkeologjike dhe monumenteve të epokave të ndryshme. Përveç burimeve të konsiderueshme natyrore dhe kulturore të vendosura brenda Bashkise Himare, ka dhe dy entitete veçanërisht të rëndësishme në afërsi: Parku Kombëtar i Llogarasë, në veri dhe Parkut Kombëtar dhe arkeologjik i Butrintit, në jug.

Mjedisi natyror – Mjedi natyror i Bashkis Himarë është pjesë e një zone më të gjerë peizazhit bregdetar, i cili formon një vazhdimësi mjedisore. Kjo njësi përfshin: në veri të Himarës Luginën e Orikumit, Gadishullin e Karaburunit dhe Parkun Kombetar te Llogarase. Në jug të Himarës fushat e Borshit, Lukoven, Kakomen, Sarandën, Butrintin dhe Kepin e Stillos. Zona karakterizohet nga një shumëllojshmëri e pasur dhe larmi të florës dhe faunës, pyje, kullota, plazhet dhe lagunat sigurojne habitate për një sere llojesh të rrezikuara. Plani i Menaxhimit të Integruar te Bregdetit (ICZMP), identifikon pesë fusha ekologjikisht të ndjeshme (ESA), domethënë zonat me bukuri natyrore, vlera historike dhe kulturore dhe biodiversitet te pasur: Gadishulli i Karaburunit; Kanioni i Vunoit; Porto Palermo; Plazhi i Kakomes; Butrinti. Dy prej tyre janë brënda Bashkise së Himares, ndërsa të tjerët janë gjithashtu në afërsi. Strategjia e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit (BSAP), e cila është miratuar nga Qeveria Shqiptare në vitin 1999 u identifikuan tetë zonat ekologjikisht të ndjeshme. Kjo listë përfshinë të gjitha fushat e përmendura më lart, me përjashtim të Kanionit te Vunoit.

Llogara- Orikum, Karaburun- Sazan- Radhime- Tragjas- Dukat (Vlora)
Kanioni i Gjipese (Himara)
Porto Palermo (Himara)
Peroi i Borshit (Himara)
Plazhi i Kakomes dhe Kepi i Qefalis (Lucova - Sarande)
Kanali i Cukes – plazhi i Ksamilit dhe ishujt (Sarande)
Liqeni i Butrintit dhe rrethinat (Sarande dhe Delvin)
Pagane- Kepi i Stillos dhe ishujt (Sarande)






Figura 19: Pisha Flamur
Burimi: Foto nga Ekspertet

Parku Kombëtar Llogara – Ky park kombëtar i klasifikuar si i tillë që prej vitit 1966 mbulon një sipërfaqe prej rreth një mijë hektar, në lartësi që variojnë nga 470 në 2.018 m mbi nivelin e detit gjendet rreth 40 km në jug të Vlorës, në kufijtë e bashkise Himarë, në mes të deteve Adriatik dhe Jon. Llogaraja ofron një florë të veçantë të pasur (lloje të ndryshme të pemëve pisha, bredhi dhe lloje te tjera pemësh) dhe faunës (duke përfshirë griffons, shqiponjat, ketrat, ujq, dhelpira, etj). Një rast veçanërisht interesant është "Pisha Flamur", një pemë pisha flamur në formë kurore, si rrjedhojë i erërave të forta. Llogaraja aktualisht është një destinacion i rëndësishëm turistik, me disa objekte turistike qendrimi dhe veprimtarie.

Zona e Bashkisë Himarë karakterizohet nga një biodiversitet tokësor i pasur me një numër të madh llojesh bimore dhe shtazore me një interes të madh shkencor, me vlera të mëdha ekonomike (bimë mjekësore, vajore, industriale, dekorative etj) si dhe ka një shumëllojshmëri të madhe të habitateve, e shoqëruar me një bimësi të një rëndësie të veçanta kombëtare. Flora e kësaj zone përfshin rreth 1,400 llojesh bimësh të larta (duke përfaqësuar rreth 42.4% të florës së Shqipërisë). Këtu gjenden gjithashtu rreth 68 lloje bimësh apo 21.3% të totalit të specieve të rralla dhe të rrezikuara të Shqipërisë (330).

2.4.3 Zonat e mbrojtura

Zonat e mbrojtura dhe të rëndësishme. Në Bashkinë e Himarës ka një numër të konsiderueshëm të zonave të mbrojtura dhe natyrore si dhe një numër monumentesh natyrore (Tabela 5). Këto monumente duhet të mbrohen me çdo kusht si një pasuri e madhe e zonës por edhe kombëtare si dhe duhet të pasurohen me zona të reja të mbrojtura në bazë të ligjeve në fuqi. Të gjitha këto monumente janë edhe një atraksion turistik i rëndësishëm për Bashkinë e Himarës.

Tabela 9: Monumentet Natyrore në Bashkinë Himarë	
<i>Bio-monumente</i>	<i>Gjeo-monumente</i>
Rrapi i Kosmarit-Kudhës	Mbihipja e Çikës
Rrapi i Palasës	Gjiri & shpellat e Gramës
Lisat e Pilurit	Shpella e Porto Palermos
Qiparisi i Kambanores së Kishës së Vunoit	Shpella e Piratëve (Dhërmi)
Ixuari i Borshit	Kanioni i Gjipes
Rrapi i Kroit të Madh Kuç	Bokërimat e Vunoit
Rrapi Laze (Tërbaç)	Delta e Përroit të Palasës
Rrepet e Buronjave	Ilqeti I Zarelit
Rrapi i Nivicës	Shpella e Odisesë
Rrapi i Shënvasisë	Shpella e Bilbilenjëve
Shkëputje tektonike e llojit shtytje (Borsh)	Vali i Vranishtit
Falëzë e vjetër (Borsh)	Gjiri i Kakomesë
	Shpella e Lukovës
	Burimet karstike të Fterës

Burimi: Ministria e Mjedisit







Figura 20: Shembuj të monumenteve natyrore në territorin e Bashkisë Himarë: (Sipër/Majtas, Kanioni i Gjipesë),
(Sipër/Djathtas, Bokërimat e Vunoit), (Poshtë/Majtas, Rrapi i Palasës)
Burimi: Foto nga Ekpertet



Shumë të rëndësishëm janë dhe llojet e ndryshme të peizazheve të cilat duhen mbrojtur me një status të veçantë, pasi përfaqësojnë një vlerë të madhe për zonën. Po ashtu një zonë e rëndësishme është edhe lugina që ndjek lumin e Kudhësit, e cila ka akoma shenja të viteve 80’ kur ajo ishte akoma e kultivuar. Rehabilitimi i saj do të ishte me interes të madh dhe të veçantë pasi ka një potencial të madh agroturistik për zonën duke krijuar edhe mundësi punësimi por edhe duke përmirësuar mjedisin e zonës. Një pamje magjepsë është edhe ajo e kodrave dhe livadheve që shtrihet në të

dyja anët e rrugës së vjetër automobilistike, e cila mund të shfrytëzohet për qëllime të shumta turistike.

2.4.4 Klima dhe cilësia e Ajrit

Klima e Bashkisë Himarë paraqet një veçanti për vetë shtrirjen e kësaj bashkie të re ku një pjesë e saj (në perëndim dhe në jug) shtrihen përgjatë bregut dhe pjesa tjetër mund të konsiderohet një zonë kodrinoro-malore. Në zonën bregdetare klima është tipike e një vendi mesdhetar, pra me verë të thatë e të nxehtë dhe dimër të ngrohtë dhe me reshje (shih figurën më poshtë). Fshatrat që shtrihen më larg detit si Pilur dhe Kudhësi etj në një lartësi 300-450 mbi nivelin e detit, për këtë arsye vera atje është më e freskët dhe dimri më i ftohët se sa në pjesën tjetër të bashkisë. Fshatra si Fterra, Kuci kanë një klimë malore. Këto karakteristika mund të shfrytëzohen për zhvillimin e turizmit në këto fshatra.




Figura 21: Harta me zonat dhe nënzonat klimatike e Shqipërisë
Burimi : Banka Boterore dhe UNDP, 2012

Zona ka një lagështi që arrin deri në 70%. Temperatura më e ulët është e regjistruar në zonë bregdetare në Janar 12°C, dhe më e larta 32°C, në muajt Korrik-Gusht. Temperatura absolute maksimale e detit arrin deri në 27,2 °C dhe minimale rreth 13,5 °C. Reshjet e shumta ushqejnë përrrenjtë dhe lumenjtë e zonës. Bashkia Himarë shtrihet në një zone klimaterike që karakterizohet nga rreshje të shumta 1200mm deri 1800mm rreshje shiu në vit. Rreshjet e dëborës janë të ralla dhe karakterizojnë zonat malore të kësaj bashkie.





Figura 22: Hartat e shpërndarjes vjetore të reshjeve
Burimi: Instituti Meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia



Legjenda: — më e larta; — mesatare; - - - më e ulëta).

Figura 23: Temperatura mesatare per 12 muajt e vitit
Burimi: ËMO

Gjatë gjithë vitit janë mesatarisht 106 ditë me diell dhe 190 ditë pjesërisht me re ose të vrenjtura. Pra, ka në total rreth 2,805 orë me diell në vit.




Figura 24: (majtas) Shpërndarja territoriale e sasisë vjetore të orëve me erë; dhe (djathtas) Harta territoriale e orëve me diell në territorin e zones në studim e më gjerë
Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia

Ndikimi i zhvillimit në ndryshimet e klimës. Konferenca e Parisit lidhur me ndryshimet klimaterike (Paris COP21-CMP11) e vuri theksin e saj në krijimin e kushteve për mosrritjen dhe kufizimin e temperaturës globale jo me më shumë se 2 gradë celsius. Në varësi të vlerave të faktorit klimaterik dhe të dhënave të siguruara nga studime të ndryshme lidhur me ecurinë në vite të këtyre vlerave mund të paraqiten disa skenarë për ndryshimet klimatike (modeli i ndjekur sipas MAGIC / SCENGEN; v. 5, 3, v 2).

Skenari bazuar në ecurinë e rritjes së **temperaturave mesatare**, jo vetëm në Shqipëri por edhe në mbarë globin, ndryshimet klimaterike të parashikuara do të sjellin një klimë më të ngrohtë në regjimin e temperaturës në zonat bregdetare shqiptare.

Skenari bazuar në rreshjet mesatare në rënie të regjistruara në stacione të ndryshme meteorologjike tregojnë një rënie të reshjeve vjetore në lidhje me mesataren e regjistruar në vitin 1990 si dhe një rritje të përmbytjeve si pasojë e rreshjeve të vrullshme. Duke përgjithësuar rezultatet e tyre rezultoi se sasia e reshjeve vjetore mund të ulen me 8,5% deri në 2050; dhe deri në 18,1% në 2100. Sigurisht që këto vlera do të sjellin ndryshime të konsiderueshme në klimën globale dhe për pasojë dhe atë shqiptare. Kombinimi i ndryshimeve të faktorëve klimaterikë do të sjellë disa pasoja të cilat janë të lidhura me :

- Rritjen e temperaturave minimale ditore e shoqëruar kjo me thatësira të zgjatura;
- Ngrohjen dhe shkurtimin e kohëzgjatjes së sezoneve të ftohta e cila do të ulë nevojat për konsum energjie për përdorim ngrohje;
- Parashikohet një rritje e numrit të ditëve me temperaturë mbi 35°C dhe me shira të rrëmbyeshëm do të sjellë përmbytje të zonave të ulta, pranë lumenjve dhe në bregdet kjo e fundit si pasojë edhe rritjes së nivelit të detit.
- Gjithashtu ngrohja globale do sjellë rritjen e temperaturës së tokës duke modifikuar periudhat e rritjes së të mbjellave p.sh zgjatja e periudhës së rritjes së të mbjellave është parashikuar të rritet me 26 ditë krahasuar me 1990 (shiko figurën 17 hartën e rritjes së temperaturës së tokës).
- Pavarësisht se parashikimet na paralajmërojnë për rreshje të vrullshme dhe të shkurtra, sasia totale e rreshjeve parashikohet të reduktohet për pasojë burimet ujore do të reduktohen në njëkohë që kërkesa për uji do të rritet (shiko figurën 18 për hartën e .
- Ndryshimi i regjimit të rreshjeve do të sjellë ndryshime të cilësisë së ujrave në tërësi dhe atij të pijshëm në veçanti;
- Sektori i turizmit është i ekspozuar në mënyrë direkte dhe indirekte ndaj këtyre ndryshimeve si pasojë e rritjes së nivelit të detit dhe acidifikimit të ujit të deteve. Po ashtu këto ndryshimet do të ndikojnë në biodiversitet duke dëmtuar eko dhe agro turizmin. Kjo do të sjelli sfida të reja për këtë sektor.
- Zona e rrezikuar duhet të parashikojnë me kohë investime në infrastrukturë për të përballuar ndryshimet.

Lidhur me *cilësinë e ajrit* raporti i mjedisit për vitin 2014-2015 nuk jep të dhëna mbi cilësinë e ajrit në Bashkinë e Himarës. Sidoqoftë duke iu referuar cilësisë së tij në qytetin e Vlorës ku monitorimet tregojnë se nuk ka asnjë nga elementët ndotës që e kalojnë normën e BE-së, ku dhe faktorët ndotës janë më të shumtë, mund të themi se cilësia e ajrit në Himarë si zonë bregdetare në përgjithësi është e mirë me përjashtim të rasteve të trafikut të rënduar në zonat bregdetare si Dhërmi, Himarë. Bashkia Himarë nuk futet në grupin e bashkive të industrializuara e për pasojë cilësia e ajrit mbetet të jetë më së paku e mirë. Cilësia e ajrit në Bashkinë Himarë do të

përcaktohet nga këta faktorë kryesorë: industria, transporti, mbetjet, pluhuri dhe pjesëzat si dhe ngrohja në periudhën e dimrit.

Numri i vogël i industrive që emetojnë ndotës në mjedis nuk duket të jetë problem për cilësinë e ajrit. Rreziku kryesor për ndotjen e ajrit mbetet ndërtimi, si një industri në rritje (PM₁₀, PM_{2.5}), transporti me ndotësit e tij (numri në rritje i automjeteve, automjetet e vjetra, cilësia jo e mirë e karburanteve (PM₁₀, SO₂, NO₂, Pb,) rrugët e pashtruara si dhe mbetjet (dioksina) e grumbulluara në disa zona si Ilias, Jal, Vishe.

Në fshatrat si Pilur, Kudhës, Qeparo-fshat, Vuno, Dhërmi, Himarë-Borsh, etj ku cilësia e ajrit është dukshëm e mirë, i vetmi problem që paraqitet është hedhja jo në vendin e caktuar e mbeturinave si dhe ngrohja me dru gjatë dimrit. Po ashtu djegia e kullotave shpeshherë sjell tymra që prishin cilësinë e ajrit në zonë. Faktorët kyç që ndikojnë në cilësinë e ajrit dhe në mjedis nuk sjellin ndonjë ndikim serioz në ndotjen e ajrit në zonë dhe për pasojë edhe për **shëndetin publik**. Numri i vogël i industrive ndotëse, trafiku i ulët dhe numri i vogël i rezidentëve për periudhën më të gjatë të vitit (pranverë, vjeshtë dhe dimër), biodiversiteti i lartë i bimësisë (bimësia e malit të Çikës) si dhe afërsi e deti Jon e përforcojnë edhe më tej këtë konkluzion.



Figura 25: Pamje nga Himara
Burimi: Foto nga eksperti


Gjithashtu edhe drejtimi i erës gjatë vitit ndihmon në pastrimin e ajrit pasi në përgjithësi gjatë verës kur edhe ndotja është më e madhe era fryn në drejtimin e detit dhe e kundërta në dimër, duke e mbajtur të pastër ajrin në zonat rezidenciale.

Si konkluzion, lidhur me cilësinë e ajrit në Bashkinë Himarë, mund të themi se akoma nuk përbën një problem por që sigurisht duhen marrë masat paraprake që kjo gjë të mos ndodhë as në të ardhmen me shtimin e presioneve të zhvillimit.

2.5 Sistemi Bujqësor

2.5.1 Boniteti i tokës

Toka bujqësore zë rreth 21,4% të totalit të sipërfaqes së tokës dhe më shumë është e përbërë me plantacione ullinjsh dhe disa pemtari. Vihet re se toka bujqësore është e mirë organizuar nga koha e socializmit. Tarracat e pjerrta janë gjëresisht të përhapura dhe të mbjella me ullinj, dhe vihet re edhe sot prezenca e sistemit të kullimit përgjatë tokës bujqësore (me kanale, rezervuare etj). Tokat bujqësore në fshatrat e luginës së Drinos në jug (Vranisht, Kallarat) janë kryesisht në formën e kultivimit të organizuar. Në pjesën bregdetare të bashkise këto zona janë më të pakta dhe në afërsi me vendbanimet, kryesisht përreth Palasë-Dhërmi dhe Himarë-Pilur. Zona paraqitet si një sistem tarracash me pemishte, një teknikë tradicionale që është përdorur gjëresisht nga regjimi i peridhës komuniste. Këto tarraca shtrihen përgjatë zonave bregdetare përreth Himarës së vjetër dhe veçanërisht në kodrat e Piqeresit, nga Borshi në Lukovë dhe janë të pasura me ullinj dhe agrume. Po ashtu, në Pilur dhe Kudhës gjenden vreshta dhe fermat me fruta në luginën e Borshit Për shkak të emigrimit dhe rënies së prodhimit bujqësor si edhe përqëndrimit të ekonomisë lokale drejt turizmit dhe ndërtimit, një pjesë e madhe e tokës bujqësore mbetet e pashfrytëzuar, ndërsa operimi i sistemeve të ujitjes mbetet e pasigurt.



Toka bujqësore pothuaj është privatizuar e gjitha gjatë vitit 1990 duke iu shpërndarë përdoruesve të saj të ardhshëm; me së shumti rezidente të Himarës dhe të ardhurve në atë kohë. Sot, pavarësisht dëmit në tokat bujqësore për shkak të zgjerimit urban dhe suburbanizimit, prodhimit të pakët dhe tokave bujqësore relativisht të kufizuara në krahasim me pjesën tjetër të Europës (24% në Shqipëri dhe 40.8% në BE), bujqësia ofron 25% të GDP e Shqipërisë (1.6 në BE). Toka, dheu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me funksionin si habitat, tërësi gjenesh, si mjedis i aktiviteteve të ndryshme njerëzore (ndërtim, bujqësi etj), si peizazh, trashëgimi si dhe një sigures

i lëndës së parë. Këto funksione janë të rëndësishme dhe duhen mbrojtur pasi ka një rëndësi të madhe për mjedisin por edhe për problemet social-ekonomike. Është e qartë se degradimi i dherave është me pasoja negative mbi shëndetin e njerëzve, ekosistemet dhe ndryshimet klimatike. Si ndërmjetës midis pjesës së brendshme të tokës, ajrit dhe ujit, dherat janë një burim i parinovueshëm që kryen funksione jetësore: ushqimi dhe prodhimi të biomasës, depozitimit, filtrimit dhe transformimit të shumë substancave duke përfshirë edhe ujin, karbonin dhe azotin. Është shumë e rëndësishme të adoptohet Direktiva Kuadër e BE për tokën me objektivat për mbrojtjen dhe ruajtjen e cilësisë në të gjithë zonën në studim.




Figura 26: (majtas) Harta e temperaturës së tokës deri 100 m; (djathtas)Harta e kategorive të tokave në zonë në studim dhe më gjerë
Burimi: Instituti i Studimit të tokave, 1985.

Përqindja e tokës urbane dhe asaj bujqësore është rreth 23% e totalit të tokës dhe në përgjithësi gjendja e saj paraqitet akoma e mirë. Raporti midis tokës së përdorur ndaj asaj totale është shumë i mirë dhe përbën një thesar për këtë zonë të studimit që duhet ruajtur. Është e nevojshme rritja e sipërfaqes së pyjeve për të minimizuar efektet e erozionit, për të ruajtur dhe krijuar habitate të reja si dhe për të kontribuar në cilësinë e peizazhit.

Sipas Planit të Integruar Ndërsektorial Bregdetar (PINSB), sektorit të bujqësisë në gjithë zonën bregdetare nga Vlora deri në Sarandë i jepet një potencial i madh. Fuqizimi i sistemit të tarracave mund të luajë një rol të rëndësishëm për qëllime turistike duke evidentuar karakterin mesdhetar të zones dhe ofrojnë produkte lokale jo vetëm për turistet por për gjithë territorin. PINSB propozon krijimin e një identitet në fushën e kulinarisë të zonës.

Bazuar në hartë e kategorive të tokave në Republikën e Shqipërisë hartuar nga Instituti i Studimit të tokave, në zonën e Bashkisë Himarë gjenden pothuajse të gjitha tipet e tyre. *Brezi i tokave të kafenjta malore* shtrihet në pjesët më të ulëta të maleve, nganjëherë fillojnë nga 300m mbi nivelin e detit dhe shfaqen në lartësi deri në 1000-1300m mbi nivelin e detit, shtrihen si në brezin e shkurreve ashtu edhe të dushkut. *Brezi i tokave të kafenjta pyjore*, shtrihet në brezin e ahut dhe të pishës, në pjesën e mesit dhe të sipërme të luginave lumore, duke zënë lartësinë nga 700-1699m mbi nivelin e detit. *Brezi i tokave kullotë malore* që rrisin dhe zhvillojnë brezin bimor të kullotave alpine, zakonisht vendosen mbi 1500-1700m dhe ndodhet nën ndikimin e një klime të ftohtë dhe të ashpër malore, të brezit të ahut, karakteristikë për pllajat malore veriore. *Brezi i toka pyjore të kafenjta është një* zonë me toka që përmbajnë më pak fosfor krahasuar me elementët e tjerë dhe kryesisht përfaqësohet nga toka pyjore të kafenjta, të cilat janë formuar sidomos nga magma ultra-alkaline TIC e shkëmbinj sedimentarë. Në bazë të strukturës kimike, tokat e zakonshme të tokave kafe pyjore kanë reagim neutral me tendencë aciditeti (pH 5,8-6,0), shkallë të lartë të ngopjes me alkaline (90-95%), përmbajtje të lartë të humusit, azotit (humus 12 - 14%, azotit 1,08-0,48) e kalium. Tokat pyjore kafe të pangopura alkaline janë formuar nga formacionet rërore dhe argjilore. Ato kanë karakteristika të përbashkëta me tokat e zakonshme pyjore, por ndryshojnë prej tyre nga aciditeti, nga shkalla më e ulët e ngopjes me alkaline (20-25%) dhe nga përmbajtja në sasi më të vogël të humusit (6-7 %) dhe azotit (0.35 %).

2.5.2 *Ekonomia bujqësore*

Bujqësia- Përpara viteve 90 bujqësia dhe blegtoaria dhe aktivitetet që lidheshin tërësisht me mbështetjen e këtij sektori ishte aktiviteti bazë i këtij rajoni, paverësisht nga potenciali i jashtëzakonshëm turistik që ofronte ky rajon. Ky zhvillim i njëanshëm vinte për faktin se Shqipëria në këtë periudhë ishte tërësisht e izoluar, dhe mungonte një infrastrukturë minimale për të vizituar këtë rajon. Tradicionalisht ky rajon është i shquar për prodhimin e agrumeve, ullirit, frutave të tjera dhe me pak vreshta, për vetë klimën mesdhetare dhe pozicionin gjeografik. Në vitin 1991 sipërfaqja me drejtim bujqësor e këtij rajoni llogaritet të jetë rreth 2,200 ha. Sot kjo sipërfaqe përdoret për destinacione të tjera duke e kufizuar mjaft sipërfaqen për kultivimin e kulturave bujqësore por edhe pemtarisë. Bashkia e Himarës dallon kryesisht për tiparin e saj në zhvillimin e ekonomisë të orientuar drejt turizmit, bujqësisë dhe agro-përpunimit. Këto veçanti ekonomike janë të zhvilluara sipas çdo njësie administrative duke ju përshtatur karakteristikave të tyre gjeografike, klimaterike dhe kulturore. Njësia

administrative e Himarës është një zonë me karakter tipik turistik por edhe e orientuar drejt prodhimeve lokale buqësore. Gjithashtu Himara dallon dhe për tiparin e saj agro-përpunues kryesisht të lidhur me prodhimin e vajit të ullirit dhe të likove.

Njësia administrative e Horë-Vranishtit për shkak të terrenit kryesisht malor, me pak tokë bujqësore, ka si drejtim kryesor të zhvillimit ekonomik blegtorinë dhe pemëtarinë. Për sektorin e bujqësisë siperfaqet totale të mbjella me drithra dhe bimë arë janë 439 ha ku peshën kryesore e zënë tokat e mbjella me foragjere të njoma në shërbim të blegtorisë. Sektori i pemëtarisë: pemë frutore 10620 rrënjë, ullinj 483 rrënjë vresht 8 ha. Në këtë njësi për shkak të llojit të bimësisë mund të zhvillohet mbledhja dhe përpunimi i bimëve medicinale, sherebelit dhe valanidhit. Zona është identifikuar si zonë që mund të zhvillojë agro – turizmin. Për këtë është përfshirë në programin e Luginës Ekologjike. Për shkak të burimeve ujore të përshtatëshme është në proces projektimi dhe ndërtimi i një H.E.C në Buronjë.

Njësia e Lukovës krahas turizmit llogarit ndër aktivitetet e rëndësishme ekonomike përpunimin e ullirit, etj. Fshati i Borshit dallon në kapacitetin e larta agro-përpunuese të vajit të ullirit duke u karakterizuar nga fabrikat dhe marka locale e zonës. Gjithashtu, fshati i Borshi dallon dhe për potencialet e larta që mbart në zhvillimin e turizmit. Këto aspekte i japin të drejtën për t'u paraqitur para syrit të turistit si pjesa më e bukur dhe e pa zbuluar e këtij bregdeti ku sot ka nisur të funksionojë një lloj turizmi familjar.

2.6 Sistemi infrastrukturor

2.6.1 Menaxhimi i mbetjeve dhe infrastruktura mjedisore

Gjendja e mbetjeve urbane dhe atyre të ndërtimit në Bashkinë e Himarës është kaotike. Kudo gjenden grumbullime plehrash të hedhura në vende të papërshtatshme (lugina, qytet, fshat, rrugë kombëtare, buzë detit etj.). Është i domosdoshëm pastrimi dhe largimi i tyre nga të gjitha pikat e përshkruara dhe të identifikuara nga specialistët në terren në raportet e mëparshme (Vishë, Ilias, Himarë, Qeparo, Jalë, Dhërmi, Porto Palermo, Gjipe, etj.) dhe depozitimi i tyre në zonën e përcaktuar (stacion transferimi) nga Bashkia Himarë pranë zonës industriale.

Ka grumbullime masive të këtyre mbetjeve në anë të rrugëve, në luginat e përrenjve dhe lumenjve, në lëndinat buzë detit etj., dhe gjendja e kazaneve të plehrave është e mjerueshme. pothuajse kudo ku ka dhe aty ku nuk ka fare, gjë që sjell një impakt negativ për turizmin dhe cilësinë e jetës në zonë. Mbetjet urbane do të grumbullohen fillimisht në stacionin tranzit (transferimi), ku pasi t'i nënshtrohen kompaktësimit (ngjeshjes), do të transportohen në landlillin rajonal në Bajkaj në afërsi të Delvinës, ndërsa mbetjet e ndërtimit mund të groposen në vendin e përcaktuar në Himarë. Zona e qytetit të Himarës ka një numër më të madh banorësh, ndërsa ato si Jala gjatë dimrit pothuaj nuk janë të banuara, por nga ana tjetër po këto qytete kanë më shumë banorë në sezonin e verës (qershor - shtator) se sa jashtë këtij sezoni (tetor - maj). Pra, skenari i transportimit të mbetjeve urbane ka dy pjesë: (1) atë të sezonit

veror dhe (2) jashtë sezonit. Në bazë të tabelës së mëposhtme edhe transporti i mbetjeve nga stacioni i përkohshëm për në vendgrumbullimin e Bajkajt mund të ndryshojë në bazë të sasive të sezonit perkatës. Llogaritjet janë bazuar në të dhënat e studimit të BB¹, ku mesatarja e prodhimit të mbetjeve nga ana e një njeriu në Shqipëri është rreth 0,7 kg/nj/ditë. Gjate sezonit të verës, ku maksimumi i prodhimit të mbetjeve arrin në 35 ton në ditë. Me një kamion me tonazh 10 ton dhe një vëllim prej afro 10 m³ do të mjaftonin 4 deri 5 transporte në ditë për të larguar nga stacioni i përkohshëm mbetjet urbane të grumbulluara. Jashtë sezonit kamioni mund të bëjë edhe 1 ose 2 rrugë çdo ditë.

Tabela 10: Përlllogaritjet e mbetjeve sipas sezonit						
Periudha	Banorë/ditë në Himarë (bashki)	Mbetje për banorë në ditë (kg/k/d)	Densiteti i mbetjeve pas ngjeshjes (ton/m³)	Mbetje për banorë në ditë (m³/k/d)	Total mbetje (ton/dite)	Vëllim total
(1) Sezoni veror (qershor - shtator)	75 000 (parashikuar 2015)	0.7	0.8	0.000875	35	43.75
(2)Jashtë sezonit (tetor -maj)	15 000 (parashikuar 2015)	0.7	0.8	0.003	12	15

Burimi: Bashkia Himarë, 2016

Trajtimi mbetjeve Në përgjithësi menaxhimi i mbetjeve jepet me sipërmarrje duke nënkontraktuar kompanitë private.

Njësia administrative Lukovë

E gjithë zona në studim ka të përcaktuara por jo të mirëstudiuara dy vende shkarkimi të mbetjeve urbane. Gjithashu është evidente një mungesë e strukturave të mirëfillta mbledhëse dhe shkarkuese në shumë zona të banuara.

Territori nën administrimin e ish komunës Lukovë përcaktohet si zonë e pastër dhe e pandotur. Në të gjithë territorin nuk ka të evidentuara zona me ndotje mbetëse të cilat janë zon të pakthyera në normalitet. Përsa i takon ndotjeve nga grumbullimi i mbetjeve urbane, ndonëse kjo përbën shqetësim, jemi në një fazë e cila është në proces si rezultat i funksionimit të Landfillit të Bajkajt si pjesë e planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve.

Për natyrën dhe relievin e zonës, nuk kemi të bëjmë me territore të cilat përmblyten qoftë edhe nga stuhitë me mot me shi. Zona për efekt të pjerrësive si gjatësore ashtu edhe tërthore të kombinuara me lugina të cilat përfundojnë në det bëjnë një menaxhim shumë të mirë të ujrave të shiut. Po ashtu edhe bregdeti nuk ka asnjë zonë të cilën e përmblytin dallgët e mëdha apo baticat.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta është i organizuar në mënyrë shumë të varfër. Depozitimi i pakkontrolluar i mbeturinave dhe hedhja e mbeturinave në zonën

bregdetare do të ketë një impakt negativ të pakthyesëm mbi potencialin e zhvillimit të turizmit.

2.6.2 Aksesi dhe rrjeti i transportit

Aksesi Ajror- Aksesi ajror ne Jug te vendit sigurohet në mënyrë indirekte - kryesisht për turistët ndërkombëtarë së pari nëpërmjet aeroportit të Tiranës dhe së dyti nëpërmjet aeroportit të Korfuzit - Greqi. Aeroporti i Tiranës, duke qenë i vetmi aeroport ndërkombëtar në vend, është i vendosur në një distancë prej 145km (2h5m) nga Vlora, 215km (3h50m) nga Himara, 280 km (4h30m) nga Saranda dhe 310km (4h55m) nga Konispoli, dhe nuk konsiderohet i përshtatshëm siç duhet për të mbuluar nevojat e udhëtimit të flukseve turistike ndërkombëtare të jugut te Shqiperise. Me negociimin e marrëveshjes në fund të 2015 - fillim të 2016, qeveria shqiptare aktualisht është në gjendje të zhvillojë aeroportet e tjera te tipt "laë cost", si në Sarandë dhe Vlorë, për të cilat janë konsideruar alternativat e operimit ne vendet ekzistuese.

Nga ana tjetër, aeroporti i Korfuzit - Greqi, edhe pse gjeografikisht më i afërt se aeroporti i Tiranës, nuk është shumë i aksesueshem per destinacionet e Himarës, Sarandës dhe Konispolit për një sërë arsyesh. Duhet te behen negociate te qeverrive bilaterale me qellim qe te te sugjerohen zgjidhje apo marreveshje sezonale apo vjetore per perdorimin e aeroportit per qytetet kufitare shqiptare. Duke pasur parasysh faktin që një pjesë e konsiderueshme e fluksit turistik ndërkombëtar, mund të vijë nga distanca mjaft të largëta nga Shqipëria, ku fluturimet ajrore janë alternativa kryesore e udhëtimit, nevoja për një aeroport në afërsi të bregdetit, në jugperëndim të Shqipërisë, për të shërbyer kryesisht në mënyrë sezonale (me fluturime charter), është e evidente. Siç tregohet në hartat e mëposhtme ka tashmë disa vendodhje të identifikuara me potencial përndërtim e aeroporteve të reja.

Saranda është vendi më i mundshëm për ndërtimin e aeroportit që i shërben pjesës jugore të Shqipërisë. Mundësia e një aeroporti në Sarandë është vlerësuar fillimisht në planin e zhvillimit të bregdetit të jugut në vitin 2008, ku janë shqyrtuar dy zona të ndryshme, siç tregohet në figurën 51. Në vijimësi me këtë studim fizibiliteti për zhvillimin e aeroportit në Sarandës është percaktuar me saktësi si ne harten poshte




Figura 27: Vendndodhja e aeroportit të Sarandës

Burimi: ICAO: LASR

Studimi i fizibilitetit të aeroportit të Sarandës përfshin elementet e mëposhtme:

- Shqyrtimi i sistemit të Transportit të Shqipërisë dhe zonës së ndikimit të aeroportit.
- Situata socio-ekonomike e vendit dhe zonës së ndikimit të aeroportit.
- Zhvillimet dhe perspektivat e transportit ajror në jug të Shqipërisë.
- Qëllimi i zhvillimit të aeroportit të Sarandës.
- Parashikimet e trafikut
- Masterplani dhe Vlerësimi CAPEX
- Modeli operacional dhe qëndrueshmëria ekonomiko/ financiare (hyrjet, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, modeli financiar)




Figura 28: Zonat e mundshme për zhvillimin e një aeroporti civil në Sarandë, Instituti i Studimeve te Transportit

Burimi: SCDP, 2008

Një aeroport në Sarandë do të ndryshojë tërësisht karakteristikat e rajonit duke siguruar një asset shumë të rëndësishëm për promovimin e zonës jo vetëm si një destinacion ndërkombëtar për turistët që mund udhëtojnë nga vende shumë larg nga Shqipëria, por edhe për fluturimet e brendshme të cilat mund të programohen nga Aeroporti i Tiranës si dhe nga aeroporti i Kukësit i cili është airporti i dytë civil në vend, aktualisht jo funksional. Qeveria shqiptare synon që të fillojnë negociatat për një marrëveshje koncesioni, në mënyrë që të reaktivizojnë operimin e këtij aeroporti. Siç është paraqitur në figurën 97 e cila paraqet varësinë ndërmjet distancës së udhëtimit dhe përqindjes për mënyrën e preferuar të udhëtimit. Opsioni i transportit ajror po bëhet gjithnjë e më popullor për distancat më të mëdha se 450 km krahasuar me atë me tren dhe më popullor për distancat më të mëdha se 600 km krahasuar me transportin rrugor. Edhe pse qyteti i Sarandës nuk është aq i madh sa disa qytete të tjera, aktualisht ka përqëndrimin më të lartë të hoteleve të cilat janë në gjendje të shërbejnë turistëve vendas dhe ndërkombëtarë të zonës.




Figura 29 : Varesia ndërmjet mënyrës së preferuar për të udhëtuar dhe distancës së udhëtimit

Burimi: SCDP, 2008

Studim i ngjashëm i fizibilitetit të aeroportit të Sarandës duhet bërë edhe për vende të tjera kandidate, si aeroporti i Vlorës e cili është duke u shqyrtuar si alternativë e dytë për të shërbyer jugut shqiptar. Mbas vleresimit dhe krahasimit të studimeve të fizibilitetit do të merret vendimi i duhur përfundimtar për vendodhjen e një aeroporti për sa kohë që nuk ka asnjë të tilla në jug. Vendndodhja e aeroportit të ri në Vlorë konsiderohet më afër me zonën e Novoselës. Aeroporti i vjetër i Vlorës (Fig. 99), i cili aktualisht është thuhet në zemër të qytetit, është pa rrjet të përshtatshëm rrugor dhe i rrethuar nga banesa informale.





Figura 30: Vendndodhja e aeroportit të Vlorës

Burimi: ICAO: LASR

Një aeroport në Vlorë/Novoselë do të promovojë zonën si një destinacion ndërkombëtar. Vlorë është aktualisht qyteti i tretë më i madh dhe i dytë më i pasur në aspektin e të ardhurave mesatare të popullsisë në Shqipëri. Në qytet vazhdojnë të bëhen shumë ndërtime dhe po ashtu shumë projekte tashmë janë miratuar duke pasur si objekt transformimin e Vlorës në një destinacion tërheqës turistik dhe bregdetin e saj në qendër referimi të të gjithë vendit.



Aksesi detar- Porti i Himarës ndodhet në pjesën kryesore të qytetit dhe në afërsi të një plazhi të rëndësishëm publik. Siç është përmendur tashmë, trafiku i pasagjerëve aktualisht nuk ekziston, ndërsa funksioni tregtar i këtij porti nuk krijon ndonjë problem serioz. Në këto kushte, aktualisht, nuk lind nevoja e zhvendosjes së portit nga vendndodhja e tij e tanishme. Megjithatë, mungesa e mbrojtjes së duhur nga erërat e jugut e bën të domosdoshëm ndërtimin e mbrojtjeve detare, në mënyrë që të sigurojnë funksionalitetin e duhur dhe të rriten elementet e sigurisë së portit. Në këtë

kontekst para marrjes se vendimeve për investime të tjera infrastrukturore në portin ekzistues, eshte e pershtatshme te vleresohen mundësitë dhe alternativat në lidhje me zhvendosjen e portit komercial brenda të njëjtit buxhet si për opsionin e ndërtimit infrastrukturës të nevojshme në portin ekzistues.

Flukset e pa planifikuara te mallrave detare të transportit kryhen kryesisht në portin e Vlorës dhe në portin e Sarandës, ndërkohë që flukset vogla kryhen në portin e Himarës dhe përbëjnë kryesisht transportin e materialeve të ndërtimit dhe të naftës . Zona e portit të Himarës është shumë e kufizuar, për shkak të vargmaleve të Logarasë dhe Cikes, si dhe për shkak të pranisë dominuese e portit fqinj të Vlorës, i cila praktikisht i shërben të gjithë Jugut të vendit, si dhe portit fqinj të Sarandës e cila përfshin një zone shumë më të mëdhe se porti i Himarës, duke përfshirë edhe zonën e Gjirokastrës

Aktualisht transporti detar në Himare kryhet në mënyrë indirekte, nëpërmjet lidhjeve detare mes Sarandës dhe Korfuzit, si dhe mes të Vlorës dhe Brindisit. Lidhja midis Sarandës dhe Korfuzit operon me një anije të rregullt me një kapacitet mbajtes prej katër automjeteve (koha e udhëtimit 90 min) dhe një anije të shpejtë (delfini fluturues), vetëm për pasagjerë (kohë të udhëtimit 30 min). Frekuenca është e limituar vetëm me një vajtje-ardhje në ditë nga të dyja anijet gjatë sezonit të pikut (nëntë muaj). Gjatë periudhës së verës të dy anijet shërbejnë me një frekuencë mesatare prej tre udhëtime në ditë. Transporti detar, ekziston si një lidhje ndërmjet Himarës dhe Korfuzit, që operon vetem gjatë sezonit të verës (dy muaj) dhe që ka është ndërprerë funksionimin disa vite më parë.

2.6.3 Rrjeti Infrastrukturor rrugor

Njësia administrative Himarë-Rrjeti infrastrukturor i njësisë administrative Himarë është i prekur nga ndikimet e investimeve dhe financimeve të jugut të Vlorës. Në këtë kuadër mund të theksojmë efektin pozitiv në segmentin Himarë - Qeparo i cili ndjek zhvillimet infrastrukturore nga jugu i Vlorës deri në Orikum ku nderhyn by-pass dhe bën shkurtimin dhe çlirimin e trafikut për destinacionin e Himarës. Kjo lidhje rrugore mund të konsiderohet e përshtatshme për aksesin në zonën e Himarës, duke patur parasysh karakterin malor të rajonit dhe përhapjen e vendbanimeve përgjatë këtij segmenti rrugor. Segmenti i rrugës ekzistuese malore, që nga Dukati deri në qytetin e Himarës, duhet të ketë vetëm funksion hyrës për në zonën e Himarës. Në të njëjtën kohë është duke u përgatitur gjithashtu projekti i “Rehabilitimit të rrugës së Lumit të Vlorës”, i cili përfshin rrugën që nis nga Vlora deri në bregdetin e Himarës si destinacion final. Faza e parë e ndërtimit të kësaj rruge përfshin punimet civile për rishtrimin e rrugës kryesore ekzistuese 74-Km Vlorë-Peshkepi-Qeparo (rreth 45 km jane ne kondicione shumë te keqia) dhe zgjerimin e saj në një rrugë me dy drejtime e gjërë 9 m (3.75m gjerësi + 0.75m) për çdo rrugë. Rruga do të mundësojë lidhjen e zonës me bregdetin e Himarës duke përmirësuar komunikim e ndërsjellë të këtyre dy territoreve me karakteristika të veçanta si dhe

do të ndikojë në zhvillimin e qëndrueshëm të gjithë zonës, veçanërisht të ish njësisë Vranisht.

Aksesi rrugor i zonës përgjatë rrugës të modernizuar Qeparo – Sarandë, mund të konsiderohet i përshtatshëm dhe pa probleme të veçanta. Kjo rrugë siguron lidhjen me njësitë administrative të Delvinës, Sarandës, Gjirokastrës, si edhe rajonet e veriut dhe Epirin e Greqisë.


Rrjeti dytësor - Gjendja e rrugëve dytësore të zonës është e keqe dhe me shumë dëmtime. Mbi bazën e inventarit të FSHZH-së mbi gjendjen e rrugëve, ndër segmentet rrugore më problematike përmendim: rruga nacionale - Kamp/Dhërmi (1.6 km); rruga Lekaj Terbac - K/Qafa e Shapkave Tërbaç (2.7 km); kthesa Pilurit - Pilur Fshat (4.2 km).

Në qytetin e Himarës, përgjatë bregdetit të qytetit, është në zbatim projekti 'Rehabilitimi i Shëtitorës anës detit' Shëtitorja do të vishet me elemente të arkitekturës tradicionale si edhe me elemente të ndryshme urbane me funksion rivitalizimit të tij. Kjo shëtitore do të trajtohet edhe me lulishte dhe elemente gjelbërimi.

Një shëtitore do të ndërtohet edhe në fshatin e Borshit dhe Lukovës. Në Qeparo është realizuar sistemi i infrastrukturës nëntokësore, ndërtimi i pedonales, ngritja e trotuareve dhe e sistemit të ndriçimit të hapësirave publike. Shëtitorja është ndërtuar me pllaka guri si dhe është përdorur guri tradicional i zonës për muret anësore të saj si edhe parkimi.



Rrjeti Rrugor, i Zonës Palasa Dhermiu Jale




Rrjeti Rrugor, të Zonës Himarë

Rrjeti Rrugor, të Zonës Qeparo

Lidhjet e linjave të ndryshme të transportit publik. Aktualisht nuk ekzistojnë linja të transportit publik dhe kjo sjell nevojën e studimit dhe përcaktimit të një plan transporti urban për të gjithë komunën i cili të përfshijë jo vetëm qendrat e banuara por edhe vendet e atraksionit dhe sitet kulturore.

Parkimet publike. Kryesisht në periudhën e verës çështja e parkimeve të automjeteve kthehet në një problem të vërtet për vizitorët, duke evidentuar faktin që në zonë nuk ka asnjë parkim formal të administruar nga pushteti vendor.



Rrjeti Rugor, Zones Lukove

2.6.4 Energjia dhe Telekomunikacioni

Furnizimi me energji elektrike

Përshkrim i përgjithshëm Bashkia Himarë- Furnizimi me energji është përgjegjësi e OSHE-së. Sistemi i shpërndarjes është relativisht i vjetër. Furnizimi me energji nuk është i rregullt por ajo që lehtësisht konstatohet është tensioni i ulët i energjisë fenomen që konstatohet kryesisht në zonat rurale të bashkisë, sidomos gjatë periudhës së verës. Gjatë bisedës me përfaqësuesit lokal u mesua se ka disa ndërhyrje të planifikuara të cilat synojnë përmirësimin e situatës. Në javët e ardhshme është planifikuar ndryshimi vetëm i linjës së transmetimit ajrore e cila do të përfundojë në dy muajt në vazhdim përpara sezonit turistik.

Segmenti Vlorë- Sarandë është një 'hallkë munguese' në rrjetin e transmetimit të tensionit të lartë. Është e qartë që linja 35 Kv nuk ka kapacitet për të mbështetur zhvillimin e ardhshëm të turizmit përgjatë bregdetit. Për më tepër kapaciteti prodhues ka nevojë për rritje dhe në veçanti, një kapacitet prodhues i pavarur nga prurjet e lumenjve është i nevojshëm për të siguruar një mbështetje energjetike alternative përgjatë gjithë vitit dhe të japë një mbështetje të madhe në zhvillimin e turizmit në rajonin bregdetar.

Meqënëse kemi të bëjmë me të njëjtin sistem dhe mbulim të furnizimit me energji elektrike për të katër bashkitë në studim, Vorë, Himarë, Sarandë, Konispol, po sjellim në vëmendje disa analiza të vecanta :

- 1. Zona e studimit, Bashkia Himarë,** mbulohet nga dy njësi prodhimi: Bistricë (për pjesën jugore nga Borshi në Ksamil) dhe Vlora për pjesën veriore (veriu i Borshit dhe Vlorës). Në shumë zona, rrjeti është i vjetër dhe akoma punon në kushte teknike antike me 35 Kv për tensionin e 'lartë' dhe 10 Kv për tensionin e 'mesëm'. Si rezultat, si pasojë e vjetërsisë së rrjetit dhe nënstacioneve, sistemi pëson humbje të mëdha.
Në këtë kuader është ndërmarrë Modifikimi i veçorive teknike të shpërndarjes (ndërtimi i dy linjave të tensionit të lartë nga 35 deri në 110 kV dhe të tensionit të mesëm nga 10 deri në 20 kV si dhe modifikimi i stacioneve).
- 2. Rehabilitimi i rrjetit të tensionit të ulët.**
Fuqizimi i nënstacionit 400/110 kV Zëmlak dhe zgjerimi i rrjetit 110 kV në zonën juglindore, gjithashtu ka mbyllur në unazë një pjesë të rrjetit ekzistues 110 kV. Në këto kushte krijohet mundësia e furnizimit të zonës Jugore, nëpërmjet fluksit të fuqisë që futet nga nënstacioni 400/110 kV i Zëmlakut. Për pasojë reduktohet fluksi i fuqisë që vjen nga linjat e largëta të rrjetit 220 kV, duke balancuar më mirë dhe vet unazën 220 kV të Jugut, që përbën një problem për sigurinë e furnizimit të një zone të gjerë.

Ndërkohë në fazë po bëhet ndërtimi i dy n/st 110 kV në zonën e bregut të detit Jon: Orikum dhe Himarë.



Telekomunikacioni Bashkia Himarë

Sot njesia administrative Himare ka central telefonik me 1000 numra/abonent dhe nje rrjet kabellor me kapacitet prej 1200 numrash, ku jane perdorur vetem 660 te tille. Rrjeti telefonik eshte cabllor, kryesisht ne linja tokesore bakri dhe pjeserisht me

ato ajrore. Alb telekomi ka hartuar projekte me qëllim futjen e shërbimeve të reja përveç thjesht ekzistences se telefonit, të tilla si interneti i shpejtë dhe televizionit kabllor. Për këtë qëllim është e nevojshme që të ndryshojë teknologjia ekzistuese e rrjeteve, zgjerimi dhe shtrirja e fibrave optike në mënyrë që të reduktohet gjatesia mesatare e linjave. Do të ndërtohen 3 Qendra (MSAN), respektivisht, ne Himare Fshat, Potam dhe Spille. Kapaciteti i synuar është rreth 3000 linja. Ky sherbim do te shtrihet gjithashtu ne Dhermi, Vuno, Qeparo, etj., duke ndertuar dhe ketu impiante te tilla. Per kete eshte e rendesishme, ndertimi i fibrave optike pergjate rruges Qeparo – Palase. Shih hartën e punimeve civile dhe instalimeve që së bashku do të përbejnë.

Aktualisht ka një mbulim shumë të kufizuar ngasistemi i AlbTelekom. Ky operator është në gjendje të mbulojë një pjesë të madhe të territorit të ish komunës vetëm me telefoninë valore. Përdorimi i kablllove optike për Internet dhe shërbime të tjera në gjendjen e tanishme mbulohen nga operatorë të fuqishëm mobile si T Mobile, Vodafone, Eagle dhe Plus.

3. Objektivat Kombëtare dhe Ndërkombëtare për një Zhvillim të Qëndrueshëm- Përfshirja e Objektivate në Plan

3.1 Hyrja

Hartimi i objektivate të VSM mundëson realizimin e një Plani që garanton një zhvillim të qëndrueshëm. Ecuria e procesit të VSM paralelisht me etapat e hartimit të Planit siguron një bashkëpunim frytdhënës midis këtyre instrumentave në drejtim të ruajtjes së parametrave mjedisorë të zonës në studim si dhe atyre të shëndetit publik. Këto objektiva hartohen në përputhje me ligjshmërinë kombëtare dhe ndërkombëtare duke mbajtur parasysh direktivat evropiane, konventat ndërkombëtare dhe dokumenta të tjera të rëndësishëm. Ligjet shqiptare dhe direktivat e ndryshme evropiane lidhur nga njëra anë me tokën, biodiversitetin, pyjet, ujin e pijshëm, detin, lumenjtë, liqenet, rezervuarët dhe nga ana tjetër ato për shëndetin publik kanë shërbyer si orientuese në hartimin e këtyre objektivate, meqenëse Shqipëria aspiro për të qenë anëtare e BE-së dhe të gjitha zhvillimet kombëtare dhe strategjitë mjedisore si dhe legjislacioni përkatës, janë të orientuar në drejtim të harmonizimit me politikat evropiane. Duke patur parasysh edhe rendësin ekologjike të zonës në studim (një numër të madh monumentesh natyrore dhe zonash të mbrojtura të kategorisë së II, III, IV dhe V) si dhe ndjeshmërinë e popullatës lidhur me ruajtjen e mjedisit janë marrë paasysh në radhë të parë ligji 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, ligji 10440/2011 për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” ligji 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, ligji nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, ligjit Nr.107/2014 për “Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” si dhe një numër ligjesh dhe rregulloresh të tjera të rëndësishme.

Gjithashtu dokumentet e strategjisë kombëtare kanë shërbyer si orientuese për përcaktimin e afateve kohore dhe të vlerave kufi të ndotësve të ndryshëm. Të gjitha së bashkë janë marrë në konsideratë për hartimin e objektivate dhe në vlerësimin e Planit të Bashkisë së re Himarë.

Seksioni 3.4, përmbledh disa nga këto objektiva. Bashkëveprimi i përmbledhjes së objektivate me objektivat e VSM është paraqitur në seksionin 3.5.

3.2 Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar

3.2.1 Objektivat kombëtare të mjedisit

Kuvendi i Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare kanë hartuar dhe miratuar tërësinë e ligjeve të mësipërme me qëllim përafrimin e kuadrit ligjor të lidhur me mjedisin me atë të BE-së si dhe mbrojtjen e tij. Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2013-2020 dhe draft-Strategjia Kombëtare për Mjedisin 2015-2025 janë dokumentet të rëndësishme që përcaktojnë drejtimet kryesore të politikave mjedisore që do të ndiqen nga institucionet ligj-zbatuese në harkun kohor të përcaktuar, politika të cilat janë të domosdoshme për ruajtjen dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës duke i siguruar kësaj të fundit standarte të njëjta me ato evropiane.

Këto dokumente japin edhe vlerat monetare të cilat do të shpenzohen në infrastrukturë për të plotësuar kushtet e vendosura nga legjislacioni por edhe nga detyrimet ndërkombëtare. Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur kushtet, afatet kohore, përcaktimi i vlerave prag për ndotësit e ndryshëm etj, të përcaktuara këto mbi bazën e dokumentave ndërkombëtare dhe kombëtarë.

a) Biodiversiteti dhe mbrojtja e natyrës

Një ndër objektivat më të rëndësishëm është “Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, i zonave dhe llojeve të mbrojtura, si dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe mjedisit në përputhje me angazhimet evropiane dhe ndërkombëtare.

Në fushën e mbrojtjes së natyrës është realizuar transpozimi i Direktivave kryesore të kësaj fushe, respektivisht Direktivës së Habitave dhe Direktivës së Shpendëve, duke arritur në një masë transpozimi mbi 85% për këto Direktiva. Është plotësuar kuadri ligjor në vite me direktivat e sipërpërmendura si: ligji “Për mbrojtjen e faunës së egër”, ligji “Për gjuetinë”, Amendimi i ligjit “Për zonat e Mbrojtura”, ligji “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të tregëtimit ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër”, amendimi i ligjit “Për biodiversitetin” si dhe një numër aktesh nënligjore në zbatim të tyre. Ruajtja dhe rritja e larmisë biologjike është synuar përmes rritjes së sipërfaqes së zonave të mbrojtura dhe mirëmenaxhimit të tyre. Është realizuar përgatitja e Planeve të Menaxhimit për 10 Zona të Mbrojtura dhe është në përfundim procesi i përgatitjes për 10 Zona të Mbrojtura të tjera. Gjithashtu është miratuar metodika standarte për hartimin e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura.

Sfidat për të ardhmen përfshijnë përgatitjen për identifikimin dhe ngritjen e rrjetit Natura 2000 të zonave të veçanta të ruajtjes me rëndësi për komunitetin evropian. Zbatimi i planeve të menaxhimit për ato Zona të Mbrojtura që kanë plane të miratuara. Forcimi i zbatimit të ligjit dhe ngritja e kapaciteteve administrative të stafit të administratave të zonave të mbrojtura dhe organeve të kontrollit për ruajtjen e florës dhe faunës së egër përbëjnë prioritet.

Një nga objektivat e realizuara të politikës në sektorin pyjor, nëpërmjet programeve të realizuara është arritur transferimi i pyjeve dhe kullotave drejt njësive të qeverisjes vendore për të siguruar gjithë përfshirjen duke i mbështetur ato me plane menaxhimi dhe punime pyllëzimi dhe përmirësimi në pyje. Sipërfaqja fondit pyjor kullosor e mbuluar me plane mbarështimi deri në vitin 2012, është rritur me 48% krahasuar me vitin 2007 nga punimet pyjore të kryera në 12.000 ha pyje të degraduar, erozioni është reduktuar me rreth 200.000 ton sedimente.

Për parandalimin e aktiviteteve të paligjshme nga ana e strukturave të Policisë Pyjore me masat e marra, janë ulur niveli i prerjeve të paligjshme në pyje, nga 8% në vitin 2007 në 55 % në vitin 2011. Siperfaqe të konsiderueshme të pyjeve aluvionale bregdetare po eliminohen çdo vit si rezultat i erozionit bregdetar i cili është mjaft aktiv. Sfidat për të ardhmen. Objektivat e ardhshëm do të jënë: (i) përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit europian në fushën e pyjeve dhe kullotave; (ii) rritja e kapaciteteve të menaxhimit të pyjeve Bashkiale nëpërmjet grandeve konkurruese dhe forcimit të kapaciteteve; (iii) përmirësimi i sistemit të informacionit dhe data bazës pyjore; (iv) forcimi i sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje; (v) përmirësimi i marrëdhënieve rajonale, aplikime të përbashkëta në programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive; (vii) aplikimi në programe kombëtare e ndërkombëtare për të siguruar një mbështetje të nevojshme për zhvillimin e pylltarisë në vend, dhe (viii) përfshirja e çështjeve të ndryshimeve klimatike në të gjithë aspektet e administrimit e menaxhimit të fondit pyjor.

Tabela 11: Masat përparësore për mbrojtjen e Biodiversitetit

Masat	Përshkrimi	Masat kryesore përparësore publike
B1	Forcimi i Kuadrit Ligjor për Mbrojtjen e Natyrës	Transpozimi i Direktivave kryesore të kësaj fushe duke arritur në një masë transpozimi mbi 85% për këto Direktiva në legjislacionin shqiptar
B2	Forcimi i Menaxhimit të Administratave të Mbrojtjes së Natyrës	Forcimi i Llogorasë dhe i Parku Kombëtar
B3	Zhvillimi i Planeve të Menaxhimit për të gjitha Zonat e Mbrojtura	Deri në 2020 përfundon procesi i përgatitjes për 10 Zona të tjera të Mbrojtura.
B4	Rritja e Menaxhimit të Zonave dhe Specieve të Mbrojtura	Krijimi i strukturave të plota të AKZM-së për e zonat e mbrojtura dhe përgatitjen për identifikimin dhe ngritjen e rrejtit Natura 2000 të zonave të vaçanta të ruajtjes me rëndësi për komunitetin evropian

B5	Zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur dhe Specieve	Sigurimi i objektivave për menaxhime zonës së mbrojtur dhe kontrolli nga ana e AKMZ.
B6	Integrimi i objektivave të Strategjisë së Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit në politikën e Shtetit	Sigurimin që udhëzuesi përmbledhës i instruksioneve i MMP&AU për Ministrinë kryesore të asistojë për integrimin e objektivave të biodiversitetit në sektorët strategjik si pjesë e procesit të VSM-së.
B7	Monitorimi i Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Informacionit	Administratat e zonave të mbrojtura me krijimin e AKZM do të kenë një lidhje të drejtpërdrejtë me Ministrinë e Mjedisit, si një agjenci e pavarur dhe e dedikuar në mbrojtjen e natyrës

Krijimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura më 2015, si një agjenci e pavarur dhe e dedikuar në mbrojtjen e natyrës, krijon premisa për akses më të lehtë dhe vizibilitet të administrative të zonave të mbrojtura, duke mundësuar aplikimin e drejtpërdrejtë dhe menaxhimin direkt të fondeve nga ky institucion.

b) Menaxhimi i Burimeve Ujore

Sigurimi i ujit të pijshëm për të gjithë popullatën; Mbrojtja e të gjithë burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Vizioni i Strategjisë Sektoriale e shërbimeve për ujin e pijshëm dhe kanalizimet periudhën 2011 - 2017 si dhe Strategjia e mjedisit për ujrën, reflekton situatën aktuale të Shqipërisë në lidhje me rritjen e investimeve të përgjithshme në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore në mënyrë që në fund të kësaj periudhe planifikimi të jetë arritur përmirësim i dukshëm në nivelin dhe cilësinë e shërbimeve, i perceptuar nga përdoruesi final. Investimet kapitale për sektorin UK për vitet 2016-2017 pritet të arrijë shifrën e afro 200 miliard lekëve. Vizioni i kësaj Strategjie Sektoriale synon hartimin e politikave të përshtatshme dhe angazhimin e fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimeve, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Evropian dhe me Objektivin e Zhvillimit të Mijëvjeçarit për qëndrueshmërinë e mjedisit.

Sektori i ujit është një nga elementet më të rëndësishëm të menaxhimit mjedisor. Kërkesat për një menaxhim të qëndrueshëm të ujit janë komplekse, teknikisht sfiduese dhe të shtrenjta. Situata në këtë sektor është e ngjashme me atë të menaxhimit të mbetjeve dhe për këtë arsye kalimi i përgjegjësisë për shërbimet Bashkiale po i transferohen autoriteteve lokale.

Në përgjithësi objektivat e strategjisë kombëtare për ujrak kanë si synim: Zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të sektorit të ujësjellës kanalizimeve; Orientimi i shërbimeve të ujit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove; Përmirësimin e drejtimit dhe rregullimit të sektorit; Investimet për rritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit; Progresin drejt harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me Direktivat e BE-së për Ujin; përmirësimin dhe forcimin e zbatimit të legjislacionit; forcimi i autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal; hartimi i planeve të menaxhimit të të gjithë baseneve të lumenjve si dhe krijimi i kadastres ujore elektronike; hartimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Ujërave; përfshirja e çështjeve të ndryshme klimatike në të gjithë dokumentet strategjike të administrimit të ujërave.

Arritja e objektivave të strategjisë për burimet ujore do të bëjë të mundur të arrihen treguesit e tabelës së mëposhtme:

Tabela 12: Objektivat paraprake të strategjisë së burimeve ujore		
Masat	Përshkrimi i Masave	Masat kryesore prioritare publike
MBU1	Sistemet efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit në sektorin e ujit	Mbështetje për ndërgjegjësimin e publikut dhe programet e Komunitetit të Arsimit në mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve ujore, përafrimi i plotë i Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/EEC, kontrole të vazhdueshme ndaj përdoruesve të burimeve ujore, për të siguruar miradministrimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre. Hartimi dhe përhapja e një Kontratë Tip për Dhënie të Shërbimeve Ndjekja dhe monitorimi i subjekteve të cilat shfrytëzojnë inertet lumore me leje të perkohshme, ndjekja dhe monitorimi i likuidimit të detyrimeve financiare të subjekteve, monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me MMPAU-ne.
MBU 2	Zbatimi i projekteve prioritare në sektorët e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza	Zbatimin e projekteve prioritare në fushën e ujit të pijshëm dhe të ujërave të zeza në rajone të ndryshme të vendit
MBU 3	Zhvillimi i programit afatgjatë të investimeve, strategjia financiare dhe zbatimi i një mekanizmi të fuqishëm për sektorët e ujit të pijshëm dhe të ujërave të zeza	Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve; Orientimi i ndërmarrjeve të ujësjellësit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove

MBU 4	Reduktimi i ndotjes së ujërave nëntokësore	Respektimi i kushteve të përcaktuara për të gjitha shkarkimet industriale dhe ato të ujërave të zeza për të kryer para-trajtimin e shkarkimeve - përmirësimin e kushteve të përdorimit të lejeve duke bërë pjesë të procesit të shqyrtimit të saj edhe sigurimin dhe para-trajtimin të gjitha ujërave të ndotur urban dhe industriale
MBU 5	Reduktimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësore	Forcimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Ujërave në rolin e vet si Sekretariat Teknik nën varësinë e Këshillit Kombëtar të Ujërave, si dhe i mbikëqyrjes së Agjencive të Baseneve të Lumenjve
MBU 6	Mbrojtja e ujërave nëntokësore	Monitorimi i vazhdueshëm i cilesisë së ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me MMPAU-ne.
MBU 7	Monitorimi i ujërave	Respektimi i kushteve të përcaktuara për të gjitha shkarkimet industriale dhe ato të ujërave të zeza dhe monitorimi i vazhdueshëm i cilesisë së ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me MMPAU-ne.

c) Mbrojtja e Tokës

Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës me qëllimin për ta bërë më pjellore, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja.

Problematika e tokës dhe e mbrojtjes së saj përfshin një spektër të gjerë çështjesh që në dokumentet e qeverisë shqiptare lidhen me tokën bujqësore, pyjet etj. Çështjet kyçe për mbrojtjen dhe menaxhimin e tokës mund të përshkruhen si më poshtë: Erozioni, lëndët organike, ndotja e tokës, tharja e tokës, kompaktësimi i tokës, zvogëlimi i biodiversitetit, kripëzimi, përmbytjet dhe rrëshqitjet e tokës.

Tetë çështjet kyçe janë grupuar në tre qëllime kryesore për mbrojtjen e tokës, duke shtuar edhe një për nevojën për informacion’ Më poshtë është tabela e qëllimeve dhe masave kryesore me qëllim përmbushjen e tyre:

Tabela 13: Objektivat për Mbrojtjen e Tokës

Objektiva	Përshkrimi i objektivave	Masat kryesore prioritare publike
MT1	Reduktimi i niveleve të erozionit të tokës dhe dëmeve të shkaktuara	Parandalimin e aktiviteteve te paligjshme nga ana e strukturave te Policisë Pyjore me masat administrative për të ulur nivelin e prerjeve të paligjshme në pyje dhe zbatimi i Planeve të Menaxhimit të kullotave malore për të lejuar zbatimin e shpejtë të rimbjelljes. Ulja e erozionit te ultësirës përmes zbatimit të masave për të minimizuar erozionin e tokës në Kodin e Praktikës së Mirë Bujqësore
MT2	Ruajtja e tokave bujqësore në gjendje të mirë mjedisore dhe bujqësore	Zbatimi i riciklimit dhe zbatimi i dispozitave të riciklimit për përdorimin e mbeturinave joorganike (urbane, ujërave të zeza, bujqësore, industriale) si pasurues të tokës në zonat me vlera të ulëta të lëndëve organike. Kufizimet në nivelet e lejuara të marrjes se ujit për ujitje në zonat e prekura, në mënyrë për të promovuar efikasitetin e ujitjes
MT3	Reduktimi i ndotjes së tokës	Zbatimi i CGAP gjithashtu do të mbulojnë çështjet e mirëmbajtjes së tokës dhe përdorimin agro-kimik
MT4	Sigurimi i disponueshmerisë së të dhënave të menaxhimit të tokës	Hartimi i planeve vendoret të bashkive

Në arritjen e këtyre qëllimeve, ka edhe një numër masash që referohen në Strategji në seksionet e tjera. Në mënyrë të veçantë masat në lidhje më cilësinë e ajrit dhe menaxhimin e mbetjeve që duhet të ndihmojnë në reduktimin e ndotjes së tokës. Lidhja midis mbrojtjes së tokës dhe menaxhimit të burimeve ujore është më direkte, në mënyrë të veçantë në lidhje me praktikën e ujitjes. Në një afat të gjatë kohor, nevojat për ujitje duhet të balancohen me objektivat e vendosura për Planin e Menaxhimit të Baseneve Ujore të Lumenjve.

Në veçanti këto plane do të duhet të rregullojnë:

- Prerjen ilegale te pemëve për qëllime tregtie – kjo do të bëhet e mundur përmes survejimit dhe forcimit të teknikave siç përshkruhen në ato në lidhje me gjuetinë ilegale.
- Prerja e drunjve për zjarr – kjo praktike duhet të minimizohet. Plani duhet të identifikojë burime të tjera alternative që të mund të ndihmojë autoritetet lokale për ta ndaluar këtë praktikë.

- Duhet të identifikohen në plan projektet për të stabilizuar rrëshqitjet e dheut dhe projekte për rimbjellje – kjo do të mundësohet përmes një procesi të shpejtë që është i përfshirë tek Fondi i Mjedisit
- Në tokat e ulëta bujqësore duhet të zbatohet rigorozisht praktika e Kodit te Bujqësisë së Mirë, me qëllim zvogëlimin e erozionit.

d) Cilësia e Ajrit

Përmirësimi i cilësisë së ajrit në mbarë Shqipërinë në përputhje me nivelet e standardeve të BE dhe OBSH.

Cilësia e ajrit në zonat kryesore urbane në shqipëri sipas SNM rezulton të ketë pësuar një përmirësim në krahasim me vitin 2007, deri në 67%. Një pjesë e treguesve që ndikojnë në cilësinë e ajrit rezultojnë të jenë brenda normave të lejuara kombëtare dhe të BE, ndërsa për dy treguesit $PM_{2,5}$ dhe PM_{10} , përputhshmëria me standartet europiane është e ulët, në vlerën 30% ndërsa treguesit e O_3 , dhe benzenit tejkalojnë me 1-5% standartet e BE.

Objektivi i përgjithshëm i qeverisë shqiptare është përmirësimi i cilësisë së ajrit, në mënyrë të veçantë në zonat urbane dhe përreth zonave industriale me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik, përputhjen me direktivat e BE dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të njohura në lidhje me cilësinë e ajrit dhe kontrollin e çlirimit të gazeve. Çështjet dhe tendencat kryesore që duhen adresuar për të arritur këto objektiva janë:

- Shkarkimi i gazeve i lidhur me transportin varet nga një numër faktorësh: lloji i karburantit që përdoret nga automjetet private/tregtare, numri i automjeteve, kilometrat e përshkuar, vjetërsia dhe lloji i motorit, mirëmbajtja dhe cilësia e tyre si dhe nga alternativat e transportit. Përveç automjeteve mund të shtojmë cilësinë e rrugëve që kontribuon në rritjen e sasisë së grimcave të pluhurit si dhe ato të automjeteve. Numri i automjeteve është rritur shumë gjatë këtyre 10 vjetëve dhe do rritet edhe më tej me rritjen ekonomike.
- Grimcat e pluhurit nga aktiviteti i ndërtimit dhe nga rrugët e pashtruara. Të dyja si ndërtimi edhe transporti priten të rriten me rritjen ekonomike.
- Ruajtja dhe shtimi i sipërfaqjeve të gjelbërta
- Shkarkimi i gazeve nga industria në përgjithësi ka rënë pasi pjesa më e madhe e industrive janë mbyllur, çlirimi i gazeve do mund të rritet përsëri me rritjen e ekonomisë, prodhimit industrial, dhe kërkesave për energji.
- Shkarkimi i gazeve rritet edhe si pasojë e djegieve të mbeturinave dhe përdorimit të djegësve për qëllime shtëpiake. Gjithashtu ka mungesë informacioni mbi cilësinë e ajrit gjë e cila duhet të rregullohet me rritjen e monitorimit.

Megjithë përpjekjet për të përmirësuar sistemin e monitorimit të cilësisë së ajrit, akoma ky sistem nuk plotëson standartet europiane për shkak të mungesës së

investimeve per blerjen e stacioneve te monitorimit, pajisjeve dhe reagenteve, koston per mirembajtjen dhe kalibrimin e tyre. Implementimi i plotë i legjislacionit të BE në këtë fushë nuk është e mundur brenda një kohe të shkurtër. Strategjia e adoptuar këtu ka për qëllim:

- Uljen e nivelit të çlirimit të gazeve nga burimet lëvizëse dhe ato fikse në nivelin e legjislacionit të BE.
- Përmirësimin e monitorimit për të siguruar informacion për të lehtësuar planet e menaxhimit të cilësisë së ajrit.
- Vendosjen e sistemit të planifikimit për menaxhimin e cilësisë së ajrit i cili do të përcaktojë dhe implementojë masat e nevojshme për të arritur standardet e cilësisë së ajrit.

Janë identifikuar pesë objektiva të përkohshme si të nevojshme për të arritur këtë objektivë të përgjithshëm. Për secilin prej tyre janë identifikuar një numër masash. Indikator kryesor i efektivitetit të këtyre synimeve do të jetë përmirësimi i cilësisë së ajrit i vlerësuar mbi bazën e rrjetit të monitorimeve.

Qeveria Shqiptare synon që deri në 2020 nëpërmjet zbatimit të ligjit, marrjes së masave dhe përmirësimit të infrastrukturës të rrisë me 43% krahasuar me nivelin 28% të vitit 2011, numrin e stacioneve të monitorimit të ajrit urban sipas standarteve të BE-së ndaj totalit të stacioneve të monitorimit, reduktim të niveleve kombetare të Nox me 15%, të PM₁₀ me 25%, të PM_{2,5} me 25% dhe të ruhen nivelet e SO₂ brenda vitit 2020 krahasuar me nivelet e vitit 2011 përkatësisht: për NO_x - 40 µ/ m³, për PM₁₀ - 83 µ/ m³, të PM_{2,5}-33 µ/ m³ dhe SO₂-8 µ/ m³.

Tabela 14: Cilësia e Ajrit

Masa	Përshkrimi	Masat kryesore prioritare publike
CA1	Monitorimi i cilësisë së ajrit në përputhje me kërkesat e KE-së	Forcimit të Sistemit Kombëtar të Monitorimit të ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër sipas standarteve evropiane
CA 2	Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve nga automjetet me motor	Forcimi i iniciativave mbi taksat e automjeteve për të patur një sistem automjetesh miqësore me mjedisin
CA 3	Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve nga instalimet industriale	Adoptimit plotësisht legjislacionit të BE për cilësinë e ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër (IPPC 96/61/EEC)

CA 4	Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve te pluhurit nga ndërtimet	Forcimi i zbatimit të legjislacionit; bashkepunimi me pushtetin vendor për miratimin dhe zbatimin e planeve te veprimit të cilësisë së ajrit
CA 5	Reduktimi i emetimeve të pluhurit nga burime të tjera duke përfshirë rrugët e pa asfaltuara, godinave jo industriale dhe zjarret e hapura	Plani për përmirësimin e infrastrukturës rrugore janë mbështetëse, përmirësimi i izolimit të ndërtesave, masat për efiçencën e energjisë

Nivelet shqiptare kombëtare për disa nga ndotësit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 15: Nivelet normale Kombëtare të elementeve të cilësisë së ajrit

Parametri mjedisor	Elementet	Niveli normal kombëtar (µg/m ³)
Ajër	pluhur	140
	PM ₁₀	70
	SO ₂	60
	NO ₂	60
	Ozoni	120
	Pb	1

e) Ndryshimet Klimaterike

Reduktimi i gazeve të efektit serë dhe ato të hollimit të shtresës së Ozonit duke kontribuar në parandalimin e ndryshimeve klimaterike

Shqipëria është anëtarësuar në Konventen Kuader te Kombeve te Bashkuara per Ndryshimet Klimatike, në Protokollin e Kiotos, dhe nuk ka detyrime të percaktuara për të reduktuar shkarkimet e gazeve serrë. Ne takimet e paleve te Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) te zhvilluara ne Kopenhagen COP 15, Kankun COP16 dhe në Durban, Shqipëria, si Palë në KKKBNK dhe Protokollit të Kiotos ka mbeshetur qendrimin e Bashkimit Evropian dhe komunitetin ndërkombëtar për të zbutur ndryshimet klimatike.

Shifrat e paraqitur në konferencën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuar për ndryshimet klimaterike të mbajtur në Paris 2015 (Paris COP21-CMP11) duke u bazuar në të dhënat e panelit Ndërqeveritar për ndryshimet klimatike sot në planetin tonë tregojnë se:

- Që prej vitit 1880 deri 2012, temperatura mesatare globale e planetit tokë është rritur me 0.85°C. Sigurisht që studimet e shumta të realizuara tregojnë një lidhje të fortë midis rritjes me një gradë (1°C) të temperaturës dhe rënies së prodhimit të drithrave me 5%. *Si pasojë e një klime më të ngrohtë misri, gruri dhe pjesa më e madhe e drithrave të tjera kanë patur një rënie të prodhimit vjetor të tyre në nivel global me një sasi përafërsisht prej 40 megatonesh (40 000 000 ton) duke filluar nga 1981 deri në 2002. Po ashtu temperatura e oqeanëve është ngritur, sasia e borës dhe e akullit është reduktuar dhe për pasojë niveli i ujit të deteve dhe oqeanëve është rritur me 19 cm në periudhën 1901 deri 2010. Sipërfaqja e Arktik-ut është zvogëluar për çdo dekadë që prej 1979 me një sipërfaqe sa 1.07 million km².*
- Bazuar në përqëndrimet e gazeve të efektit serë dhe të emetimit të tyre sot, *ka shumë të ngjarë që në fund të këtij shekulli temperatura globale të rritet me më shumë se 1.5°C krahasuar me 1850 deri 1900. Niveli i oqeanëve do të vazhdojë të rritet me 24-30cm deri në vitin 2065 dhe me 40-63cm deri 2100. Mjaft aspekte klimatike nuk do të ndryshojnë për disa shekuj që do pasojnë edhe po të ndaleshin këto emetime gazesh.*
- Emetimet globale të CO₂ janë rritur me afërsisht 50% që prej vitit 1990. Këto emetime janë rritur me shpejt midis viteve 2000 deri 2010 në krahasim me tre dekadat e mëparshme

Sidoqoftë konferenca theksoi se *akoma është e mundur sot që përmes politikave dhe përdorimit të teknologjive të reja, ndryshimit të sjelljes ndaj mjedisit do mund të kufizojmë rritjen globale mesatare të temperaturës me 2 gradë celsius në raport me periudhën e paraindustrializimit dhe se ndryshimet teknologjike dhe ato institucionale do të krijojnë mundësi që ngrohja globale të mos e kalojë këtë vlerë prag.*

Shkarkimi i gazeve të efektit serë ndodh si rezultat i disa aktiviteteve. Mjeti më i fuqishëm për reduktimin e këtij efekti mbetet reduktimi i shkarkimeve të këtyre gazeve, për këtë arsye duhet adresuar problemi i reduktimit të shkarkimeve duke e integruar objektivat dhe procesin e vendimmarrjes në një numër nivelesh:

- Qeverisje – në mënyrë të veçantë në strategjitë për energjinë, ekonominë dhe transportet për të përfshirë hapa për kufizimin e shkarkimeve.
- Industri dhe tregti –të inkurajohen për të qenë efektive në energji dhe në reduktimin e shkarkimeve.
- Individët- të inkurajohen për ta konsideruar si kriter në veprimet dhe blerjet e tyre çështjen e efektivitetit të energjisë.

Masat që duhen të ndërmerren do të duhet të shoqërohen nga instrumente ekonomike nëse janë efektive. Në mënyrë të veçantë janë të specifikuar masat e mëposhtme:

- Futja e taksës së Karbonit, të ardhurat e së cilës do të futen në Fondin e Mjedisit
- Fushata të vazhdueshme për reduktimin e numrit të lidhjeve të paautorizuara në rrjetin elektrik (nëse konsumatori nuk paguajnë atëherë nuk mund të ketë stimuj për reduktimin e përdorimit të energjisë).
- Zhvillimi dhe publikimi i Strategjisë afatgjate të Çmimeve të Energjisë, duke treguar tendencën e çmimeve të energjisë në një afat të mesëm- kjo do të publikohet që konsumatorët të kuptojnë përfitimet e investimeve në pajisje dhe në aktivitete duke hequr subvencionimet që ekzistojnë midis sektorëve shtëpiakë dhe jo shtëpiakë
- Fondi i Efiçencës Energjetike- ky do të jetë një grant program i një madhësi të vogël e të mesme që do të përdorë të ardhurat nga Taksa e Karbonit tek projektet e Fondit të Mjedisit- nga këshillat e Qendrës për Efiçencë në Energji.
- Ka një mori masash specifike, si ato për te specifikuar kufizimin në ambient të ndotjes së ajrit, që do të kontribuojnë në objektivin për reduktimin e emetimeve të gazeve. Këto janë masat që iu referuam më sipër:

Tabela 16: Ndryshimi i Klimës		
Masa	Përshkrimi	Masat kryesore prioritare publike
NK1	Minimizimi i emetimeve të gazeve të efektit serrë	Zbatim i kerkesave te Traktatit te Komunitetit te Energjise te ratifikuar nga Parlamenti; Zbatimi i kerkesave te legjislacionit per energjite e rinovueshme dhe eficiencies se energjise
NK2	Menaxhimi dhe reduktimi i emetimeve të substancave të shtresës së ozonit	Zbatimi i dispozitave të Konventës së Vjenës, Protokollit të Montrealit dhe ngritja e sistemit kombëtar të monitorimit, verifikimit dhe raportimit te gazeve

f) Menaxhimi mbetjeve

Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve aq sa të reduktohen rreziqet për shëndetin publik, mjedisin, dhe tregtinë në përputhje me kërkesat e BE.

Hartimi i Planit Kombëtar për menaxhimin e mbetjeve është një projekt për të ardhmen. Ai përcakton objektiva sfiduese, por realiste, për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në Shqipërisë. I ndërtuar mbi një angazhim fondesh të konsiderueshëm nga ana e Qeverisë Shqiptare për të transformuar praktikat e Shqipërisë për mbetjet, ai përcakton drejtimin e politikave të Qeverisë për administrimin e qëndrueshëm të mbetjeve gjatë 15 viteve të ardhshme (deri 2025).

Menaxhimi i mbetjeve në vend është akoma në një nivel të ulët pasi sistemet për grumbullimin e mbetjeve të ngurta janë pajisur vetëm qytetet, por jo zonat rurale, sasia e mbetjeve që riciklohet është 10%, mbetjet asgjësohen kryesisht në vend-grumbullimet e mbetjeve, nga industritë dhe ato shtëpiake), sistemi i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme është shumë i dobët dhe pjesa më e madhe e grumbullimit të mbetjeve kryhet nga sektori privat, gjithashtu edhe impiantet e riciklimit janë në pronësi të sektorit privat dhe ndërgjegjesimi i publikut për menaxhimin e mbetjeve është në nivele të ulëta.

Duke pasur si qëllim arritjen e nivelit të standardeve të BE dhe punën që nevojitet është bërë një punë e madhe për përputhjen me legjislacionin e BE. Ky Plan do të do të ngrejë kuadrin për një përtëritje të planeve lokale dhe rajonale. Politikat Kombëtare për Mbetjet dhe Strategjia përcaktojnë drejtimin e politikave të Qeverisë Shqiptare për vazhdimësinë e menaxhimit të mbetjeve në 2025. Politika nënvizon katër shtyllat kyçe të strategjive në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri si dhe mekanizmat e reja që janë prezantuar për të lehtësuar implementimin përmes këtij plani mbi politikën dhe objektivat strategjike të ekspozuara në Politikat Kombëtare për Mbetjet & Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve për Shqipërinë. MMPAU merr parasysh katër shtylla politike (PEBL), Planifikimin, Edukimin, Burimet & Legjislacionin në lidhje me implementimin e politikës dhe strategjisë nëpërmjet planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve.

Në Ndërtimin e një Shqipërie të Qëndrueshme Qeveria ka vendosur një objektiv të përgjithshëm për të siguruar përparimin drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve të Shqipërisë dhe arritjen e objektivave të Bashkimit Evropian në konvertimin e landfilleve në një metodologji të verifikueshme deri në vitin 2015, 2020 dhe 2025. Plani ka vendosur gjithashtu dy objektiva të përkohshme ku janë pasqyruar nevojat afatshkurtër për t'u përqëndruar mbi mbetjet bashkiake:

- për të rritur sasinë e mbetjeve të mbledhura nga autoritetet lokale të cilat janë ricikluar apo përzier në 25% deri në vitin 2015, dhe

- për të rritur sasinë e mbeturinave të mbledhura nga autoritetet lokale të cilat janë ricikluar apo përzier në 55% deri në 2020;

Në tabelën e mëposhtme janë disa nga objektivat më të rëndësishme të planit:

Tabela 17: Objektivat Kombëtare në Menaxhimin e Mbeturinave		
Masat	Përshkrimi	Masat kryesore prioritare publike
MM1	Përcaktimi i praktikave më të mira për menaxhimin e mbeturinave	Udhëzime për përgatitjen e planeve të menaxhimit të mbeturinave nga autoritetet lokale dhe rajonale dhe në standardet që do të aplikohen në përgatitjen e projekteve për menaxhimin e mbeturinave
MM2	Sistemi i planifikimit për menaxhimin e mbeturinave në vend në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar	Planifikimin, Edukimin, Burime njerëzore dhe përmirësim dhe përditësim i legjislacionit
MM3	Zbatimi i projekteve prioritare për menaxhimin e mbeturinave	Marrja e fondeve dhe zbatimi i projekteve prioritare mjedisore të investimeve për projektet e vendgrumbullimit të mbeturinave në Vlorë, Sarandë dhe Himarë Marrja e fondeve dhe zbatimi i projekteve prioritare mjedisore të investimeve për projektet e riciklimit të mbeturinave
MM4	Zbatimi i projekteve prioritare për menaxhimin e mbeturinave Faza II dhe III	Marrja e fondeve dhe zbatimi i projekteve prioritare mjedisore të investimeve për projektet e vend grumbullimit të mbeturinave- Faza II
MM5	Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme	Të ndalohet groposje e mbetjeve të rrezikshme dhe të aplikohen kërkesat për para trajtim të Direktives të Gorposjes. Plani kombëtar i menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme.
MM6	Plotësimi i kuadrit ligjor për menaxhimin e mbeturinave	Ligji i Menaxhimit të Mbeturinave
MM7	Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e mbeturinave në mënyrë që të nxisë sjellje të përgjegjshme	Fushata për të nxitur sjelljen miqësore ndaj mjedisit dhe përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave

g) Ndotja Akustike

Kontrolli i niveleve të zhurmës për sigurinë e popullatës nga to

SKM parashikon që të arrihet deri në 2020, 100% e perputhshmerise se kuadrit normativ me rregulloret e BE ne fushen e zhurmave dukesynuar njëkohësisht te reduktohet ndotja akustike me 20% ne zonat kryesore urbane, krahasuar me vitin 2012 (vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së ditës te reduktohen nga 70 dB (A) në 56 dB dhe vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së natës te reduktohen nga 55 dB (A) ne 45 dB(A);

Tabela 18: Objektivat për ndotjen akustike

Masa	Përshkrimi	Masat kryesore p rioritare publike
NA1	Minimizimi i zhurmave në mjediset e mbyllura	Forcimi i zbatimit të legjislacionit për zhurmën; forcimi i zbatimit të ligjit të bashkëjetesës
NA2	Menaxhimi dhe reduktimi i zhurmave në mjediset e hapura	Rritja e numrit të stacioneve të monitorimit të zhurmave; Studimi dhe Vleresimi i gjendjes së sinjalistikës rrugore dhe hekurudhore për zhurmën dhe p ropozimi i masave konkrete për nderhyrje

Nivelet e zhurmës janë të përfshira tek indikatorët që ndiqen nga Programi Kombëtar i Monitorimit (Vendimi No.103, datë 31/03/2003). Niveli i zhurmave është monitoruar dhe rezulton në përgjithësi nën nivelin që mund të dëmtojë shëndetin. Sidoqoftë, gjatë ditës në shumë qytete pragu normal tejkalohet, ndërsa gjatë natës në përgjithësi është poshtë këtij pragu, me përjashtim të Tiranës.

Niveli i zhurmave në ndërtesa është në përputhje me cilësitë strukturore të tyre. Ulja dhe reduktimi i zhurmave nuk janë objekt i projektimit në ndërtesat tona. Deri më sot shumë pak është bërë për të adresuar çështjet e lidhura me nivelin e zhurmave. Standardet e zhurmave nuk janë vendosur për një aktivitet apo pajisje specifike, me përjashtim të aviacionit.

Duke qenë se nivelet aktuale të zhurmave nuk janë aq akute për shëndetin publik si faktorët e tjerë, kjo çështje nuk është konsideruar si përparësore në një periudhë afatshkurtër. Pavarësisht, hapave për të kontrolluar zhurmat që do të ndërmerren në të ardhmen si në rastin e automjeteve që kalojnë në rrugë, si pjesë e masave për cilësinë e ajrit.

3.2.2 Objektivat kombëtare të planifikimit të territorit (Ligji 107/2014)

Që nga Korriku i vitit 2014, Shqipëria ka kthyer faqe të re në rrugën drejt arritjes së standardeve të BE në planifikimin hapësinor dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit në hyrjen në fuqi të **Ligjit 107/2014 për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit** dhe akteve nën ligjore, i cili zëvendëson Ligjin 10119/2011 *për Planifikimin Territorial*. Kjo strukturë e re ligjore krijon sistemin e planifikimit territorial të Shqipërisë nëpërmjet krijimit të dy institucioneve, si dhe instrumenteve dhe procedurave që karakterizojnë praktikën bashkëkohore të planifikimit Evropian dhe sistemit të menaxhimit të tokës. Kompetencat e planifikimit të territorit janë ndarë midis autoriteteve të planifikimit kombëtare dhe lokale.

Bazuar në këtë kuadër të ri, është paraparë që i gjithë territori i Shqipërisë do të pajiset me plane lokale që duhet të përgatiten nga njësitë e qeverisjes vendore qoftë në veçanti ose së bashku me njësi të tjera, për të gjithë territorin duke mbuluar kufijtë e tyre administrative. Planet lokale duhet të mbështesin qëllimin e mëposhtëm gjithëpërfshirës, siç thuhet në nenin 1, duke synuar:

Tabela 19: Planifikimi i Territorit	
Masat	Përshkrimi
PT1	Të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
PT2	Të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për: i) mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet; ii) krijimin e garantimin e territoreve të ndërtueshme, të organizuara në mënyrë të harmonizuar e funksionale, duke i dhënë përparësi hapësirës publike, mundësisë së banimit për të gjitha shtresat ekonomike e sociale, krijimit të infrastrukturës fizike të përshtatshme për nxitjen e investimit në ushtrimin e veprimtarive ekonomike, sociale e kulturore, lehtësimit të përdorimit të sigurt të shërbimeve e komoditeteve publike, të transportit, komunikimit dhe infrastrukturës, përfshirë territoret e përshtatura; iii) nxitjen e jetës ekonomike, shoqërore e kulturore në nivel kombëtar e vendor; iv) garantimin e burimeve të furnizimit të mjaftueshëm dhe veçanërisht atij jetësor; v) garantimin e kushteve të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare; vi) nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal për të siguruar shpërndarje të qëndrueshme të popullsisë në vend në bazë të burimeve

PT3	Të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;
PT4	Të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me dokumentet planifikuese dhe sipas legjislacionit mjedisor në fuqi;
PT5	Të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë;
PT6	Të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale;
PT7	Të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit;

Për më tepër siç shprehet dhe në Nenin 20, objektivat e *Planit të Përgjithshëm Vendor* duhet të jenë:

- a) *balancimi i nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në territor;*
- b) *krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor dhe sipas parimeve të këtij ligji;*
- c) *drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme;*
- ç) *rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetit e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;*
- d) *planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;*
- dh) *rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike e servituet publike, sipas këtij ligji;*
- e) *rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe, sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

2. *Plani i Përgjithshëm Vendor zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit.*

Plan i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin (PINS) do të shërbejë për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit bregdetar, duke mundësuar përdorim e balancuar të resurseve përgjatë vijës bregdetare me shtrirje veri- jug. Për një çështje lehtësie të menaxhimit të procesit, brezi bregdetar menaxhohet në 4 nënzona, sipas tipareve të ngjashme territoriale, por vizioni i zhvillimit dhe politikat e hartimit të Planit Ndër Sektorial të Turizmit Bregdetar do të shërbejnë si një “mbulesë” e vetme për të gjithë brezin bregdetar, dhe ç`është më e rëndësishmja, do të jenë të integruara me vizionin dhe politikat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.

- Zona 1: Velipojë – Derdhja e Lumit Mati

- Zona 2: Derdhja e Lumit Mat – Derdhja e Lumit Shkumbin
- Zona 3: Derdhja e Lumit Shkumbin – Derdhja e Lumit Vjosë
- Zona 4: Derdhja e Lumit Vjosë – Butrint (*zona e studimit tonë*)

Vizioni i shprehur sipas PINS Bregdetit është:

Bregdeti Shqipëtar si një aset i rëndësishëm kombëtar dhe pjesë e integruar e rrjetit Mesdhetar me një hapësirë të mirëmenaxhuar ku harmonizohen nevojat për zhvillim ekonomik dhe nevojat lokale me domosdoshmërinë mbrojtjes së asetëve kulturore, natyrore dhe historike duke u be re një destinacion autentik, i shumëllojshëm dhe i pastër.

Mungesa e deri tanishme e një PINS për bregdetin ka shkaktuar parcelizimin e planifikimit, aty ku kompetencat dhe juridiksionet territoriale ndahen. Për më tepër të gjitha planet vendore dhe ato rajonale (të pakta në numër), si dhe zhvillimet deri më sot, janë jetësuar pa rakorduar një vision të qartë rajonal, e aq më pak kombëtar. Ndaj, hartimi i PINS Bregdetit ishte një nevojë urgjente për të ndaluar përkeqësimin e situatës në territorin e bregdetit dhe jo vetëm.

Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin do të përfshijë të gjitha bashkitë e reja që preken nga brezi bregdetar tek të cilat përfshihen: Vlora, Himara, Saranda dhe Konispoli.

Si pasojë e sensibilitetit të menaxhimit të zonës bregdetare të Republikës së Shqipërisë, duke konsideruar rëndësinë e veçantë që ka ky territor si dhe duke marrë parasysh problematikat aktuale që shfaqen në administrimin e saj, nevojitet një menaxhim i integruar i kësaj zone, i cili mund të kryhet duke respektuar dhe vendosur objektiva të qarta, të cilat duhet të:

- *lehtësojnë përmes planifikimit racional, zhvillimin e qëndrueshëm të brezit bregdetar, duke siguruar që mjedisi dhe peisazhet të trajtohen në harmoni me zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor;*
- *ruajnë potencialin natyror të zonave bregdetare edhe për brezat e ardhshëm;*
- *sigurojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, veçanërisht në lidhje me përdorimin e ujit;*
- *sigurojnë ruajtjen e integritetit të ekosistemeve bregdetare, peisazheve dhe gjeomorfologjisë;*
- *parandalojnë dhe pakësojnë efektet e rreziqeve natyrore dhe në veçanti ato të ndryshimit të klimës, të cilat mund të shkaktohen nga faktorë fizikë apo aktivitetet njerëzore;*
- *vendosin koherencë ndërmjet iniciativave publike dhe private nga ana e autoriteteve publike, në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, të cilat ndikojnë në përdorimin e brezit bregdetar.*

Gjatë zbatimit të këtij “Protokolli Objektivash” palët do të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme të menaxhimit të integruar të brezit bregdetar:

- *Pasuritë biologjike, dinamiken natyrore dhe funksionimin e integruar të gjithë brezit duke plotësuar dhe ndërlidhur pjesët e natyrës detare me pjesët e tokës.*
- *Të gjitha elementet që lidhen me aspektet hidrologjike, gjeomorfologjike, klimatike, ekologjike, social-ekonomike dhe kulturore, sistemet që duhet të trajtohen në mënyrë të integruar pa tejkalluar kapacitetet dhe potencialet natyrore të zonave*

bregdetare, si dhe të parandalojnë efektet negative që mund të shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara prej aktiviteteve zhvillimore.

- *Duhet të zbatohet planifikimi dhe menaxhimi i ekosistemeve bregdetare në mënyrë që të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të brezit bregdetar.*
- *Qeveria duhet të sigurojë pjesëmarrjen dhe transparencën në këtë proces për të krijuar ura komunikimi gjatë vendimmarrjeve me komunitetet lokale dhe aktorët e shoqërisë civile.*
- *Organizmi ndër-sektorial i institucioneve të koordinuara (rajonale dhe lokale) për shërbime të ndryshme administrative në zonat bregdetare*
- *Formulimi i strategjive të përdorimit të tokës, planeve dhe programeve që mbulojnë zhvillimin urban dhe social-ekonomik, si dhe politikave të tjera sektoriale përkatëse të nevojshme për projektet rehabilituese ose zhvillimore.*
- *Duhet të merret në konsideratë shumëllojshmëria dhe diversiteti i aktiviteteve të shërbimeve përgjatë brezit bregdetar, prioritetet që do t'u jepen në raport me përdorimin dhe vendndodhjen.*
- *Të bëhen vlerësime paraprake të rreziqeve që lidhen me aktivitetet e ndryshme njerëzore dhe infrastrukturën, në mënyrë që të parandalohet dhe zvogëlohet ndikimi i tyre negativ në hapësirën bregdetare*

Tabela 20 : Përmbledhja e objektivave të Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin (PINS) është si më poshtë:

Urbanizimi BJ-1	Objektiva Sektoriale 1: Orientimi drejt një zhvillimi të qëndrueshëm urban Objektiva Sektoriale 2: Zhvillimit sipas arkitekturës tradicionale
Infrastruktura BJ-2	Objektiva Sektoriale 1: Aktivizimi i zonave potenciale përmes infrastrukturës së transportit publik të diversifikuar për turizëm Objektiva Sektoriale 2: Mbulimi i bregdetit me infrastrukturën primare
Energjia BJ-3	Objektiva Sektoriale 1: Përdorimi i energjive të rinovueshme Objektiva Sektoriale 2: Eficencë energjie në ndërtim
Ekonomia BJ-4	Objektiva Sektoriale 1: Rritje ekonomike per te qene zona më e zhvilluar në vend dhe një rajon turistik konkurrues në rajon Objektiva Sektoriale 2: Nxitje e avantazhit konkurrues
Turizmi BJ-5	Objektiva Sektoriale 1: Shndërrimi i bregdetit shqiptar në një destinacion unik Objektiva Sektoriale 2: Zgjatja e sezonit turistik
Bujqësia BJ-6	Objektiva Sektoriale 1: Kthimi i bujqësisë në një sektor primar në ekonominë e vendit Objektiva Sektoriale 2: Marketim të produktit lokal
Natyra BJ-7	Objektiva Sektoriale 1: Shtimi i zonave të mbrojtura mjedisore Objektiva Sektoriale 2: Mbrojtja nga erozioni, rrëshqitja dhe përmytja

3.3 Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar

3.3.1 Politikat ndërkombëtare

Shqipëria është një anëtare e organizatave ndërkombëtare dhe merr pjesë në konferenca dhe aktivitete shumëpalëshe të cilat synojnë të përmirësojnë trajtimin e mjedisit dhe gjendjen në nivel global të tij. Objektivat kryesore që Shqipëria kërkon të arrijë në këtë nivel janë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), të pranuar nga përfaqësuesit e 189 vendeve në Konferencën e OKB-së të vitit 2000, dhe synimeve të përcaktuara në Samitin Botëror të vitit 2002 për Zhvillim të Qëndrueshëm (SBZHQ) në Johaneshburg. Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm (Johaneshburg, 2002) ishte kulmi i një serie konferencash, duke përfshirë Konferencën e Stokholmit mbi Mjedisin në vitin 1972 dhe Konferencën e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin në vitin 1992 - e cila paraqiti parimin e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Takimi i parë ngriti shqetësimet e kanalizimeve, ku u vendos të merren masa për të siguruar që deri në vitin 2015 kjo mungesë e rëndësishme të jete reduktuar në 50% të niveleve aktuale. Angazhimi i dytë ishte që të ndërmerren masa për të rritur rezervat e peshkut në oqeanet deri në vitin 2015, ndërsa një rrjet global për mbrojtjen e zonave bregdetare duhet të jetë ngritur tre vjet më parë. Nuk kishte vendime të tjera të detyrueshme që kanë të bëjnë me çështje të tjera (demografike, varfërisë, mbi-shfrytëzimit të burimeve, të klimës, shpyllëzimi, ozonit, ujit, specieve të rrezikuara, erozionit të tokës dhe zvogëlimit të burimeve detare).

Tabela 21: Përmbledhje e objektiveve të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar

INT-1	Reduktimi i rrezikut për shëndetin publik
INT-2	Promovimin e barazisë sociale dhe të mirëqenies
INT-3	Promovimin e mjedisit të qëndrueshëm
INT-4	Përmirësimin e trajtimit të mbetjeve të ndotura ujore
INT-5	Mbrojtje, rritjen dhe rruajtjen mjedisit detar dhe zonës bregdetare

a. Politikat Ndërkombëtare

Shqipëria është anëtare e organizatave ndërkombëtare dhe merr pjesë në konferenca shumëpalëshe dhe vepron me synimin për të përmirësuar zhvillimin e mjedisit dhe gjendjen e mjedisit në nivel global. Objektivat kryesore që Shqipëria kërkon të arrijë në këtë nivel janë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), të pranuar nga përfaqësuesit e 189 vendeve në Konferencën e OKB-së vitit 2000, dhe detyrave të

përcaktuara në Samitin Botëror të vitit 2002 për Zhvillimin e Qëndrueshëm (ËSSD) në Johaneshburg.

Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm (Johaneshburg, 2002) ishte kulmi i një serie konferencash, duke përfshirë dhe Konferencën e Stokholmit mbi Mjedisin në vitin 1972 dhe Konferencën e Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin në vitin 1992 - i cili paraqiti parimin e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Angazhimi i parë ngriti shqetësimin e kanalizimeve, ku u vendos të merren masa për të siguruar që deri në vitin 2015 kjo mungesë e rëndësishme të reduktohet deri në 50% të niveleve aktuale. Angazhimi i dytë ishte që të ndërmerreshin masa për të rritur rezervat e peshkut në oqeanë deri në vitin 2015, ndërsa një rrjet global për mbrojtjen e zonave bregdetare duhet të jetë ngritur tre vjet më parë. Nuk janë bere vendime të detyrueshme, megjithatë për pjesën tjetër të çështjeve (demografike, varfërisë, mbishfrytëzimin të burimeve, të klimës, shpyllëzimi, ozonit, ujit, specieve të rrezikuara, erozionit të tokës dhe pakësimit të pasurive detare).

b. Politikat në nivel Evropian

Politika mjedisore e BE-së udhëhiqet nga parimi i parandalimit dhe parimi "ndotësi paguan", duke siguruar shumë instrumente institucionale, financiare dhe menaxheriale për të siguruar zbatimin efektiv të tyre. Pjesëmarrja qytetare është gjithashtu një element kyç dhe një prioritet i kësaj politike.

Sipas Marrëveshjes së Planit të Veprimit Mjedisor 6-të, Këshilli i Evropës është mbledhur për të përgatitur shtatë tematika strategjike, në mënyrë që të specifikojë objektivat dhe mjete e zbatimit në çdo zonë proritare; këto strategji prezantojnë në mënyrë esenciale gjeneratën e re të politikës mjedisore në Evrope.

1. Strategjia për ndotjen e ajrit (SKENA) vendos objektivat afat gjatë, duke synuar të reduktojë me 2020 (nivele të vitit 2000):

- Me 47% zvogëlimin normës së jetëgjatësisë influencuar nga ekspozimi ndaj grimcave;
 - Me 10% rastet e vdekshmërisë akute nga efekti i ozonit;
 - Përqendrimin e depozitimit të acidit me 74% në zonat pyjore dhe me 39% në ujërat sipërfaqësore;
 - Me 43% zonat e ekosistemeve ku shfaqet eutrofikimi
- Realizimi i këtyre objektivave kërkon një reduktim të shkarkimeve të SO₂ me 82%, NO_x (oksidit të nitrogjenit) me 60%, VOCs (komponentëve organik volatile) me 51%, amonit me 27% dhe PM_{2,5} fillestar (grimce e shkarkuar direkt në ajër) me 59%, krahasuar me normat e vitit 2000.

2. Strategjia për parandalimin e mbeturinave dhe riciklimin (SKEPMR) synon të reduktojë impaktin negativ mjedisor të mbetjeve gjatë të gjithë ciklit të jetës së tyre, nga prodhimi në depozitimin e tyre përfundimtar, nëpërmjet riciklimit. Kjo qasje lejon trajtimin e çdo lloj mbeturine jo vetëm si një burim i ndotjes e cila duhet të reduktohet, por edhe si një burim potencial i mundshëm për shfrytëzim. Objektivat e Komunitetit Evropian (vendosur përpara miratimit të kësaj strategjie) për zvogëlimin e mbeturinave, promovimin, ripërdorimin dhe riciklimin, janë ende të vlefshme. Një theks i veçantë i është kushtuar mbeturinave biodegraduese, dy të tretat e të cilave duhet t'i nënshtrohen formave të tjera të trajtimit, të tjera nga depozitimi, në përputhje me Direktivën 1999/31/EC. Strategjia parashikon veçanërisht dhënien e udhëzimeve përkatëse nga Komisioni, adaptimin e strategjive të menaxhimit nga ana e shteteve anëtare dhe përfshirjen e kësaj çështjeje në rishikimin e Direktivës IPPC dhe Direktivës për përdorimin e llumrave të ujërave të zeza në bujqësi.

3. Strategjia për mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar (SKEMKD) është përshkruar në Direktivën 2008/56/EC. Direktiva përcakton objektiva të përbashkëta mbi bazën e të cilave shtetet anëtare duhet të formulojnë strategjitë e tyre në bashkëpunim me shtetet e tjera anëtare dhe vendeve të treta, në mënyrë që të arrijnë një status të mirë ekologjik në ujërat detare nën juridiksionin e tyre. Për të arritur këto objektiva, shtetet anëtare duhet të bëjnë një vlerësim të gjendjes ekologjike të ujërave detare dhe ndikimin e veprimtarive njerëzore, duke përfshirë:

- Analizimin e karakteristikave bazë të ujit (karakteristikat natyrore dhe kimike, tipet e habitateve, specie e faunës dhe florës, etj);
- Analizimin e impaktit të aktivitetit njerëzor në karakteristikat e ujit (ndotjen nga produktet toksike, eutrofikimi, fragmentimin e habitateve, shkaktuar nga ndërtimi, futjen e specieve të reja, dëmtimet e shkaktuara nga ankorimi i anijeve, etj);
- Analizat ekonomike dhe sociale të ujit të përdoruar, dhe analiza e kostos së degradimit të mjedisit detar.

→ Në bazë të këtij vlerësimi, shtetet anëtare duhet të identifikojnë "status të mirë ekologjik" të ujërave detare (p.sh duke marrë në konsideratë shumëllojshmërinë biologjike, praninë e llojeve jo-autoktone, statusin shëndetësor të rezervave, eutrofikimi, përqendrimit e ndotësve, etj) dhe të vendosin objektivat dhe treguesit për të arritur këtë status. Këto objektiva duhet të jenë të matshme, dhe të shoqërohen nga afate të zbatimit, pastaj duhet të formulohet një program i masave konkrete për të arritur këto objektiva, duke marrë veçanërisht parasysh ndikimet socio-ekonomike të çdo mase të propozuar (nëpërmjet studimeve, VNM dhe me analizë kosto / përfitim.

4. Strategjia për mbrojtjen e tokës (SKEMT) vlerëson rëndësinë e ruajtjes së kualitetit të tokës dhe funksionet ekologjike të saj si një faktor kyç për të luftuar ndryshimin e klimës dhe për të parandaluar fenomenet e shkretëtirës që paraqesin një kërcënim të rëndë në të gjitha vendet e Mesdheut. Në këtë kontekst, strategjia e BE-së për mbrojtjen e tokës synon të parandalojë korrozionin, degradimin, ndotjen dhe shkretëtirëzimin. Kërcënimet kryesore të identifikuar janë:

- Erozioni, i cili shkaktohet nga një kombinim i faktorëve të tillë si shpatet e pjerrëta, klima, përdorimi i papërshtatshëm i tokës, llojet e bimësisë dhe katastrofat ekologjike;
- Reduktimi i materialit organik, për shkak të praktikave bujqësore dhe pyjore;
- Ndotja, nga lokalizimi (p.sh. minierat, vend-depozitimet e mbetjeve, industria, etj) dhe efektet (depozitimet atmosferike, të praktikave bujqësore, të riciklimit të papërshtatshme dhe trajtimin e ujit dhe ujërave të zeza, etj);
- Përdorimi i tokës, p.sh. toka për qëllime banimi, rrugë dhe aktivitete të tjera njerëzore të përcaktuara në kuadrin e planifikimit hapësinor;
- Kompaktësia e tokës, dmth presionin mekanik ushtruar në tokë nga trafiku i rëndë, mbi kullotja si dhe formave të caktuara të turizmit (të tilla si ski);
- Ulja e biodiversitetit të tokës, e shaktuar nga ulja e materies organike dhe përdorimi i disa praktikave bujqësore (të tilla si përdorim i gjerë i pesticideve);
- Kripëzimi, i cili është zakonisht i lidhur me praktikën e ujitjes dhe përbën një shkak të rëndësishëm për shkretëtirëzimin;
- Përmbytjet dhe rrëshqitjet, të shoqëruara direkt me pedologjinë dhe menaxhimin e tokës.

Sipas tematikave të strategjisë, mbrojtja efektive e dherave si një koncept i integruar dhe një rregullim dhe përmirësim i politikave aktuale. Në këtë kontekst, veprime për të adresuar rreziqet duhet të përfshijë:

- zhvillimin e një politike të përshtatshme mjedisore nëpërmjet zbatimit të Direktivave të BE (Direktivat për ndotjen nga Nitratet, Ujin, depozitimim e mbetjeve Spitalore, Mbrojtjen nga zjarret të pyjeve, etj);
- Zbatimin e një plani të qëndrueshëm territorial dhe praktikash të menaxhimit të tokës, sugjerimin në se është e nevojshme kufizimi i përdorimit të tokës;
- Politika të Përbashkëta Bujqësore (PPB), të cilat të sigurojnë mundësi për të përdorur praktika të qëndrueshme siç janë mbjelljet organike, mirëmbajtja e tarracave, menaxhimi i integruar i kulturave, etj;

→ Monitorimin e gjendjes së tokës dhe vlerësimin e faktorëve që formojnë rrezikshmërinë më të madhe për degradimin e dherave.

5. Strategjia në përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve krijuar në kuadër të strategjisë për mbrojtjen e tokës dhe ndjekja një politike koherente në përdorimin e pesticideve, duke ndihmuar në:

- Minimizimin e rrezikut shëndetësor dhe mjedisor nga përdorimi i pesticideve;
- Përmirëson kontrollin në përdorimin dhe shpërndarjen e pesticideve;
- Redukton sasinë e dëmeve të substancave të rrezikshme, veçanërisht me zëvendësimin e me të rrezikshmeve me alternativa më të sigurta;
- Inkurajon praktikat fermere me pak ose aspak përdorim pesticidesh;
- Realizon një sistem transparent për raportim dhe monitorimin e progresit drejt arritjes së objektivave strategjike.

6. Strategjia për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve, synon të promovojë një përdorim më efikas dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre. Objektivi kryesor është për të zbutur ndikimin mjedisor të përdorimit të burimeve natyrore (mbarimi i burimeve dhe ndotja), pa kompromentuar objektivat e strategjisë së Lisbonës për zhvillimin ekonomik dhe punësimin. Për këtë qëllim, strategjia synon të përmirësojë efikasitetin e burimeve, zbutjen e ndikimeve mjedisore të lidhura me të dhe të zëvendësojë ndotësit e rëndë të burimeve me alternativa të tjera por edhe propozon krijimin e një Qendre të Dhënash për burimet natyrore (të menaxhuara nga Komisioni), në mënyrë që të forcojnë njohuritë në lidhje me përdorimin e burimeve dhe ndikimin e tyre mjedisor dhe të lehtësojnë shkëmbimin dhe shpërndarjen e informacionit për hartuesit e politikave.

7. Strategjia për mjedisin urban, i cili është direkt i lidhur me qëllimin e Planit të zonës në studim, ndihmon në kontributin për përmirësimet të përgjithshme të performancës mjedisore të një qyteti Evropian, nëpërmjet reduktimit të burokracisë, rritjen e eficiencës në zbatimin e politikave mjedisore dhe inkurajimin afat gjatë të planifikimit mjedisor. Duke pranuar që qytetet dhe planifikimet e përshtatshme të qyteteve kanë një rol të rëndësishëm në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, zbutjen e lëshimit të gazeve serrë, ruajtjen e hapësirës sub-urbane dhe habitateve natyrore, përdorimi i mençur e burimeve natyrore, përmirësimin e shëndetit publik dhe cilësisë së jetës, etj, janë propozuar një sërë masash për të cilat Komuniteti duhet të ofrojë udhëzime,

- Menaxhim i Integruar i Mjedisit, duke u përqendruar në objektivat e përcaktuara qartë, pranimin e përgjegjësive, procedurat për monitorimin e progresit, për konsultimin publik, si dhe për rishikimin, auditimin dhe raportimin; rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe mbështetjen e shkëmbimit të praktikave më të mira në Evropë;
- Plane të qëndrueshme të transportit urban; zbatimi i gjerë i planeve të tilla, së bashku me masat specifike për nxitjen e energjisë-efikase tek automjetet me emetime të ulëta të CO₂, do të ndihmojë për të ulur emetimet e gazit serrë në nivel lokal, për më tepër, këto plane do të ndihmojë në uljen e ndotjes së ajrit dhe zhurmave duke inkurajuar përdorimin e biçikletave dhe ecjeve në këmbë, duke përmirësuar shëndetin dhe reduktuar shëndoshjen e tepërt;
- Ndërtimin e metodave të qëndrueshme - bioklimatike, për të përmirësuar efikasitetin e energjisë dhe për të zvogëluar emetimet e CO₂, nxitjen e komoditetit, sigurinë, aksesibilitetin dhe për të zvogëluar ndikimin në shëndet të ajrit të ndotur brenda dhe jashtë ndërtesave (sidomos nga grimcat e emetuara nga sistemet e ngrohjes);
- Zhvillim urban të qëndrueshëm dhe planifikim i përdorimit të tokës; parandalimi i shtrirjes urbane (dmth nëpërmjet densitetit të lartë dhe ndërtesave të përdorimit të përziera në zonat urbane), ofron një sërë avantazhesh mjedisore si një faktor kyç për mbrojtjen e habitatit natyral dhe biodiversitetin (ruajtjen e zonave sub-urbane) dhe për mbrojtjen e tokës (reduktimin e kripëzimit), si dhe kontribuon në përdorimin në mënyrë të konsiderueshme më pak të burimeve natyrore për banor (në aspektin e rrjeteve të infrastrukturës, ofrimin e shërbimeve, transportit, ngrohjes, etj);
- Menaxhimi i përgjithshëm urban dhe masat politike mjedisore, duke përfshire ruajtjen dhe nxitjen e biodiversitetit urban, zbutjen e efekteve të energjisë dhe konsumin e ujit, promovimin e një skeme masash paraprake për mbetjet lokale.

Pavarësisht nga politikat dhe masat e marra në Planin e 6 të Veprimit të Mjedisit, për mbrojtjen mjedisore dhe politikat për zhvillimin e qëndrueshëm të BE-së, të cilat janë promovuar nëpërmjet një serie tematikash strategjike dhe dokumentesh. Dokumenti i cili ndikon direkt në qëllimin e vlerësimeve aktuale janë përshkruar shkurtimisht më poshtë

Politikat e B E p ë r ndryshimet k limatike (PBENK) synojnë stabilizimin e përqendrimeve të gazeve të efektit serë në atmosferë në nivele që do të parandalojnë ndikimet e rrezikshme humane në sistemet klimatike; rritja e temperaturës mesatare së përgjithshme vjetore të tokës nuk duhet të kalojë 2 ° C, krahasuar me nivelet para-industrisë. Kjo politikë është përshkruar si politika **20 - 20 - 20**, meqenëse ajo në të njëjtën kohë synon:

- Reduktimin e gazit të efektit serrë në të paktën 20% në vitin 2020 nën nivelin e vitit 1990;
- Në vitin 2020 20% e energjisë së BE duhet të vijë nga burime të rinovueshme të energjisë;
- Reduktimin e energjisë primare me 20% në vitin 2020 krahasuar me nivelin e projekteve, (nëpërmjet përmirësimit të eficiencës së energjisë).

Strategjia e BE për biodiversitetin(SBEB) vendos një sërë objektivash të cilat mund të arriten nëpërmjet një numri politikash sektoriale dhe aktiviteteve. Objektivat e strategjive për sektor / tipet e aktiviteteve janë:

- Rruajtja e burimeve natyrore: Krijimi dhe funksionimi i rrjetit “Natyra 2000”; mbrojtjen e disa specieve në rrezik zhdukjeje; aplikimin e instrumenteve ligjore siç është Model Direktiva për Ujin (2000/60/EC); trajtimin e ndryshimeve klimatike;
- Bujqësia: mirë ruajtjen e burimeve gjenetike me vlerë të lartë ushqyese; promovimin e praktikave të mira bujqësore që kontribuojnë në ruajtjen e diversitetit gjenetik dhe uljen e ndotjes (arritjen e disa kriterëve gjenetike të caktuara ekologjike është vendosur si kusht për dhënien e subvencioneve bujqësore); forcimin e masave agro-mjedisore; nxitjen e politikave tregtare të cilat janë kompatible me mbrojtjen e biodiversitetit;
- Peshkimi: praktika promovuese që lehtësojnë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të sasisë së peshkut dhe që kanë një impakt të kufizuar në ekosistemet marine dhe bregdetare; një rritje të mbrojtjes së trupave ujore të një rëndësie të veçantë ekologjike;
- Politikat rajonale dhe planifikimi hapësinor: promovimin e masave planifikuese të cilat mund të kontribuojnë në mbrojtjen e biodiversitetit, në veçanti në korridoret midis zonave të mbrojtura, në zonat rurale dhe në zonat e ndjeshme të pa mbrojtura, duke marrë parasysh konsideratat mjedisore për projektet e financimit nga Fondet Strukturore;
- Pyjet: siguron që menaxhimi i pyjeve nuk do të ndikojë në biodiversitetin ose cilësinë ekologjike të pyjeve; marrjen e masave për ripyllëzim, nxitjen e hulumtimeve dhe vlerësimit të ndikimit;
- Energjia dhe Transporti: Marrjen e masave kundër acidifikimit dhe ndryshimit të klimës, zvogëlimin e ndikimeve negative të zhvillimit të infrastrukturës, kërkimi i burimeve të përshtatshme të energjisë;
- Turizmi: promovimin e turizmit të qëndrueshëm, përcaktimin e poleve për tërheqjen turistike që lidhet me mjedisin dhe biodiversitetin;

- Zhvillimi i ndihmës dhe bashkëpunimit ekonomik: integrimin e objektivave të biodiversitetit në mekanizma të ndihmës për zhvillim dhe bashkëpunimit ekonomik, duke mbështetur përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në vendet në zhvillim, duke siguruar koordinimin dhe plotësimin e masave të marra në nivel kombëtar (duke përfshirë edhe vendet e treta), BE dhe nivelet ndërkombëtare.

Strategjia e BE për zhvillimin e qëndrueshëm (SBEZHQ)u miratua fillimisht në Këshillin Evropian të Goteborgut në vitin 2001 dhe është rishikuar në vitin 2005, plotësuar nga parimi i integritit të dimensionit mjedisor në të gjitha politikat e BE-së. Strategjia e rishikuar përmban katër objektiva kryesore:

1. Mbrojtjen Mjedisore;
2. Drejtësi sociale dhe ndërveprim;
3. Prosperitet ekonomik;
4. Pranimin e përgjegjësive tona ndërkombëtare.

Paralelisht, shtatë sfidat kryesore janë evidentuar, për të cilat një seri objektivash respektive të përgjithshme, objektiva funksional dhe veprimesh janë propozuar:

- Ndryshimet klimatike dhe energji e pastër: Objektivi i përgjithshëm është për të zbutur ndryshimet klimatike dhe shpenzimet e lidhura me të, si dhe impaktet negative sociale dhe mjedisore.
- Transport të qëndrueshëm: Objektivi i përgjithshëm është që të sigurohet se sistemet e transportit plotësojnë nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore të shoqërisë duke minimizuar ndikimet negative në shoqëri, ekonomi dhe mjedis.
- Konsum dhe prodhim të qëndrueshëm: objektivi i përgjithshëm është të promovojë metodat e një konsumi dhe prodhimi të përgjithshëm.
- Konservimi dhe menaxhimi i pasurive natyrore: Objektivi i përgjithshëm është të përmirësojë menaxhimin dhe të shmangë mbishfrytëzimin e burimeve natyrore, duke njohur vlerën e shërbimit të ekosistemit.
- Shëndeti publik: objektivi i përgjithshëm është promovimi i një shëndeti të mirë publik dhe përmirësimin e mbrojtjes ndaj rreziqeve të shëndetit.
- Përfshirja sociale, demografike dhe emigracioni: Objektivi i përgjithshëm është që të krijojë një shoqëri gjithëpërfshirëse shoqërore, duke marrë në konsideratë solidaritetin midis dhe ndërmjet brezave dhe sigurimin / përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve si parakusht për mirëqenie individuale të vazhdueshme.
- Varfëria globale dhe sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm: Objektivi i përgjithshëm është që të promovojë në mënyrë aktive në mbarë botën zhvillimin e qëndrueshëm

dhe të sigurojë që politikat e brendshme dhe të jashtme të BE-në janë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm global dhe angazhimet e saj ndërkombëtare.

Karta e L aipzigt p ër q ytetet e q ëndrueshme E vropiane, (KLQQE) detyron shtetet anëtare të BE të përdorin konsultimin publik për integrimin e parimeve dhe strategjive të “zhvillimit të integruar urban” në politikat e zhvillimeve kombëtare, rajonale dhe ato lokale. Ajo ka nevojë për krijimin e qeverisjeve të vetëdijshme dhe marrjen e masave zbatuese për promovimin e organizimit të balancuar territorial të bazuar në një strukturë evropiane policentrike urbane. Parimet udhëzuese të Kartës së për zhvillimin e qëndrueshëm urban janë

- Promovimin e politikave "të zhvillimit të integruar urban":
 - Analizimi i situatës aktuale, përshkuan problemet dhe mundësitë;
 - Identifikon qëllimet e zhvillimeve aktuale për çdo zonë dhe i zhvillon ato në përputhje me vizionin e përgjithshëm të qytetit;
 - Koordinon planet teknike dhe politikat sektoriale duke siguruar kontributin e investimeve të planifikuara për të krijuar një zhvillim të balancuar për çdo zonë;
 - Koordinon burimet publike dhe private dhe përqendrimin e tyre hapësinor;
 - Koordinon planin në nivel lokal dhe në nivel qyteti - rajoni;
 - Përfshirjen e shoqërisë civile dhe të partnerëve të tjerë të cilët mund të kontribuojnë ndjeshëm në formimin e ekonomisë së ardhme, në karakterin social, kulturore dhe mjedisor të çdo zone në procesin e planifikimit.

Tabela 22: Përmbledhje e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të vendosura në nivel Evropian

ME-1	Promovimin e shëndetit publik për të përmirësuar mbrojtjen kundër rreziqeve shëndetësore
ME-2	Reduktimin e ndotjes së ajrit
ME-3	Reduktimin e shkarkimeve të gazit serre
ME-4	Përmirësimi i efikasitetit të përdorimit të burimeve natyrore (shpang mbi-shfrytëzimin), zbutje ndikimet negative në mjedis dhe nxit përdorimin e burimeve më pak ndotëse.
ME-5	Reduktimi i konsumit të energjisë dhe rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme
ME-6	Redukto mbetjet dhe promovojë ripërdorimin, riciklimin dhe rigjenerimin
ME-7	Krijimi i një rrjeti të zonave të mbrojtura dhe korridoreve ekologjike dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të pyjeve.
ME-8	Promovimi i mbrojtjes efektive të tokës nëpërmjet (a) reduktimit të ndotjes së tokës nga të gjitha burimet (duke përfshirë edhe përdorimin e pesticideve të dëmshme), (b) zbatimin e një planifikimi të qëndrueshëm

	territorial dhe praktikave të menaxhimit të tokës, dhe (c) promovimin e praktikave bujqësore të qëndrueshme dhe politika bujqësore të zhvillimit ekologjikisht miqësore.
ME-9	Mbron, rrit dhe konservon cilësinë e mjedisit detar
ME-10	Promovon transport urban te qëndrueshëm (fleksibilitet urban te qëndrueshëm)
ME-11	Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm urban, parandalimin e shtrirjes se ç'rregullt urbane dhe sigurimin e një zhvillimi "kompakt" dhe përdorimi të përzier.
ME-12	Promovimi i turizmit të qëndrueshëm dhe te përcaktojë nyjet e tërheqjes turistike që lidhen me mjedisin dhe biodiversitetin
ME-13	Përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe promovimin e përfshirjes sociale, duke marrë në konsideratë solidaritetin midis dhe brenda brezave
ME-14	Përmirësimi i kushteve mjedisore dhe forcimin e ekonomisë lokale dhe punësimin në zonat e privuara
ME-15	Promovimin e metodave ndërtimore te qëndrueshme - bioklimatike
ME-16	Përmirëson cilësinë dhe atraktivitetin e hapësirave publike
ME-17	Promovimi i skemave të integruara të menaxhimit mjedisor dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik

- Krijimin e një hapësire publike të një cilësie të lartë:
 - Prezantimin e “*Baukultur*” (një koncept ndërtimor i shoqëruar me estetikën dhe cilësinë), e cila i referohet rritjes së ndërveprimit të projektimit, arkitekturës dhe planifikimit të infrastrukturës urban, në mënyrë që të krijojë hapësira atraktive publike të orientuara drejt nevojave të përdoruesve për të arritur standarde të larta në lidhje me mjedisin e jetesës së qytetarëve.
- Modernizimi i rrjetit infrastrukturor dhe përmirësimi i efikasitetit të energjisë:
 - Nxitjen e qëndrueshmërisë, aksesueshmëri dhe përbalueshmëri të transportit urban, menaxhimit të trafikut dhe të infrastrukturës për këmbësorët dhe përdoruesit e biçikletave, koordinon planifikimin e transportit me qendrat e punësimit, banesat, hapësirat publike dhe nevojat për mbrojtjen e mjedisit;
 - Përmirësimin e infrastrukturës teknike, veçanërisht të rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; të përshtatura me nevojat në ndryshim, në mënyrë që të mbulojë kërkesat në rritje të standardeve të një jete më të mire.
 - Nxitjen e funksionimit efikas dhe përmirësimin e rrjeteve të shërbimeve dhe për të siguruar qëndrueshmërinë përmes përdorimit të kujdeshëm të burimeve të tyre natyrore dhe rritje të efikasitetit të energjisë në veçanti në ndërtesa, rinovimin e ndërtesave të pabanuara për të zvogëluar shpenzimet, si për bizneset ashtu dhe konsumatorët dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës.
 - Nxit zhvillimin "kompakt" dhe të përzier përdorimi (strehimi, punësimi, arsimim, dhe shërbime argëtuese), nëpërmjet planifikimit të duhur urban dhe

- hapësinor që parandalon efektivisht kontrollin e shtrirjes së çrregullt urbane për zhvillim, duke trajtuar zhvillimet spekulative;
- Sigurimin e një jete cilësore dhe për të tërhequr bizneset nëpërmjet përdorimit të informacionit të avancuar dhe teknologjive të komunikimit në arsim, punësim, shërbime sociale, shëndetësi, sigurinë dhe mbrojtjen;
 - Përshtatjen me kërcënimet e ndryshimeve të klimës; pajton zhvillimin urban me përdorimin e ulët të lëndëve djegëse fosile, përmirëson cilësinë e mjedisit dhe redukton shkarkimet nëpërmjet planifikimit të duhur dhe parashikimeve të reja, si dhe masave zbutëse.
- Prezantimin e politikave proaktive të risive dhe arsimit:
- Mbështet arsimin dhe sistemet e trajnimit dhe organizatat sociale dhe kulturore; Siguroni mundësi për të mësuarit gjatë gjithë jetës, mbështet universitetet, institucioneve kërkimore dhe rrjetet shkencore ndërmjet industrive, bizneseve dhe komunitetit shkencor, përmes politikave të integruara të zhvillimit urban dhe qeverisjes së mirë.
- Fokusimin në zonat e privuara/degraduara në kontekstin e përgjithshëm të çdo situatë:
- Zbatimi i strategjive për rritjen mjedisore;
 - Forcimin e ekonomisë lokale dhe punësimin;
 - Nxitjen e arsimimit proaktiv të të rinjve dhe politikave të trajnimit;
 - Nxitjen për një transport publik efikas dhe të mjaftueshëm për përmbushjen e nevojave.

Kuadri Evropian i Politikave për Mjedisin

Rritja e ndërjegjësimit dhe e shqetësimit për çështjet e larmisë biologjike dhe pejsazhore, krijoi bazën për zhvillimin e Strategjisë Pan-Evropiane të Larmisë Biologjike dhe Pejsazhore (PEBLDS). Kjo strategji përfaqëson një përgjigje evropiane në vijim të zbatimit të Konventës së Larmisë Biologjike.

Strategjia synon të veprojë për një periudhë 20-vjeçare.

Qëllimi dhe objektivat e Strategjisë Pan-Evropiane të Larmisë Biologjike dhe Pejsazhore

- Reduktim i kërcënimeve ndaj larmisë biologjike dhe pejsazhore,
- Rehabilitim i shpejtë i larmisë biologjike dhe pejsazhore
- Forcim i koherencës ekologjike,

- Sigurim i pjesëmarrjes se plote te publikut ne ruajtjen e larmisë biologjike dhe pejsazhore.

PEBLDS ka gjashte tema:

- Përforcim i zbatimit te Konventës se Larmisë Biologjike nëpërmjet procesit te Strategjisë Pan-Evropiane;
- Integrim te ruajtjes se larmisë biologjike dhe pejsazhore ne politikat sektoriale;
- Ngritje te kapaciteteve te zhvillimit mjedisor ne Evropën Qendrore dhe Lindore si dhe Vendet e Reja te Pavarura;
- Dhënie te informacionit dhe forcim te komunikimit;
- Zhvillim te Rrjetit Ekologjik Pan-Evropian;
- Ndërmarrje e rishikimeve dhe vlerësimeve si dhe monitorimi, raportimi dhe financimi i Strategjisë Pan-Evropiane.

Rrjeti Ekologjik Pan-Evropian

Rrjeti Ekologjik Pan-Evropian (**PEEN**) është një rrjet fizik nëpërmjet te cilit ruhen ekosistemet, habitatet, llojet, pejsazhet dhe karakteristika te tjera natyrore te rendesise Pan-Evropiane. PEEN është gjithashtu një mekanizëm koordinues me ane te cilit partneret mund te zhvillojnë dhe zbatojnë aksione te përbashkëta. Një karakteristike e këtij rrjeti është funksioni i tij për ruajtjen e zonave natyrore te mëdha dhe parandalimin e copëzimit ose restaurimin e lidhjeve midis mjediseve te copëzuar.

PEEN u shpall ne Sofje ne 1995. Ne vitin 1996 Këshilli i Evropës nxiti ngritjen e Rrjetit Emerald ne kuadrin e Konventës se Bernës (Këshilli i Evropës 1979b). PEEN përbehet nga:

- zona qendrore për ruajtjen e ekosistemeve, habitateve, llojeve dhe pejsazheve,
- korridore biologjike për përmirësimin e lidhjes midis sistemeve natyrore,
- zona te restauruara për rimëkëmbjen e elementeve te dëmtuar te ekosistemeve, habitateve dhe pejsazheve me rëndësi evropiane dhe
- zona tampon (buferike) qe mbështesin dhe ruajnë rrjetin nga ndikimet e huaja te dëmshme.

Rrjeti Emerald

Ngritja e Rrjetit Emerald për Zonat me Rëndësi te Veçante për Ruajtje (ASCI) mbështet zbatimin e Konventës se Bernës (1979) për Konservimin e Gjallesave dhe Habitateteve Natyrore Evropiane. Ne rekomandimin Nr. 16 (1989) për ASCI-t, Komiteti Drejtues i Konventës se Bernës u rekomandon Palëve “te ndërmarrin hapa për krijimin e Zonave ASCI si dhe te sigurojnë ndërmarrjen e masave konservuese për secilën zone”.

Objekti i përgjithshëm dhe rezultatet e Projektit Pilot EMERALD ne Shqipëri

Objektivi i përgjithshëm i projektit ishte zhvillimi i një baze të dhënash pilot për një numër të

caktuar ASCI-sh dhe propozimin e kësaj baze pranë Komitetit Drejtues të Konventës së Bernës.

Projekti pilot është vetëm një pike nisje që vendos themelet për zhvillimin e Rrjetit EMERALD në nivel kombëtar.

Rezultatet kryesore të projektit pilot për Rrjetin EMERALD janë si më poshtë :

- Metodologji për ngritjen e Rrjetit EMERALD.
- Instalimi i programit për EMERALD-in. Programi jep mjetet për konvertimin e të dhënave nga baza e të dhënave CORINE në atë EMERALD.
- Plotësimi i bazës së të dhënave EMERALD për zonat CORINNE të përzgjedhura për cilësimin si ASCI dhe përfshirjen e tyre në Rrjetin EMERALD.

Shqipëria nënshkroi Konventën e Bernës më 31 Tetor 1995 dhe e ratifikoi atë më 13 Janar 1999. Në prill të vitit 2002, Shqipëria përzgjodhi gjashtë zona pilot për tu përfshirë në rrjetin EMERALD. Pas përfundimit të projektit pilot, Shqipëria ka mundësi të zhvillojë me tej një listë të zonave ASCI potenciale. Zona në studim ka zona të mundshme për tu bërë pjesë e Rrjetit EMERALD.

3.4 Përmbledhje e objektivave

Hartimi dhe ndërtimi i Strategjive Kombëtare në pjesën më të madhe të tyre janë në përputhje me strategjitë e vendeve të Bashkimit Evropian, si p.sh ato për ndryshimet klimatike, në zhvillimin e biodiversitetit të qëndrueshëm dhe pak a shumë me shtatë objektivat e veçanta të tematikave strategjike të Planit të Veprimit Mjedisor 6 të BE-së edhe pse fillimisht me element të reduktuar të synuara. Në parim qasja për VSM e ndjekur në rastin e Bashkisë ka ndjekur, së pari përputhshmërinë me objektivat kombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm që përbejnë shumicën e atyre ndërkombëtare. Kur kjo përputhshmëri nuk ka qenë e mundur apo e zbatueshme, në rastin kur politikat kombëtare nuk janë përputhur akoma me ato ndërkombëtare, është marrë parasysh eksperiencia ndërkombëtare dhe është trajtuar kapaciteteve dhe mjedisit administrative dhe ekonomik të Bashkisë, në përpjekje për të shtyrë objektivat e VSM për të përfshirë gjithashtu dhe objektivat ndërkombëtare siç është ndryshimi i klimës aktiviteteve të lidhura me të dhe veprimet ndërgjegjesuese.

Në Planin e zonës në studim Objektivat e VSM, që do trajtohen me gjerësisht në kapitujt e mëposhtëm, janë shumica e objektivave të VSM të lidhura me objektivat e BE-së për zhvillim të qëndrueshëm, të cilat nga ana e tyre janë të përfshira në masë të madhe në Planin e objektivave Kombëtare.

Në plan të parë mbahet gjithnjë ruajtja e parametrave mjedisor duke patur parasysh këtu rëndësinë kombëtare dhe ndërkombëtare të lagunave, ZMD-ve, parkun kombëtar

dhe të biodiversitetit të lidhur ngushtë me konservimin e saj duke u bazuar në qëllimet dhe objektivat e Strategjisë Pan-Evropiane të Larmisë Biologjike dhe Peizazhore

Lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, plani i dhe VSM-ja përkatëse kanë adresuar çështjet e “ Reduktimit të Varfërisë së skajshme” nëpërmjet zhvillimit të komponentit ekonomik të planit, qasjes në shkollat fillore (duke ofruar jo vetëm një plan për këtë nivel të ulët të arsimit, por edhe për ato të nivelit të arsimit të mesëm), për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm, një qëllim që mund të përdoret akoma nga VSM dhe plani është "*krijimi i Partneritetit Global për zhvillim*". Krijimi i partneriteteve ndërkombëtare me qytete të tjera të ngjashme, por në nivelin më të përparuar (në aspektin e zhvillimit ekonomik, planifikimi mjedisor dhe atij urban), mund të ndihmojë bashkinë për të marrë njohuri dhe përvojë në përpjekjet e saj për të ndjekur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kështu, përveç shtatë strategjive të përmendura më sipër, të tjerat janë më rigorozë, si ajo e ndjekur për parandalimin e mbeturinave dhe riciklimin, për mbrojtjen e tokës, për mjedisin detar /ujë, cilësinë e ajrit në përshtatjen graduale, sikurse edhe përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve për ruajtjen e shëndetit të popullatës, metodat ndërtimore bioklimatike të qëndrueshme etj.

Zonat e mbrojtura dhe të rëndësishme.

Në Bashkinë e Himarës ka një numër të konsiderueshëm të zonave të mbrojtura dhe natyrore si dhe një numër monumentesh natyrore. Këto monumente duhet të mbrohen me çdo kusht si një pasuri e madhe e zonës por edhe kombëtare si dhe duhet të pasurohen me zona të reja të mbrojtura në bazë të ligjeve në fuqi. Të gjitha këto monumente janë edhe një atraksion turistik i rëndësishëm për Bashkinë e Himarës.

Plani i Bashkisë ndër të tjera përfshin edhe trajtimin e zonave të mbrojtura përmes VKM dhe që zhvillohen sipas një plan menaxhimi të miratuar. Kjo përbën një element të rëndësishëm të objektiveve të VSM.

Parku i Llogarasë merret në konsideratë nga PPV pasi përbën një park kombëtar të rëndësishëm i cili është kufitar me të dhe ku respektimi i zonës buferike prej 1000 m duhet respektuar, ku asnjë zhvillim i ri është i lejuar, vetëm përdorim bujqësor, shpłodhje dhe rekreacion.

Po ashtu një zonë e rëndësishme është edhe lugina që ndjek lumin e Kudhësit, e cila ka akoma shenja të viteve 80' kur ajo ishte akoma e kultivuar. Rehabilitimi i saj do të ishte me interes të madh dhe të veçantë pasi ka një potencial të madh agroturistik për zonën duke krijuar edhe mundësi punësimi por edhe duke përmirësuar mjedisin e zonës. Një pamje magjepsë është edhe ajo e kodrave dhe livadheve që shtrihet në të dyja anët e rrugës së vjetër automobilistike, e cila mund të shfrytëzohet për qëllime të shumta turistike.

Menaxhimi i Burimeve Ujore

Burimet ujore në Bashki janë një objektiv kryesor i VSM. Në Planin e paraqitur është trajtuar gjerësisht problematika pasi *së pari*, vihet re mungesa e menaxhimit të burimeve ujore, së dyti nisur nga rëndësia e madhe që ka zhvillimi i industrisë së turizmit në Bashki i cili është i lidhur ngushtësisht me furnizimin me ujë dhe së treti rëndësia e burimeve ujore për shëndetin publik. Të gjitha masat e Objektivit Kombëtar të zbatuara për rastin e Bashkisë (projekte përparësore në sektorët e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, të programit të investimeve, reduktimi i ndotjes së burimeve ujore sipërfaqësore, mbrojtjen e ujërave nëntokësore etj) dhe duhet të pasqyrohet në VSM-ne e kësaj Bashkie.

Mbrojtja e Tokës

Mbrojtja e tokës përbën një nga objektivat kryesore të planit të Bashkisë duke marrë në mbrojtje fondin e tokës dhe në mënyrë të veçantë atë bujqësore, nëpërmjet parimeve dhe udhëzuesit të tij. Gjithashtu një vend të veçantë zë riaftësimi i tokave të kripëzuara, tokave në rrezik përmbetje përmes rigjenerimit të sistemit të drenazhimit apo atij kullues ekzistues, ujitjen, hedhjen e pakontrolluar e mbeturinave etj, pra praktikisht të gjitha objektivat kombëtare zbatohen për rastin e Bashkisë Himarë. Mbrojtja e tokës përbën edhe një nga objektivat kryesore të VSM të Bashkisë .

Cilësia e Ajrit

Zona e studimit e bashkisë së re Himarë karakterizohet nga një cilësi ajri e mirë pasi ajo shtrihet nga bregdeti e deri në zona malore. Industri të mirëfillta nuk ka. Problematika e vetme që ka kjo bashki është gjatë periudhës së verës ku fluksi i turistëve krijon trafik të rënduar. VSM-se i ka identifikuar presionet mjedisore që lidhen me nevojën e përmirësimit të trafikut për të zvogëluar ndotjen prej tij. Objektivat e VSM do të vendosen në përputhje me ceshtjet e mësipërme dhe të tjera të ngritura dhe objektivat përkatëse kombëtare.

Ndryshimet Klimatike

Objektivat lidhur me ndryshimet klimaterike janë të lidhura ngushtësisht dhe në varësi të iniciativave dhe planeve kombëtare, sidoqoftë vendosja dhe zbatimi i niveleve të emetimeve që lëshojnë apo do të lëshojnë aktivitetet industriale në afërsi të territorit të Bashkisë do të përbënin një ndër objektivat e VSM. Kjo do të ndikonte në ndërgjegjësimin e popullatës për të kontribuar në nivel kombëtar, në përdorimin me efikasitet të energjisë dhe në përdorimin e energjive të rinovueshme që mund të zhvillohen në nivel lokal.

Menaxhimi i Mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve pavarësisht zgjidhjes së pjesshme që ajo k marrë përsëri mbetet një ndër presionet mjedisore të Bashkisë Himarë. PPV gjen zgjidhje në

mënyrë të veçantë për problemin e vend-hedhjes së tyre dhe atë të përpunimit. VSM merr parasysh këtë zgjidhje por do të kërkojë edhe planin e menaxhimit të plotë të mbeturinave listën e projekteve prioritare lehtësuese si për reduktimin dhe eliminimin e aktiviteteve ekzistuese te pakontrolluara te depozitimit të mbeturinave, ashtu dhe për zhvillimin e qëndrueshëm te sistemit të mbeturinave për të ardhmen e Bashkisë.

Ndotja nga Zhurmat

Ndotja nga zhurmat nuk është një presion i konsiderueshëm mjedisor në Bashkinë Himarë. Problemi kryesorindotjes akustike qëndron tek një numër baresh në buzë të detit që mbajnë muzikë më volum të lartë si nëorët e ditës ashtu edhe në ato të natës. Një pjesë e tyre përbëjnë shqetësim edhe për banorët e zonave përreth.

Trafiku i rënduar sidomos në zonën pasme (hyrje) të Himarës dhe në rrugën që të con në bregdetin e Dhërmiut përbën një tjetër shqetësim për banorët me banim në buzë të rrugës. VSM do e shqyrtojë këtë ndotje në mënyrë që të shmangen këto problematika duke kërkuar monitorimin, ndërtimin e rrugëve alternative nëpërmjet zbatimit të ligje në përputhje me ato të kombëtare dhe ato të BE me qëllim reduktimin gjatë periudhës së ditës deri në 56 dB dhe vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së natës te reduktohen ne 45 dB.

3.5 Objektivat e veçanta te VSM-se

Duke marre në konsiderate:

- Analizën mjedisore të bashkisë Himarë;
- Objektivat e zhvillimit te qëndrueshëm ndërkombëtar, demonstruar në Tabelën 21 dhe kodifikuar si INT 1 deri ne INT 5;
- Objektivat e zhvillimit te qëndrueshëm te BE, kodifikuar si EU1(BE1) deri EU17(BE17), tabela 22;
- Përmbledhja e objektivave të Strategjisë Mjedisore Kombëtare të Shqipërisë;
- Përmbledhja e objektivave kombëtare të planifikimit të territorit, jepen në Tabelën 19 dhe kodifikohen si PT 1 deri PT 4;
- Përmbledhja e objektivave të Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin (PINS) dhe kodifikohen si BJ-1 deri BJ-7, tabela 20, etj

Konsulenca e VSM-se ka përpiluar një grup prej 18 Objektivash gjithëpërfshirëse të VSM-se, të cilat janë përdorur në kapitujt në vazhdim në mënyre që të:

- Vlerësojë efektet e pritshme mjedisore dhe shëndetësore te skenarëve alternative (Kapitulli 4);
- Vlerësojë në detaje efektet e pritshme mjedisore dhe shëndetësore të politikave të Planit Lokal dhe projekteve (Kapitulli 5); dhe
- Strukturojë sistemin e propozuar te monitorimit te VSM-se, (Kapitulli 6).

Tabela 23 tregon rëndësinë e çdo objektivi te VSM-se me objektivat e sipërpërmendur kombëtare, te BE-se dhe atyre ndërkombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm, si edhe kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni i VSM-se. Kur një Objektiv e VSM-se është e lidhur ne mënyre te drejtpërdrejte me një objektive te zhvillimit të qëndrueshëm apo me një kërkesë të veçantë te VSM-se, objektivi i përshtatshëm apo kërkesa e VSM-se është e shënuar në germa të rregullta, në rastet kur është e lidhur ne mënyre jo te drejtpërdrejte, me objektivat e përshtatshme apo kërkesat e VSM-se, është e shënuar me germa të pjerrëta.

Tabela 2 3: Lidhja e Objektivave te VSM me objektivat n dërkombëtare, te BE dhe ato kombëtare te zhvillimit te qëndrueshëm si dhe kërkesave te legjislacionit te VSM-se

Objektivat e VSM-se		Lidhja e Objektivave te VSM-se me				Kërkesat e legjislacionit te VSM-se
		Sfidat kryesore mjedisore	Objektivat ndërkombëtar dhe te BE	Objektivat e SKM-se	Objektivat e S KZHT dhe te planifikimit te territorit	
1	Mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit, zonat e mbrojtura dhe zonat e gjelbra, speciet dhe habitatet	10	INT-1, INT-3, EU-7/ INT-2, INT-5, EU-1, EU-8	NES-1 / NES-9	SC-2, SC-3 / TP-2, TP-4, SC-1	Biodiversiteti, Fauna, Flora, Mjediset natyrore / Shëndeti njerëzor, Toka, Uji, Klima, Ajri, Peizazhi, Trashëgimia kulturore
2	Menaxhimi i tokave në mënyrë të qëndrueshme dhe parandalimi i ndotjes së tokës dhe erozioni	12, 13	INT-3, EU-8 / INT-1, EU-1, EU-4	NES-4	SC-2 / TP-2, TP-4, SC-3	Toka / Shëndeti njerëzor, Biodiversiteti, Fauna, Flora, Klima, Uji, Mjediset natyrore
3	Mbrojtja dhe përmirësimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	11, 13	INT-3 / INT-1, EU-1, EU-4	NES-3 / NES-2	SC-2 / TP-2	Uji, / Shëndeti njerëzor, Biodiversiteti, Fauna, Flora, Toka, Mjediset natyrore
4	Mbrojtja, përmirësimi dhe zhvillimi i mjedisit të marinës dhe zonave bregdetare	10, 11	INT-3, INT-5, EU-9/INT-1, EU-1, EU-4	NES-1, NES-9	SC-1, SC-2 / TP-2	Uji, Peizazhi, Mjediset natyrore / Shëndeti njerëzor, Biodiversiteti, Klima
5	Reduktimi i ndotjes së ajrit dhe emetimeve të gazeve sërre, nxitja e një lëvizshmërie të qëndrueshme urbane dhe përmirësimi i efikasitetit të energjisë	5, 6, 15	INT-1, INT-3, EU-2, EU-3, EU-5, EU-10/ EU-1	NES-5, NES-6 / NES-9	TP-2	Mjediset natyrore, Klima, Ajri / Mjediset natyrore / Vlerat Materiale
6	Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta	12	INT-1, INT-3, EU-6/ INT-2, EU-1, EU-8	NES-7	SC-2	Shëndeti njerëzor/ Biodiversiteti, Toka, Ajri, Uji, Peizazhi, Mjediset natyrore
7	Përmirësimi i trajtimit të ujerave të zeza	11	INT-1, INT-3, INT-4	NES-3 / NES-2,	SC-2	Shëndeti njerëzor, Uji / Biodiversiteti, Toka, Mjediset

			<i>INT-2, INT-5, EU-1, EU-9</i>	<i>NES-4</i>		<i>natyrore</i>
8	Kontrollimi i niveleve të zhurmës, në kuadër të rritjes së nivelit të hëndetësor të popullatës	14	<i>INT-1, INT-2 / INT-3, EU-1</i>	<i>NES-8</i>	<i>TP-2</i>	<i>Shëndeti njerëzor / Vlerat materiale, Trashëgimia kulturore</i>
9	Mbrojtja, përmirësimi dhe rivendosja e cilësisë dhe karakterit të peizazhit, promovimi i dallueshmërisë lokale dhe vlerës piktoreske	9	<i>INT-2 / INT-3, INT-5, EU-12, EU-14, EU-16</i>	<i>NES-1, NES-9</i>	<i>SC-1, SC-3 / T-2, TP-4, SC-2</i>	<i>Peizazhi / Biodiversiteti, Toka, Uji, Mjediset natyrore, Vlerat materiale, Trashëgimia kulturore</i>
10	Mbrojtja, përmirësimi dhe restaurimi i monumenteve kulturore dhe trashëgimisë arkitekturore; Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së formës urbane, modelit të vendbanimeve, identitetit pamor të qytetit	7	<i>EU-14, EU-16 / INT-2, INT-3, EU-11</i>	<i>NES-9</i>	<i>TP-4, SC-3</i>	<i>Peizazhi, Trashëgimia kulturore / Vlerat materiale</i>
11	Përmirësimi i cilësisë së projektimit dhe mbështetja e kologjikisht e favorshme me metodat e ndërtimit në zhvillimin e ri	6	<i>EU-15 / EU-4, EU-5, EU-14</i>		<i>SC-3</i>	<i>Trashëgimia kulturave / Vlerat materiale</i>
12	Reduktimi dhe parandalimi i zhvillimit të shpërndarë dhe përmirësimi i strukturës së vendbanimit	5	<i>INT-3, EU-8, EU-11 INT-2, EU-2, EU-3, EU-4, EU-7, EU-10</i>	<i>NES-1, NES-9 / NES-4</i>	<i>T-2, TP-2, TP-4, SC-1, SC-3 / SC-4</i>	<i>Biodiversiteti, Fauna, Flora, Mjediset natyrore / Shëndeti njerëzor, Toka, Uji, Klima, Ajri, Peizazhi, Trashëgimia kulturore</i>
13	Reduktimi dhe parandalimi i zhvillimit të papajtueshëm të përdorimit të tokës në zonën bregdetare, të sistemit bujqësor dhe natyror	4, 10	<i>INT-1, INT-3, INT-5, EU-8 / INT-2, EU-1, EU-7, EU-11, EU-12</i>	<i>NES-9 / NES-1, NES-4</i>	<i>T-2, TP-2, TP-4, SC-1, SC-2, SC-3, SC-4 / TP-3</i>	<i>Shëndeti njerëzor, Peizazhi, Vlerat materiale / Trashëgimia kulturore</i>
14	Përmirësimi i kushteve dhe sigurimi i aksesit të barabartë në rrjetet e shërbimeve dhe infrastrukturës sociale, përmirësimi i aksesueshmërisë	8	<i>INT-2 / INT-3, INT-5, EU-1, EU-10, EU-13</i>	<i>NES-5, NES-9</i>		<i>Shëndeti njerëzor, Uji / Vlerat materiale</i>
15	Mbështetja e rritjes demografike nëpërmjet zhvillimit të sektorit të turizmit	1	<i>INT-2, EU-13, EU-14</i>	<i>NES-9</i>	<i>T-1 / T-3, TP-1</i>	<i>Shëndeti njerëzor, Peizazhi, Vlerat materiale, Trashëgimia kulturore</i>

	ne një mënyre qe te gjeneroje punësim te qëndrueshëm dhe mundësi bi znesi për komunitetin lokal					
16	Promovimi i zhvillimit te qëndrueshëm te turizmit, i cili do te ve projes in një katalizator i një ekonomie te larmishme lokale te qëndrueshme gjate te gjithë vitit	3	INT-2, INT-3 / INT-4, INT-5, EU-12, EU-13, EU-14	NES-1, NES-9	T-1, T-3 / TP-1, SC-3	Vlerat materiale / Biodiversiteti, Peizazhi, Mjediset natyrore, Trashëgimia kulturore
17	Zyrtarizimi i sektorit te turizmit, zhvillimi i infrastrukturës se turizmit me mjete publike dhe private, financimi i strukturës lokale dhe gjenerimi i aseteve sipjese e procesit te zhvillimit te pasurisë se paluajtshme	2	EU-13		T-2 / T-1, T-3	
18	Rritja e nërgjegjësimi mjedisor dhe nxitja e veprimeve pilote dhe iniciativave	16	EU-17			

Tabela 23 jep Objektivat e zgjedhura te VSM-se, duke dhëne një përshkrim te shkurtër te problematikave te cilat janë marre ne konsiderate për çdo objektive. Ngjyrimet perfaqesojne kategorinë përfshirëse te elementit te qendrueshmerise me te cilin ka me shume lidhje për secilën nga objektivat:

- Objektivat 1 deri 8 te VSM-se, i referohen problemeve të mbrojtjes se mjedisit natyror dhe përmirësimit te shëndetit publik;
- Objektivat 9 deri 14 te VSM-se, mbulojnë problemet e zhvillimit te qëndrueshëm të territorit dhe përmirëson cilësinë e përditshme te jetës te popullsisë;
- Objektivat 15 deri 17 te VSM-se, ka te beje me problemet e zhvillimit te qëndrueshëm social-ekonomik;
- Objektivi 18 mbulon problemin e pergjithshem të rritjes së vetëdijes mjedisore të popullsisë lokale.

Tabela 24: Përshkrimi i Objektivave të VSM-së

Objektivat VSM	Përshkrimi
1 Mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit, zonat e mbrojtura dhe zonat e gjelbra, speciet dhe habitatet	Mbrojtja e biodiversitetit te zonës, duke përfshirë faunën dhe florën lokale; mbrojtjen dhe rivendosjen e llojeve te habitateve; mbrojtjen e objekteve natyrore dhe pyjeve, rritjen e sipërfaqeve te zonave te mbrojtura (natyrore dhe peizazhet)
2 Menaxhimi i tokave ne një mënyre te qëndrueshme dhe parandalimi i ndotjes se tokës dhe erozioni	Minimizon konsumimin e pasurive tokësore të vlefshme (tokat natyrore dhe bujqësore); nxisin masa për të parandaluar dhe për të zvogëluar ndotjen e tokës dhe erozionit
3 Mbrojtja dhe përmirësimi i ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore	Mbron cilësinë dhe sasinë e burimeve ujore lokale, duke përfshirë sistemet e përrrenjve (minimizon konsumin, promovon riciklimin e ujit, parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes së tij)
4 Mbrojtja, përmirësimi dhe zhvillimi i mjedisit te marinës dhe zonave bregdetare	Parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së ujerave detar; mbrojtjen dhe rivendosjen karakterit te zonave bregdetare nëpërmjet rregullimit te presioneve të zhvillimit
5 Reduktimi i ndotjes së ajrit dhe emetimeve te gazes sere, nxitja e një lëvizshmërie te qëndrueshme urbane dhe përmirësimi i efikasitetit te energjisë	Përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe të kontribuojë në parandalimin e ndryshimeve klimatike, duke nxitur masat për lëvizshmëri të qëndrueshme (Uljen e nevojës për të udhëtuar dhe gjatësinë ditore te udhëtimit, nxit transportin publik, ecjen dhe çiklizmin), si dhe eficientë e energjisë (nëpërmjet reduktimit te konsumit te energjisë, të promovojë përdorimin e energjisë se rinovueshme)

6	Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta	Nxit zhvillimin/ndërtimin e mjeteve të përshtatshme për asgjësimin e sigurve të mbetjeve urbane dhe atyre ndërtimore; rehabilitimin e vendgrumbullimit ekzistues të mbetjeve; të përmirësojë sistemin e grumbullimit; promovojë ripërdorimin dhe riciklimin, të kontribuojë në reduktimin e mbeturinave
7	Përmirësimi i trajtimit të ujërave të zeza	Promovojnë zhvillimin e impianteve lokale dhe qendrore të trajtimit të ujërave të zeza; zgjerimin e rrjetit të kanalizimeve për të mbuluar vendbanimet ekzistuese, të sigurojë mbulimin adekuat të rrjetit për zhvillimet e ardhshme; të parandalojë dhe të zvogëlojë ndotjen nga veprimtaritë produktive (turizmi, bujqësia dhe blegtoaria)
8	Kontrollimi i niveleve të zhurmës, në kuadër të rritjes së nivelit shëndetësor të popullatës	Parandalon dhe kufizon ekspozimin e popullsisë ndaj ndotjes nga zhurmat; nxisin masat për të minimizuar zhurmat nga të gjitha aktivitetet në nivele të pranueshme, sipas normave kombëtare
9	Mbrojtja, përmirësimi dhe rivendosja e cilësisë dhe karakterit të peizazhit, promovimi i dallueshmërisë lokale dhe vlerës piktoreske	Reduktimin dhe parandalimin e ndryshimeve të peizazhit; promovon modelet e zhvillimit dhe format që janë në përputhje me karakterin e peizazhit, zhvillon dhe rivendos karakteristikat dhe vlerat lokale të peizazhit, mbrojtjen e cilësive piktoreske dhe pamjeve të veçanta
10	Mbrojtja, përmirësimi dhe restaurimi i monumenteve kulturore dhe trashëgimisë arkitekturore; Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së formës urbane, modelit të vendbanimeve, identitetit pa mor të qytetit	Nxitja e masave për mbrojtjen efektive dhe restaurimin e vendbanimeve tradicionale, monumenteve të kulturës dhe vendeve me interes; promovon modelet e zhvillimit dhe rregullat e ndërtimit që respektojnë dhe përmirësojnë aspektet e vlefshme të formës ekzistuese dhe karakterin urbane
11	Përmirësimi i cilësisë së projektimit dhe mbështetja e kologjikisht e favorshme me metodat e ndërtimit në zhvillimin e ri	Nxitjen e masave për të siguruar cilësinë e ndërtimeve të reja në aspektin e standardeve të projektimit, përdorimin e materialeve dhe eficienten e energjisë dhe për të përmirësuar cilësinë e ulët të ndërtimeve ekzistuese
12	Reduktimi dhe parandalimi i zhvillimit të shpërndarë dhe përmirësimi i strukturës së vendbanimit	Redukton dhe parandalon fenomenet e shpërndarjes urbane, promovimin e zhvillimit në pole të organizuara kompakte; konsolidon strukturën urbane dhe përmirëson strukturën tradicionale të vendbanimeve

13	Reduktimi dhe parandalimi i zhvillimit te papajtueshem te perdorimit te tokes ne zonat bregdetare, te sistemit bujqesor dhe natyror	Nxit planifikimin e perdorimit te tokes qe ka per qellim te rregulloje konfliktet ekzistuese te perdorimit, si dhe nxit perdorimin e duhur kompleks te saj; mbron zonat ekologjike te ndjeshme (shpatet natyrore, tokat bujqesore, zonat bregdetare) dhe peizazhet e rendesishme nga presionet e zhvillimit; nxit rehabilitimin e vendeve te degraduara; imponon rregulla transparente per format rezidenciale, turistike dhe te tjera te zhvillimit.
14	Permirsimi i kushteve dhe sigurimi i aksesit te barabarte ne rrjetet e sherbimeve dhe infrastrukturës sociale, permirsimi i aksesueshmerise	Permirson gjendjen dhe shperndarjen hapesinore te rrjeteve te sherbimeve, te infrastrukturave sociale dhe rrjetet e transportit, duke promovuar barazine e aksesit per popullaten (perfshire personat me aftesi te kufizuara)
15	Mbeshtetja e rritjes demografike nepermjet zhvillimit te sektorit te turizmit ne menyre qe te gjeneroje punesim te qendrushem dhe mundesi biznesi per komunitetin lokal	Forcimin e tregut lokal te punes, sidomos nepermjet krijimit te cilesis se larte dhe te perhershem, te punesimit ne turizem, ne menyre qe te ktheje trendet aktuale te rënies demografike dhe per te terehur popullaten e re (veçanerisht emigrantet), si banore te perhershem ne zone
16	Promovimi i zhvillimit te qendrushem te turizmit, i cili do te vepronte si nje katalizator i nje ekonomie te larmishme lokale te qendrushme gjate te gjithë vitit	Nxitja e zhvillimit te qendrushem te turizmit, me theks te veçante per te permirësuar cilësinë dhe per te zgjeruar gamen e sherbimeve, si dhe kohëzgjatjen e sezonit turistik, ne menyre qe te mbështes nje ekonomi te larmishme lokale, bazuar ne funksionimin suplementar te veprimtarive prodhuese
17	Zyrtarizimi i sektorit te turizmit, zhvillimi i infrastrukturës se turizmit me mjete publike dhe private, financimi i strukturës lokale dhe gjenerimi i aseteve si pjese e procesit te zhvillimit te pasurisë se paluajtshme	Nxitja e formalizmit te industrisë se turizmit lokal, ne menyre qe te rrisë te ardhurat bashkiake, financimin e infrastrukturës lokale (sherbimet, turizmin dhe infrastrukturën sociale) dhe te gjenerojë vlerën e tokës bashkiake
18	Rritja e dërgjegjësimit mjedisor dhe nxitja e veprimeve pi lote dhe iniciativave	Promovon veprimet masat qe kontribuojne per rritjen e vetedijes per mjedisin te popullsisë lokale, biznesit dhe vizitoreve; mbështet pjesëmarrjen e publikut ne vendim marrje dhe zhvillim.

4. Skenarët/ zgjidhjet alternative

4.1 Hyrje - Metodologjia

Për realizimin e VSM-se, ekipi i eksperteve duhet të vlerësojë efektet e mundshme mjedisore, sociale dhe ekonomike të Planit të Pergjithshem Vendor, si dhe të skenarëve të arsyeshëm që mund të ndiqen pa ekzistencën e këtij Plani specifik Vendor. Roli i VSM-së nuk është për të vendosur mbi zgjedhjen e alternativave, por të japi informacion mbi ecuritë përkatëse të performances mjedisore, shoqërore dhe ekonomike të alternativave të ndryshme, në mënyrë që të lehtësojë marrjen e vendimeve midis palëve të interesuara dhe të ofrojë amendamente pozitive dhe shtesa, në mënyrë që të përsosën dhe finalizohen udhëzimet e PPV.

Skenarët e ekzaminuar janë formuluar gjatë hartimit të Planit të Pergjithshem Vendor (specifikisht, gjatë fazës së Strategjise Territoriale). Duke marrë parasysh se, forma dhe intensiteti i zhvillimit të turizmit përbën faktorin kyç për të përballuar presionet dhe kërcënimet mjedisore për Himarën, ndonëse ajo mund të shërbejë si katalizator për të promovuar mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm lokal, skenarët e shqyrtuar janë strukturuar mbi një **vizion të zhvillimit të turizmit në të ardhmen**, në kuadër të llojit, intensitetit dhe të karakteristikave të përgjithshme të modelit të zhvillimit të turizmit dhe modelet hapësinore të zhvillimit.

Katër (4) skenarë janë ekzaminuar. Ata përfshijnë:

- 1) **Skenari Zero**, shembull për këtë është rasti kur nuk implementohet asnjë Plan ose propozim për zbatim, në të cilën zhvillimi hapësinor për zonën në studim zbaton praktikat ekzistuese.
- 2) Skenari i **tërheqjes së investimeve të jashtme nëpërmjet zhvillimit të ndërtimeve rezidenciale**, i cili e sheh Bashkinë Himarë të hapur ndaj influencave të jashtme nëpërmjet investimeve në pasuritë e patundshme (kryesisht rezidenciale) dhe shtëpi sekondare nga kompanitë e ndërtimit, etj.
- 3) Skenari i **zhvillimit në një formë të zbutur të turizmit masiv**, i cili mbështet promovimin e turizmit masiv të organizuar si bazë për zhvillimin ekonomik lokal, duke u përqendruar në zhvillimin bregdetar me hotele me kapacitete të mesme deri te ato më të mëdha si dhe resorte, duke lejuar të bëhet diferencimi i standardeve të akomodimit.
- 4) Skenari i **zhvillimit të turizmit të interesit të veçantë**, i cili kapitalizon trashëgiminë natyrore dhe kulturore, si bazë e identitetit të zonës si destinacion turistik, duke përfshirë llojet e ndryshme të turizmit dhe duke tërhequr kryesisht turistët e huaj nga Evropa dhe një përqindje të vogël të shqiptarëve me nivel të lartë jetese.

Në kuadrin e komenteve të mësipërme, vlerësimi i kryer në piken 4.2 bazohet mbi logjikën që është zhvilluar gjatë hartimit të Planit të Pergjithshem Vendor, **duke bërë një vlerësim sistematik të të gjitha opsioneve në bazë të objektive të VSM, identifikuar në kapitullin 3.** Në çdo rast, vlerësimi është strukturuar në mënyrë që të

nxjerrë në pah efektet pozitive të të gjitha alternativave, me qëllim që të evidentojë çështje të caktuara që duhet të përfshihen në skenarit të fundit.

Vlerësimi përmban një **përshkrim** të ndikimeve të pritshme të çdo alternative kundrejt objektivave të VSM dhe **është paraqitur grafikisht në një sistem shkalle graviteti**, ku:

- ++ simbol që përdoret, kur ndikimi i pritshëm konsiderohet si pozitiv;
- + simbol që përdoret, kur ndikimi i pritshëm konsiderohet të ketë potencial pozitiv;
- -- simbol që përdoret, kur ndikimi i pritshëm konsiderohet si negativ;
- - simbol që përdoret, kur ndikimi i pritshëm konsiderohet të ketë potencial negativ;
- 0 simbol që përdoret, nëse një alternativë pritet të ketë ndikim neutral;
- ? simbol që përdoret, në rastet kur një shkallë e konsiderueshme e pasigurisë karakterizon vlerësimin, meqenëse impakti varet shumë në marrëveshjet e zbatimit.

Në rastet kur një alternativë zhvillimi mund të ketë njëherazi dy **efekte, pozitive dhe negative**:

- ose në pjesë të veçanta të territorit në të njëjtën kohë,
 - ose në të gjithë zonën e studimit në periudha të ndryshme me kalimin e kohës,
- në një mënyrë që nuk do të jetë e mundur për të siguruar një klasifikim të përgjithshëm (simboli + / - do të përdoret).

Pjesa e fundit (4.3) ofron një **vlerësim krahasues** të të gjithë skenarëve në formate tabelore. Tabela tregon rezultatin e përgjithshëm të secilës alternativë dhe ndihmon për të identifikuar **pikat e forta të çdo alternative**. **Qëllimi i këtij ushtrimi është që të nxjerr në pah çështjet e veçanta dhe mundësitë zhvillimore që duhet të integrohet në Skenarin përfundimtar të përzgjedhur.**

4.2 Vlerësimi i Skenarëve

Skenari 1: Skenari Zero

Skenari Zero është i bazuar në vazhdimësinë e trendeve ekzistuese. Ai mund të quhet mbrojtës në sensin që mbron zonën nga ndikimet e jashtme dhe mban status quo. Himara mbetet një sistem i mbyllur, i cili varet nga investimet private në një shkallë të vogël me burime nga emigrantët në Greqi. Turizmi mbetet i paorganizuar dhe karakterizohet nga "informaliteti", pasi ai nuk është i regjistruar si aktivitet turistik. Më konkretisht, në këtë rast:

16. Ekonomi	++	>>/ >>>	afatgjatë sinergjik në rivitalizimin e vendbanimeve dhe përmbyshjen graduale te rënies se trendeve demografike dhe zhvillimeve ekonomike.	- Hartimi i një strategjie efektive të marketingut të bazuar në ndërtimin e një markë për Himarën.
17. Finance	+		Financimi për infrastrukturën e kërkuar është	

			një çështje thelbësore që ndikon në perspektivën e përgjithshme të zhvillimit lokal.	
18. Ndërgjegjësimi	+	>>/ >>>	Orientimi i zhvillimit drejt projektimit të cilësisë dhe zgjerimit të pamjes së qytetit nëpërmjet ndërhyrjeve të buta në hapësirën publike dhe renovimin gradual të ndërtimeve tradicionale, nëse kombinohen me sukses me rivitalizimin e zhvillimit ekonomik lokal dhe cilësisë së punësimit rreth turizmit, janë faktorë që mund të kontribuojnë në një ndryshim pozitiv të ndërgjegjësimit mjedisor të banorëve lokalë.	- Fushata drejtuar vizitorëve dhe bizneseve lokale duke theksuar rëndësinë e (a) respektimi i rregulloreve të ndërtimit dhe kufizimet dhe (b) ruajtja e hapësirës publike në një gjendje të pastër dhe të rregullt, duhen të promovohen nga ana e bashkise dhe shoqatave lokale të turizmit.

Orientime Strategjike 4: “Reduktimi i periferialitetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së komunitetit”

Janë identifikuar 4 programe për realizimin e këtij Drejtimi Strategjik:

1. Projektet e zhvillimit urban dhe përmirësimi i kërkesave sociale për vendbanimet. Bashkia e Himares duhet të forcojë pozitën e saj si një qendër shërbimesh midis Bashkisë Vlorë dhe Bashkisë Sarandë, jo vetëm nëpërmjet përmirësimit të funksioneve të saja portuale por edhe duke u mbështetur në zhvillimin e turizmit me ndikim rajonal. Bashkia Himarë ofron një shumëllojshmëri atraksionesh për turistët të cilat do të kombinohen me rikonstrukcionin e qendrave lokale dhe hapsirave publike si edhe zgjerimin e zonave rekreative publike, ndërtimin e qendrave dhe faciliteteve sportive. Bashkia Himarë duhet të përmirësojë pamjen e saj nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës sociale dhe teknike (rikonstrukcion i qendrave dhe ambulancave shëndetësore, zhvillim i infrastrukturës energjitike dhe telekomunikacionit) dhe të banesave të abandonuara në mënyrë që të tërheqë sa me shume banorë të përhershëm që do të vendosen në zonë gjate viteve te ardhshme.

2. Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë. Burimet ujore janë më se të mjaftueshme nga pikëpamja rajonale, por jo për çdo njësi dhe fshat të veçantë. Hulumtimi i rrjetit ekzistues evidenton struktura të veçanta për secilën njësi të veçante administrative. Koncepti i përdorimit në maksimum të burimeve ujore lokale bazuar në parametrat e tyre sasior dhe cilësor dhe që mbulon nevojat e pikut të zhvillimit të ardhshëm do të kërkojë përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë për të mbuluar zonat e populluara të Palasës, Dhërmiut, Gjilekës, Iliasit, Vunosë, Jalës, Himarës, Livadhit dhe Pilurit si dhe lidhjen me rrjetet e ardhshme të furnizimit me ujë të Himarës, Pilurit, Kudhësit dhe Qeparoit. Problemet e menaxhimit të ujit përfshijnë reduktimin e humbjeve teknike dhe lidhjeve ilegale, vendosjen jo të përshtatshëm dhe kapacitetin e pamjaftueshëm të rezervuarëve të ujit, mungesën e respektimit të zonave sanitare si dhe përdorimin e ujit të pijshëm për ujtitje.

3. Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe infrastrukturës së ujërave të ndotur. Riparimi dhe zgjerimi i furnizimit ekzistues me ujë dhe rrjeteve të kanalizimeve është i nevojshme për të mbuluar të gjithë zonën e populluar. Një zgjidhje e veçanta për trajtimin e ujërave të ndotura duhet të sigurohet për secilën zone. Parashikohet ndërtimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe të impianteve të përpunimit të ujit të ndotur për të gjithë fshatrat. Plani merr parasysh jo vetën ndërtimin e sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza por gjithashtu edhe ndërtimin e kolektorëve të drenazhit, eliminimin e shkarkimit të ujërave të zeza në det dhe ndërtimin e impianteve të trajtimit kompakt të parafabrikuar ose me grupa septike për fshatra të rëndësishëm dhe me nevoja specifike të gjithë Bashkisë Himarë. Plani parashikon kushtet teknike dhe financiare për ndërtimin e objekteve të shërbimit në zonat turistike dhe ato rezidenciale të zhvillimit si dhe në plazhe.

4. Organizimi në menaxhimin e mbetjeve është një problem i madh që kufizon potencialet e zhvillimit të turizmit dhe paraqet një rrezik shëndetësor për popullsinë, tokën dhe mjediset ujore. Zhvillimi dhe zbatimi i një plani të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Bashki dhe caktimi i një vendi që do të përdoret si depozitim tranzit, i veçantë ose dhe i përbashkët për të gjitha vendbanimet, në përputhje me standardet kombëtare mbeten përparësi absolute. Mbetet shumë e nevojshme gjithashtu edhe puna për promovimin e riciklimit dhe ndërgjegjësimin mjedisor për të gjithë popullatën e zonës.

Tabela 44: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i PPV-së së Bashkisë Himarë/ Orientimi Strategjik 4: Reduktimi i periferialitetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së komunitetit				
Nen-komponenti Programi 4.1: Projektet e zhvillimit urban dhe përmirësimi i lehtësirave sociale për vendbanimet				
Objektivat e VSM - se	Rëndësia	Kohe / Kohëzgjatja	Përshkrimi i ndikimit (duke përfshirë efektet akumuluese, sinergjike & anësore)	Masat - Akte Korrigjuese
1. Biodiversiteti	0		Forcimi i rolit ekonomik dhe rëndësia e qytetit të Himarës si një qendër shërbimi dhe si shtyllë e aktiviteteve do të imponojë stresa për mjedisin natyror të pellgut të Himarës si efekt anësor negativ të zhvillimit dhe rritjen e numrit të banorëve. Masat e duhura janë të nevojshme në mënyrë që të zbutin impaktin mjedisor të urbanizimit, turizmit dhe aktiviteteve ekonomike në tokë, ujë dhe në mjedisin detar, si dhe në prodhimin e mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme.	- Zhvillimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në vendndodhjen e caktuar sipas skemës së miratuar të Planit PZHBJ. - Zhvillimi i përpunimit të mbetjeve të ngurta dhe stacion transferimi në vendndodhjen e caktuar sipas skemës së miratuar të Planit PZHBJ. - Përgatitja e studimit të VNM-se, duke përfshirë studimin e ndikimit të Trafikut (SNT) për portin e Himarës. Theks i veçantë për të minimizuar veprat detare, për të shmangur/minimizuar gërmimet në shtratin e detit, vendosja e rregullave për shkarkimin e anijeve, parandalimi i aksidenteve nga pompat e karburantit, monitorimi i cilësisë së detit, gjetja e hapësirave të parkimit në mënyrë që të minimizojë ndikimet e dukshme dhe për lehtësojë aksesin e këmbësorëve dhe çiklisteve. - Zbatimi i rregulloreve për aktivitete rekreative në Potam dhe Spilea për kontrollin e ndotjes së zhurmës, në përputhje me nivelin e normave kombëtare dhe monitorimi i zbatimit të tyre.
2. Toka	-	>>/ >>>		
3. Ujë	-	>>/ >>>		
4. Mjedisi Detar	--	>>		
5. Ndotja e Ajrit	+	>>>		
6. Mbetje të Ngurta	-	>>		
7. Ujërat e Zeza	--	>>		
8. Zhurma	-	>>		
9. Peizazhi	-	>>		

10. Trashëgimia	-	>>	Përqendrimi i zhvillimit në zona të caktuara të përdorimit të tokës dhe përcaktimi i zonave të mbrojtura e të gjelbra peri-urbane do të kenë një kontribut pozitiv në eliminimin e shtrirjes dhe konfliktin potencial për përdorimin e tokës. Zonimi duhet të mbrojë identitetin e kështjellës së Himarës. Ndërtimet e reja do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së banimit me standardet bashkëkohore. Rritja e dendësisë së popullsisë do të rrisë nevojën për përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës urbane dhe aksesit të popullatës ndaj shërbimeve.	tampon rreth vendbanimeve. - Përcaktimi i lartësive të ndërtimit në Himarë dhe Livadh në një mënyrë që mos dëmtojë pamjet nga Kalaja. - Përmirësimi i imazhit dhe qasjes ndaj pamjes ballore urbane të bregut të Gjirit të Himarës (zhvillimi i një shëtitore bregdetare me aktivitete rekreative dhe aksesin në plazhet e Potamit dhe Spileas). - Orientimi i aktiviteteve ekonomike me efekt të mesëm në të lartë të ndikimit mjedisor (te përcaktuara në shtojcat 1 dhe 2 të Ligjit 8990/2003) në anën e pasme të qytetit të Himarës.
11. Cilësia e Projektimit	+	>/ >>		
12. Shtrirja	++	>/ >>		
13. Përdorimi i Tokës	++	>/ >>		
14. Rrjetet	?			
15. Demografia	++	>>/ >>>	Ky nënkomponent do të ketë një ndikim pozitiv afatmesëm për rritjen e atraktivitetit të Himarës si një vend për qëndrim të përhershëm që ofron një shumëllojshmëri të shërbimeve për popullatën lokale kombinuar me bukuritë e mjedisit natyror. Për më tepër ai do të ketë një ndikim pozitiv në zhvillimin e ekonomisë lokale të mbështetur në zhvillimin e shërbimeve turistike. Zhvillimi i veprimtarive tregtare në Spilea gjithashtu do të sigurojë të ardhura shtesë për popullatën lokale. Këto zhvillime do të kenë një efekt sinergjik në tërheqjen e investimeve dhe përmirësimin e të ardhurave bashkiake nëpërmjet taksimit.	
16. Ekonomi	++	>>		- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve bashkiake. - Zhvillimi i infrastrukturës sociale për banorët e rinj (shkollat, objektet kulturore dhe sportive) në bazë të standardeve kombëtare dhe udhëzimeve të paraqitura nëpërmjet Planit.
17. Finance	++	>/ >>		
18. Ndërgjegjësimi	?		Zhvillimi i intensifikuar rezidencial, turistik dhe tregtar do të kërkojë masa nga ana e bashkise në	- Fushata për ndërgjegjësimin mjedisor në shkolla dhe të organizatave profesionale.

			mënyrë që të rrisë ndërgjegjësimin mjedisor të komunitetit lokal dhe vizitorëve.	
--	--	--	--	--

Tabela 45: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i PPV-së së Bashkisë Himarë / Orientimi Strategjik 4: Reduktimi i periferialitetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së komunitetit				
Nen- komponenti Programi 4.2: Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë				
Objektivat e VSM -se	Rëndësia	Kohe / Kohëzgjatja	Përshkrimi i ndikimit (duke përfshirë efektet akumuluese, sinergjike & anësore)	Masat - Akte Korrigjuese
1. Biodiversiteti	+	>	Ky nënkomponent do të ketë një ndikim pozitiv në shëndetin publik duke përmirësuar cilësinë e ujit. Planifikimi në nivel rajonal do të rrisë ekonominë në burime dhe do të ulë presionet ekzistuese mbi burimet ujore lokale, që kanë një efekt të përgjithshëm pozitiv sinergjik në sistemet e ujit dhe biodiversitetin.	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e mbrojtjes së burimeve ujore dhe sistemeve të lumenjve, duke respektuar zonat sanitare në mbrojtjen e ligjit 8093/1996 dhe rregulloret e Planit. - Sigurimi i vendeve të reja të ndërtimit për rezervuarët e ujit, sipas propozimeve të planit dhe të ujit duke respektuar rezervuarët sanitare të zonave. - Minimizimi i humbjeve në rrjetet e furnizimit me ujë. - Minimizimi i përdorimit të ujit të pijshëm për ujitje dhe promovimi i riciklimit të ujit.
2. Toka	0			
3. Ujë	++	>>/ >>>		
4. Mjedisi Detar	+	>		
5. Ndotja e Ajrit	0			
6. Mbetje të Ngurta	0			
7. Ujërat e Zeza	+	>>		
8. Zhurma	0			
9. Peizazhi	0		Ky nënkomponent nuk ka rëndësi të drejtpërdrejtë për modelin e zhvillimit territorial megjithatë ai do të ndikojë pozitivisht kushtet e jetesës të popullatës lokale duke siguruar furnizim të vazhdueshëm dhe efikas të ujit në të gjitha pjesët e territorit gjatë gjithë vitit.	Nuk janë propozuar masa shtese
10. Trashëgimia	0			
11. Cilësia e Projektimit	0			
12. Shtrirja	0			
13. Përdorimi i Tokës	0			
14. Rrjetet	++	>>		
15. Demografia	+	>>/ >>>	Ky Nënkomponent do të ketë një efekt pozitiv sinergjik në zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të zonës, duke përmirësuar një parametër kyç i cilësisë së	Nuk janë propozuar masa shtese
16. Ekonomi	+	>>/ >>>		

17. Finance	+	>>	jetës së popullatës lokale. Masterplani do të mundësojë menaxhimin më efikas të ujit, regjistrimin e konsumit dhe planifikimin e investimeve të ardhshme, duke përmirësuar administrimin financiar të bashkise.	
18. Ndërgjegjësimi	+	>>	Ky nënkomponent do të ketë një efekt sinergjik në ngritjen e vetëdijes së popullatës lokale për përdorimin e ujit te përshtatshëm.	Nuk janë propozuar masa shtese

Tabela 46: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i PPV-së së Bashkisë Himarë/ Orientimi Strategjik 4: Reduktimi i periferialitetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së komunitetit				
Nen- komponenti Programi 4.3: Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe infrastrukturës së ujërave të ndotur				
Objektivat e VSM -se	Rëndësia	Kohë / Kohëzgjatja	Përshkrimi i ndi kimit (duke pë rfshirë efektet akumuluese, sinergjike & anësore)	Masat - Akte Korrigjuese
1. Biodiversiteti	+	>>>	Ky nënkomponent do të ketë një ndikim të përgjithshëm pozitiv në mjedisin natyror të zonës me trajtimin e problemit të shkarkimeve të lumenjve, përrrenjve dhe detit, duke minimizuar presionin mbi burimet ujore, ujit te detit dhe mjedisin detar, si dhe reduktimin e ndotjes së tokës nga përdorimi aktual i gropave septike.	<ul style="list-style-type: none"> - Prioritet zhvillimin e rrjetit në Himarë dhe Dhërmi. - Ndarja e një pjesë të të ardhurave në rritje nga zhvillimi i turizmit bregdetar për të zbatuar rrjetet e vendbanimeve malore. - Zhvillimi i impianteve te trajtimit të ujërave të zeza në vendin e caktuar sipas skemës së miratuar të Planit PZHBJ. - Për zonat T2: Zhvillimi i objekteve të trajtimit të ujërave të zeza, si një kusht për ndikimin në lejet e zhvillimit, vendosja e një shkallë të caktuar të riciklimit të ujit për ujitje. - Për zonat T1: Studime të iniciuara nga Bashkia për zhvillimin e objekteve të trajtimit të ujërave të zeza në të gjitha zonat turistike brenda gjashtë muajve nga miratimi i Planit. - Për të gjitha zonat e tjera: Zhvillimi i zgjidhjeve individuale për trajtimin e mbetjeve të lëngshme të kërkuara në fazën e lejes së zhvillimit.
2. Toka	++	>>/ >>>		
3. Ujë	++	>>/ >>>		
4. Mjedisi Detar	++	>>		
5. Ndotja e Ajrit	0			
6. Mbetje te Ngurta	0			
7. Ujërat e Zeza	++	>>		
8. Zhurma	0			
9. Peizazhi	0			
10. Trashëgimia	0			
			Ky nënkomponent nuk ka një korrelacion të drejtpërdrejtë në modelin e zhvillimit	Nuk janë propozuar masa shtese

11. Cilësia e Projektimit	0		territorial, por është një faktor kyç në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës lokale nëpërmjet sigurimit të aksesit në shërbime. Përmirësimi i infrastrukturës do të ketë një efekt pozitiv sinergjik në frenimin urban duke bërë zona të caktuara të zhvillimit më tërheqëse për investimet e ndërtimit.	
12. Shtrirja	+			
13. Përdorimi i Tokës	0			
14. Rrjetet	++	>>		
15. Demografia	++	>>/ >>>	Ky nënkomponent do të rrisë atraktivitetin e zonës si një vend për qëndrim të përhershëm. Në këtë mënyrë ka një efekt pozitiv sinergjik për problemin e shterimit demografik dhe të kontribuojë në zhvillimin e shëndetshëm socio-ekonomik.	Nuk janë propozuar masa shtese
16. Ekonomi	+	>>/ >>>		
17. Financë	+	>		
18. Ndërgjegjësimi	+	>>	Ky nënkomponent do të ketë një efekt sinergjik në ngritjen e vetëdijes së popullatës lokale.	Nuk janë propozuar masa shtese

Tabela 47: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i PPV-së së Bashkisë Himarë / Orientimi Strategjik 4: Reduktimi i periferialitetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së komunitetit				
Nen- komponenti Programi 4.4: Organizimi në menaxhimin e mbetjeve				
Objektivat e VSM -së	Rëndësia	Kohë / Kohëzgjatja	Përshkrimi i ndikimit (duke përfshirë efektet akumuluese, sinergjike & anësore)	Masat - Akte Korrigjuese
1. Biodiversiteti	+	>>>	Ky nënkomponent do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në ndotjen e tokës, në cilësinë e burimeve ujore dhe mjedisit detar duke eliminuar problemin e mbetjeve urbane që ndot ujëmbajtësit dhe transportohen në det nëpërmjet lumenjve dhe përrenjve. Ndalimi i djegies së paligjshme të mbeturinave do të ketë një efekt pozitiv sinergjik në përmirësimin e cilësisë së ajrit.	- Zhvillimi i përpunimit të mbetjeve të ngurta dhe stacion transferimi në vendndodhjen e caktuar sipas skemës së miratuar të Planit PZHBJ. - Zbatimi i menaxhimit të programit bashkiak të mbeturinave.
2. Toka	++	>>/ >>>		
3. Ujë	++	>>/ >>>		
4. Mjedi detar	+	>>/ >>>		
5. Ndotja e Ajrit	+	>>/ >>>		
6. Mbetje të Ngurta	++	>>		
7. Ujërat e Zeza	0			
8. Zhurma	0		Ky nënkomponent do të ketë një efekt pozitiv në ngritjen e standardit jetësor të popullatës lokale. Eliminimi i hedhjes së paligjshme e mbetjeve do të ketë një ndikim pozitiv në mbrojtjen e peizazhit të zonës. Vendosja e një sistemi efikas të menaxhimit të mbeturinave do të përmirësojë aksesin e popullsisë lokale në shërbimet bashkiake.	Nuk janë propozuar masa shtese.
9. Peizazhi	+	>>		
10. Trashëgimia	0			
11. Cilësia e Projektimit	0			
12. Shtrirja	0			
13. Përdorimi i Tokës	0		Menaxhimi më i mirë i mbeturinave do të rrisë atraktivitetin e zonës për popullatën lokale dhe vizitorët, duke krijuar kushtet e duhura për zhvillimin e turizmit cilësor. Kjo mund të ketë një efekt pozitiv sinergjik në zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të zonës.	Nuk janë propozuar masa shtese.
14. Rrjetet	++	>>		
15. Demografia	+	>>>		
16. Ekonomi	+	>>/ >>>		
17. Finance	0			

18. Ndërgjegjësimi	+	>>	Ky nënkomponent do të ketë një efekt sinergjik në ngritjen e vetëdijes së popullatës lokale.	Nuk janë propozuar masa shtese.
---------------------------	---	----	--	---------------------------------

6. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I SISTEMIT TË PLAN - MONITORIMIT

6.1 Vlerësim i përgjithshëm

Ky projekt përfshin përgatitjen e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit të Bashkisë Himarë (PPVTB) sipas ndarjes së re territoriale ku koncepti kyç është promovimi i **zhvillimit** dhe **turizmit të qëndrueshëm** në zonë, i cili adreson nevojën për të mbrojtur burimet e vlefshme dhe për të promovuar menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke minimizuar ndikimet negative në mjedis të zhvillimit lokal dhe të infrastrukturës.

Zona bregdetare Himarë, e cila përbën pjesën më të madhe dhe më tërheqëse të Rivierës shqiptare, është një rast unik i njësisë territoriale me karakteristika të dallueshme, që aktualisht përballet me një dilemë të madhe në lidhje me zhvillimin e saj të ardhshëm. Ndërkohë potenciali për zhvillimin e turizmit duket se ka kapacitete që mund të sjellin përmirësime rrënjësore të kapitalit vendas dhe të cilësisë së jetës së popullatës lokale.

Nivelet e monitorimit deri më sot në këtë bashki kanë qenë në nivele të pakënaqshme gjë e cila lidhet me shumëfaktorë. Duke qenë se sot tendenca e turizmit ecën në drejtim të rritjes së kërkesave lind nevoja për një monitorim të vazhdueshëm. Mungesa e kapaciteteve monitoruese si për nga teknologjia ashtu edhe ai njerëzor e vështirëson monitorimin, për këtë arsye ekspertët kanë përpunuar një sistem monitorues të thjeshtë i cili reflekton një nivel mesatar zhvillimi dhe kërkesash për aftësi të stafit, për një të një Bashki Evropiane të një niveli të mesatar. Sistemi përputhet me të gjitha kërkesat kombëtare dhe parashikon edhe kërkesa të reja për integrim në të ardhmen që mund të lindin si rezultat i marrëveshjeve ndërkombëtare që mund të lidhë qeveria shqiptare.

Siç është thënë edhe në kapitujt pararendës sistemi i monitorimit dhe në mënyrë të veçantë objektivat dhe treguesit janë rrjedhojë direkte e punës së detajuar të vlerësimit dhe e nevojës për të ndjekur pranë evoluimin e implementimit të planit paralelisht me masat e detajuara të impaktit.

Në varësi nga niveli i ekspertizës së administrimit të bashkisë, të sistemit ekzistues të monitorimit kombëtar, në varësi dhe të kompleksitetit të zhvillimit dhe të disa parametrave të tjerë mjedisor, sistemi i monitorimit të VSM luhatet nga mjaft i thjeshtë në mjaft i ndërlikuar, të dyja këto duke u bazuar si në të dhënat e grumbulluara deri më tani e deri tek mjetet e monitorimit dhe metodologjia.

Sistemi është mjaft fleksibël dhe mund të bëhet mjaft i ndërlikuar kur flitet për mjetet dhe matjet (p.sh kur flitet për treguesit mjedisorë dhe matjet e tyre në stacione e specializuara) dhe nëse duhet, zhvillimi ekonomik i mundëson këto mjete.

Sistemi është bazuar kryesisht në ato të dhëna që janë gjetur dhe grumbulluar nga administrata aktuale për fusha të ndryshme, nga të dhëna në nivel kombëtar, në raportet dhe kërkimet e realizuara për **Plani Vendor** si dhe në potencialin e eksperteve dhe të aftësive të tyre.

Ekspertët u munduan të optimizojnë midis kërkesës dhe realitetit për matje të mundshme si dhe ndjekjen e vazhdueshme për monitorime, duke mos e rënduar administratën.

6.2 Sistemi i monitorimit

Qëllimet dhe objektivat e VSM si dhe masat zbutëse lidhur me mjedisin janë paraqitur edhe në kapitujt e mëparshëm.

Më qëllim që VSM të ketë një përdorim praktik për administratën e bashkisë dhe për shtresat e interesuara, do të ishte e nevojshme vendosja e një numri indikatorësh dhe një sistemi monitorimi që do ta bënin atë sa më të thjeshtë dhe praktik, duke përdorur si burimet ekzistuese ashtu dhe aktivitetet shtesë.

Sistemi i monitorimit do tu mundësojë grupeve të interesit:

- a) Monitorimin e progresit drejt objektivave të VSM
- b) Monitorimin e efekteve mjedisore që vijnë nga zbatimi i PPV
- c) Identifikim e efekteve negative të paparashikuara mbi mjedisin apo të paralajmërohen në stadi të hershme
- d) Mundësim për veprime korrigjuese të përshtatshme

Sistemi i indikatorëve të monitorimit, i qëllimeve dhe metodave të matjes do të paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Një proces rishikimi dhe monitorimi është përgatitur për tu përfshirë në një raport vjetor, që do të hartohet nga sektori i mjedisit në administratën e bashkisë (me ndihmën e eksperteve kur është e nevojshme) dhe që do t'i paraqitet Këshillit Bashkiak.

Është propozuar që informacioni i mjedisit të përditësohet çdo 6 muaj me qëllim për të siguruar një paralajmërim në kohë të përshtatshme në rastet e një dëmtimi serioz mjedisor, pavarësisht që raporti i monitorimit të VSM është vjetor.

Sistemi i monitorimit do tu mundësojë grupeve të interesit të bashkisë të vlerësojnë nga pikëpamja mjedisore, strategji dhe programe të tjera që mund të zbatohen në të ardhmen, duke ndjekur iniciativat e Këshillit Bashkiak dhe mundësi apo programe të BE.

Procesi i monitorimit të VSM duhet të ecë që sot e tutje paralelisht me zbatimin e PPV duke u bërë pjesë integrale e tij.

Të gjithë qëllimet dhe të dhënat janë të bazuara në objektivat e PPV dhe standardet kombëtare. Në rrugën e zbatimit mundet që Shqipëria të përshtatë edhe më tej standardet e saja me ato të BE-se apo nga marrëveshje ndërkombëtare të reja (p.sh për cilësinë e ajrit, objektivat për klimën dhe efektin serrë etj), duke bërë kështu të mundur që sistemi i monitorimit të përmirësohet me këto objektiva të reja (si dhe arritje të tjera të rëndësishme).

Poshtë janë siguruar disa të dhëna bazë ekzistuese lidhur me gjendjen aktuale si dhe disa vlera normale për parametra të ndryshëm.

6.2.1 Normat për parametrat e ujit të pijshëm

Bashkia në bashkëpunim me institucione të tjera duhet të monitorojë dhe të ulë disa vlera të parametrave të ujit të pijshëm në përputhje me ato kombëtare dhe ato ndërkombëtare si Direktiva /98/83/EC apo standardet e OBSH. Duke u bazuar në disa studime që lidhen me zonën ujërat janë të një cilësie të mirë dhe që mund të përdoren pasi kanë marrë trajtimin e duhur. Pjesa më e madhe e këtyre burimeve të ujit të pijshëm gjenden në fshatrat Pilur, Kudhës, Dhërmi, Vuno, Qeparo-fshat, Ilias, Jal, Borsh dhe Lukove dhe që praktikisht duke u nisur nga pozicioni i tyre ato mund të quhen të mbrojtura nga ndotësit e mundshëm pasi gjenden larg zonave urbane dhe atyre në zhvillim. Sidoqoftë mungon monitorimi dhe matjet e parametrave të ndryshëm sipas ligjit në fuqi si nga ana e Bashkisë ashtu edhe nga institucionet përgjegjëse. Analiza sporadike janë kryer për disa nga parametrat fiziko-kimik të burimeve të mësipërme, por që janë krejtësisht të pamjaftueshme për ta bërë ujin e këtyre fshatrave të pijshëm. Vetëm shtatë parametra janë matur nga 48 të tilla që duhen monitoruar në bazë të normave kombëtare dhe ndërkombëtare. Situata paraqitet më shqetësuese në burimet që ndodhen në Himarë, Livadh, Porto Palermo dhe Qeparo-fushë, pasi ato nuk plotësojnë kushtet e zonës sanitare. Disa parametra kimikë, mikrobiologjikë, pesticide dhe komponime organike janë plotësisht jashtë monitorimit dhe nuk kanë asnjë vlerë për to. Është shumë e rëndësishme për shëndetin publik që këto parametra të jenë nën monitorim për tu mbajtur në nivelet e lejuara. Të gjitha zonat përreth burimeve ujore duhet të konsiderohen dhe të shpallen Zona Sanitare të Mbrojtura bazuar kjo edhe në ligj (Ligj Nr. 8093, 21.3.1996, Nr. 111/2012).

Tabela 48: M.1: Treguesit dhe objektivat e treguesve fiziko-kimike të ujit të pijshëm në Bashkinë Himarë

Nr	Treguesit kimike	Vlerat e monitoruara të ujit të pijshëm në Bashkinë Himarë	Standarde Kombëtare ml/ujë	Max	Objektiva nga 2018 (Direktiva e Këshillit 98/83/EC & te tjera)
----	------------------	--	----------------------------	-----	--

1	Shija dhe era (numër hollimi)			2deg12 ⁰ C , 3deg25 ⁰ C	E pranueshme nga konsumatorët dhe nuk ka ndryshim jo të rregullt
2	Ngjyra dhe pamja e jashtme (mg/l shkalla Pt/Co)		1	20	E pranueshme nga konsumatorët dhe nuk ka ndryshim jo të rregullt
3	pH		6,5-8,5	9,5	≥ 6.5 dhe ≤ 9.5
4	Konduktiviteti elektrik (µS/cm)		400		2500
5	Kalcium (mg/l)		75	200	200
6	Lendet pezull (mg/l)				0
7	Turbullira (FTU)		0.4	4	Nuk ka udhëzime
8	Alkaliniteti (mg ekv/l)			n.v	Acc.pH
9	Karbonate (mg/l)				250
10	Bikarbonate (HCO ₃ ⁻) (mg/l)		H ₂ O not CaCO ₃	n.v	Ac.pH
11	Amonjak (mg/l)		0	0,05	0.50
12	Nitrite (mg/l)		0	0,05	0.5
13	Nitrate (mg/l)		25	50	50
14	Fortësia Totale (°german)			20	36-71
15	Fosfate (mg/l)		0,4	2,5	2.5
16	Lëndë Organike (mg/l)		1	3	3
17	Klorure (mg/l)		25	200	250
18	Sulfate (mg/l)		25	250	250
19	TDS (mg/l)		500		≤1500
20	Magnez (mg/l)		20	50	0.05

Tabela 49 : M.2: Treguesit mikrobiologjike të ujit të pijshëm të Bashkisë Himarë (burimi ISHP) dhe objektiva përkatëse

N ^o	Treguesit mikrobiologjike	Pus i përbashkët para Klorinimit	Vlerat në Bashki	Standarde kombëtare ml/ujë	Objektiva nga 2016 Direktiva e Këshillit 98/83/KE ml/ujë
1	E. Coli			0/100	0/250
2	Strept			0/100	0/250
3	Pseudomonas aeruginosa			n.v	0/250
4	Numri i kolonive 22°C			n.v	100/ml
5	Numri i kolonive			n.v	20/ml

37°C				
------	--	--	--	--

6.2.2 Monitorimi i ujit të detit

Deti përbën burimin kryesor të të ardhurave direkte dhe indirekte të bashkisë Himarë për këtë arsye ai është një element shumë i rëndësishëm për këtë bashki dhe duhet monitoruar për të përcaktuar zonat e ndotura dhe ato të pastra. Ndërkombëtarizimi i përbërjes së turistëve vitet e fundi e bën të detyrueshme krahasimin e parametrave të ujit me ato të standardeve europiane.

Bashkia ka detyrimin ligjor dhe është përgjegjëse për marrjen e kampioneve të ujit në zonat e plazheve duke e identifikuar atë. Bashkia duhet të kryejë të paktën pesë (5) monitorime nëpërmjet kampioneve të ujit të marra në plazhet e identifikuara për çdo sezon plazhi, duke filluar nga një kampion për sezonin para fillimit të sezonit veror dhe katër të tjera gjatë sezonit veror. Si sezon plazhi të konsiderohet nga 1 Qershori deri në 1 Shtator dhe para-sezon nga 15 Maji deri në 31 Maj.

Tabela 50: M.3: Kërkesat Cilësore të ujërave të plazheve në përputhje me BE		
Direktiva e KE për cilësinë e ujërave të plazheve (76/160/EEC)		
Parametra	Udhëzim	I detyrueshëm
Mikrobiologjike		
Totali i coliform (Numri/100ml)	$\leq 500^1$	$\leq 10,000^3$
Foecal coliform (Numri/100ml)	$\leq 100^1$	$\leq 2,000^3$
Fiziko-kimike		
Vajra minerale (mg/l)	$\leq 0.3^2$	Jo film dukshme në sipërfaqen e ujit dhe pa erë ³
Substanca me sipërfaqe aktive (mg/l)	$\leq 0.3^2$	Jo shkume të qëndrueshme ³
Fenol (mg/l as C ₄ H ₃ OH)	$\leq 0.005^2$	Nuk ka ere specifike $\leq 0.05^3$

Shënim1: $\geq 80\%$ të kampioneve - Shënim 2: $\geq 90\%$ të kampioneve - Shënim 3: $\geq 95\%$ të kampioneve

Është shumë e rëndësishme për zonën dhe Bashkinë që, sikurse edhe për bashkitë fqinje, të mund të kryejë këtë monitorim të këtyre parametrave brenda vitit **2017**. Rezultatet e monitorimit duhet edhe të shërbejnë si bazë për masat e nevojshme që duhen marrë. Rezultatet duhen të bëhen të njohura me mënyra të ndryshme për publikun si dhe përmes faqes së internetit të Bashkisë. Bashkia në bazë të rezultateve mund të hartojë një hartë me cilësinë e ujërave dhe plazheve.

6.2.3 Cilësia e ajrit dhe standardet

Në analizën e gjendjes aktuale në bashkinë Himarë, vlerësimi i cilësisë së ajrit është monitoruar nga institucionet përkatëse por jo në mënyrë të rregullt sipas standardeve. Nga rezultatet e pjeshme ai nuk rezulton shqetësues, por duke marrë parasysh zhvillimin e zonës Bashkia duhet të sigurojë dhe të synojë që parametrat e cilësisë së ajrit të mbeten të mbeten brenda kufijve të përcaktuara si normale nga Direktiva 2008/50/EC për cilësinë e ajrit si dhe bazuar në Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe Ligjin nr. 162, date 04.12.2014 " Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit". Bashkia duhet të monitorojë nivelin e ndotësve në mënyrë

periodike sidomos gjatë sezonit veror, dy herë gjatë muajve korrik dhe gusht dhe të paktën njëherë jashtë këtij sezoni. Në varësi të monitorimeve Bashkia duhet edhe të marrë masat e nevojshme për uljen apo ruajtjen e vlerave brenda standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Strategjia e mjedisit 2015-20 përcakton objektivat e qeverisë shqiptare për një numër ndotësish si: (i) ulja me 40% e nivelit të ndotjes në zonat urbane; (ii) arritja e niveleve të ndotësve të ajrit, bazuar në shëndetin human, në vlerat përkatëse: për NO_x - $40 \mu/m^3$; për PM_{10} - $40 \mu/m^3$; për $PM_{2,5}$ - $25 \mu/m^3$ dhe $20 \mu/m^3$ dhe SO_2 - $125 \mu/m^3$ për 24 orë ose $20 \mu/m^3$ në vit.

Tabela 51: M.4: Vlerat e kufi të ndotësve (burimi ISHP)				
Periudha e Monitorimit				Objektiva nga 2016
Ndotësit	Metoda	Vlera e periudhës mesatare	Standarde AL	Standarde e BE
($\mu g/m^3$)			($\mu g/m^3$)	($\mu g/m^3$)
Pluhuri total	gravm		140	80
PM_{10}	ads		40	40
O_3	ads		120	110
NO_2	ads		50	40

Tabela 52: M.5: Niveli i kufi i ndotësve të ajrit për tu monitoruar në Bashkinë Himarë			
Ndotësit	Përqendrimi	Periudha Mesatare	Te monitorohet dhe zvogëlohet nga viti
Grimcat e Imëta ($PM_{2.5}$)	$25 \mu g/m^3$	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2015
Dyoksidi i Squfurit (SO_2)	$350 \mu g/m^3$	1 ore	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2014
	$125 \mu g/m^3$	24 ore	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
Dyoksid Azoti (NO_2)	$200 \mu g/m^3$	1 ore	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
	$40 \mu g/m^3$	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 1.1.2014
PM_{10}	$50 \mu g/m^3$	24 ore	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
	$40 \mu g/m^3$	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
PLUMB (Pb)	$0.5 \mu g/m^3$	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
Monoksid Karbon (CO)	$10 mg/m^3$	Maksimalja ditore 8 ore mesatarja	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
Benzen	$5 \mu g/m^3$	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2010
Ozon	$120 \mu g/m^3$	Maksimalja ditore 8 ore mesatarja	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2010
Arsenik (As)	$6 ng/m^3$	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016

Cadmium (Cd)	5 ng/m ³	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
Nikel (Ni)	20 ng/m ³	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
Hidrokarbure Aromatike Policiklike	1 ng/m ³ (i shprehur si përqendrim i benzenit (a)pirene)	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
PM2.5 Përqendrim i ekspozuar i detyruar	20 µg/m ³ TME (Treguesi Mesatar i Ekspozimit)	Bazuar ne Mesataren e 3 viteve	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2018

Bashkia duhet gjithashtu të përgatisë një plan apo program për të siguruar përputhshmërinë e vlerave me standardet përpara datës së synuar limit të përcaktuar në tabelat e mësipërme. Gjithashtu Bashkia duhet të marrë masat për të siguruar transparencën lidhur me informacioni mbi cilësinë e ajrit për grupet e interesit dhe publikun.

6.2.4 Ndotja akustike

Të dhënat mbi ndotjen akustike në Bashkinë e Himarës mbeten brenda intervaleve të lejuara me përjashtime (sipas një sondazh i realizuar gjatë periudhës të vlerësimit të territorit) në disa plazhe të njohura të bashkisë, ku gjatë sezonit veror lokalet gjatëditës dhe natës krijojnë shqetësime me muzikën e tyre. Një bazë të dhënash lidhur me nivelin e zhurmave në zonë sigurisht që do të ndihmonte shumë në përcaktimin e saktë të masave që duheshin marrë në zonat më të ndjeshme për të siguruar një zonë turistike të shëndetshme dhe relaksuese.

Në përgjithësi **vlera e synuar për zh urmat** nuk duhet të kalojë vlerën maksimale prej **Lmax-56 dB** gjatë ditës dhe **45 dB** gjatë natës në të gjitha zonat e Bashkisë. Për të realizuar këtë duhen marrë masa të përshtatshme që të jenë në përputhje me parimet dhe objektivat kombëtare dhe ato ndërkombëtare e sidomos me Direktivën e Zhurmave në Mjedis 2002/49/EC.

6.2.5 Synimet për mbetjet

Bashkia e Himarës për nga sasi të llogaritura gjeneron në tërësi rreth 8 800t mbetje në vit, pra sasia është modeste. Me zhvillimin e mëtejshëm të turizmit dhe rritjes së agro-turizmit në zonë premisat janë për rritje të sasisë së mbetjeve dhe autoritet vendore duhet të synojnë një ulje të gjenerimit të tyre. Kjo mund të arrihet duke u bazuar në një numër të madh ligjesh dhe VKM (Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “ Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; Vendim nr. 705, datë 10.10.2012 “ Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”; Vendim nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”; Vendim nr. 178, datë

6.3.2012 “ Për incinerimin e mbetjeve”; Vendim nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lëndfilllet e mbetjeve”; Vendim nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”; Vendim nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”; Vendim nr.957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”; Vendim nr.117, datë 13.02.2013 “Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje; Vendim nr. 52 datë 5.2.2014 “Për disa ndryshime ne vendimin nr.117, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje”; Vendim nr. 798, datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”; Vendim nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”; Vendim nr.371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”; Vendim nr.418, datë 25.06.2014 ” Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”; Vendim nr.608, datë 17.09.2014 ”Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”;Vendim nr. 641, datë 01.10.2014 “Per miratimin e rregullave per eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit te mbetjeve jo te rrezikshme e të mbetjeve inerte” dhe ligjin përimportin e mbetjeve 2016) parimet e strategjise kombëtare dhe ligjit mbi menaxhimin e mbetjeve si dhe duke zbatuar tre parimet të BE lidhur me reduktimin e sasisë së mbetjeve: 1. Parandalimi të krijimit të mbetjeve; 2. Duke ndihmuar në riciklim dhe ripërdorim; 3. Duke përmirësuar grumbullimin final të mbetjeve dhe duke monitoruar. Kjo qasje e re do të çojë në një përmirësim të gjendjes së mbetjeve në të ardhmen.

1. **Parandalimi i krijimit të mbetjeve:** Ky është një faktor kyç në strategjinë e menaxhimit të mbetjeve. Bashkia duhet të synojë pakësimin e krijimit të sasisë së mbetjeve që në origjinë si dhe reduktimin e rrezikut që vjen prej tyre nga pakësimi i substancave të dëmshme, për pasojë edhe hedhja e grumbullimi i tyre do të jetë automatikisht më i thjeshtë.
2. **Ndihmë për i ndustrinë e ri ciklimit:** Organizimi nga ana Bashkisë i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, do të rrisë interesin e industrisë së riciklimit për grumbullimin dhe largimin e tyre nga zona.
3. **Përmirësimi hedhjes së mbetjeve dhe monitorimi:** Atje ku është e mundur, për mbetjet të cilat nuk mund të riciklohen dhe të ripërdoren ato duhet të dërgohen në incinerator dhe në mundësi të fundit në landfill. Të dyja këto mundësi kërkojnë një monitorim të kujdesshëm pasi mund të sjellin dëmtime serioze për mjedisin.
4. **Shmangie të hedhjes së mbetjeve** det, në shtretërit e përrrenjve dhe lumenjve, buzë rruës apo në çdo vend tjetër jo të destinuar për hedhje mbetjesh. Një synim i menjëhershëm duhet të jetë monitorimi i aktivitetit të ndërtimit, industrive prodhuese dhe turizmit.

Në tabelën e mëposhtme jepen disa objektiva dhe synime kohore lidhur me qasjen e përmendur me sipër.

Tabela 53: M.6: Objektivat për reduktimi e mbetjeve		
Parimi	Objektiva	Nga viti
Asgjësimi i mbetjeve që shkojnë në landfill	Reduktimi në masën 55%;	2020
Riciklimi dhe ripërdorimi	Mbledhja e diferencuar e mbetjeve nga 35%	2020
Përmirësimi i asgjësimit përfundimtar dhe monitorimi	Të gjitha mbetjet e mbledhura me 100%	2017
Shmangia e asgjësimit në shtretër të lumenjve dhe rrugëve anësore	Të gjitha mbetjet 100%	2017
Asgjësimi në landfille në mënyrë të kontrolluar	Në masën 35%	2017
Monitorimi i mbetjeve të industrisë së peshkut dhe akuakulturës	Shmangia e rritjes së peshkut në gjire të mbyllura nga 100%	2017
Portet e reja dhe ekzistuese (marina)	Shmangia e derdhjes së naftës dhe mbeturinave të tjera në det	2017

6.2.6 Ujërat e ndotura

Në bazë të Strategjisë Kombëtare brenda vitit 2020 të arrihet plotësisht mbrojtja e ekosistemeve lumore: a)Të realizohet mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ujerave nepermjet zbatimit te Planeve të Menaxhimit të Burimeve Ujore brenda vitit 2020; b)Monitorimi i vazhdueshem i cilesise se ujerave siperfaqesore dhe nentokesore nga institucionet përgjegjëse në bashkepunim me MM.

Në tabelat e mëposhtme ekspertët kanë vendosur disa objektiva dhe synime të reja kohore, në mungesë të një synimi të ri në nivel kombëtar, për ujërat e ndotura dhe çështjet e lidhura me to. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh që niveli i kanalizimeve është mjaft i ulët në këtë bashki (nuk ka asnjë rrjet të mirëfilltë ujërash të ndotura ose gjenden vetëm gropa septike aspak të ndërtuara sipas standardeve), rritet nevoja e monitorimit si dhe ndërtimit të infrastrukturës përkatëse duke siguruar mbrojtjen e shëndetit të popullatës.

Tabela 54: M.7: Objektivat e reduktimit të ndotjes së ujit

Parimi	Objektiva	Nga viti
Menaxhimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore me qëllim reduktimin krahasuar me vitin 2011 të ndotjes së tyre	Reduktimi i ndotjes 95 %	2020
Riciklimi dhe ripërdorimi i ujit për qëllime të ujitjes	Riciklimi %	2020
Përmirësimi i kriterëve për licenca të reja dhe për ripërtëritje (industriale dhe bujqësore) dhe monitorimi	Kriter i ri dhe monitorimi 100%	2018
Shmangia e shkarkimit të ujit të ndotur nga agroturizmi në përrenj dhe lumenj (pa trajtim paraprak) dhe nga peshkimi	Të gjitha shkarkimet nga 100%	2017
Ndërtimi i rrjetit të ujërave të zeza apo i sistemeve individuale (ujërat urbane dhe mbeturinat)	Mbulimi me rrjet i të dyjave 80%	2020
Përmirësimi dhe ndërtimi i gropave septike sipas standardeve të BE-së (të gjitha fshatrat)	Pjesa tjetër e zonës 100%	2020

6.2.7 Monitorimi i pyjeve, hapësirave të gjelbra dhe të mbrojtura

Hapësirës e pyllëzuar vetëm për Horë-Vranisht përbëhet nga 8774 ha pyje dhe 1494 ha kullota dhe sipërfaqja e pyjeve e Himarës me 7107ha. Është e domosdoshme nevoja e një monitorimi të rreptë dhe aplikimit të plotë të ligjit për Pyjet Nr 9385/2005 ndryshuar me Nr. 48/2016. Monitorimi i pyjeve është i domosdoshme për t'i mbrojtur ato nga djegiet aksidentale si pasojë e praktikave të gabuara në zonë për djegien e kullotave apo për shkak të prerjes së drurëve për qëllim ngrohjeje. Zonat e mbrojtura janë të rrezikuara si pasojë e presioneve të zhvillimit në zonë. Dëmi që vjen nga djegiet dhe prerjet e druve nuk lidhet vetëm me pyjet por edhe me llojet e rralla dhe endemike që i përdorin ato si habitate.

Tabela 55: M.8: Monitorimi i pyjeve dhe zonave të mbrojtura dhe të gjelbra		
Parime	Objektiva	Nga viti
Parandalimi i dëmtimit të kullotave dhe pyjeve	Reduktimi i dëmtimit 100%	2018
Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura	Për zonat e reja të shpallura dhe përditesimi/rishikimi i planeve ekzistuese në masën 100%	2019
Shtimi i sipërfaqes së pyllëzuar	Rritje me 10%	2020

6.2.8 Guroret dhe industria e vajit

Në territorin e bashkisë Himarë gjenden disa punishte vaji. Monitorimi i tyre duhet të bëhet në mënyrë të rregullt nga ana e institucioneve përkatëse pasi shpeshherë nuk respektojnë mjedisin përreth punishteve të tyre.

Gurore përpbëjnë një tjetër aktivitet, monitorimi i të cilave është e një rëndësie të veçantë, megjse aktualisht ato nuk përpbëjnë një shqetësim. Riliçensimi dhe rinovimi i lejeve për këto industri është një proces i një rëndësie të veçantë dhe duhet të bëhet në respekt të ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse (udhëzim 3, Maj 2006 Ministria e Mjedisit, ligj për Vlerësim e Thelluar Mjedisor. Në mënyrë të veçantë për guroret është e rëndësishme aplikimi i udhëzimit në pikat e nenit 14 (a, b, c, d). Hapja e guroveve të reja duhet të bëhet në zonat e sugjeruara nga Plani ose duke u bazuar në sugjerimet e specialistëve dhe të Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

Tabela 56: M.9: Monitorimi i guroveve dhe rehabilitimi		
Parime	Objektiva	Nga viti
Parandalimi i rinovimit te licencës për guroret pa vlerësimin paraprak mjedisor nga Agjencia e Vlerësimit Rajonale të Mjedisit	100%	2017
Rehabilitimi i guroveve ekzistuese sipas Direktives 3, Maj 2006 MoEFËA	100%	2018

6.2.9 Monitorimi i tokës bujqësore

Toka bujqësore zë rreth 21,4% të totalit të sipërfaqes së tokës dhe më shumë është e përbërë me plantacione ullinjsh dhe disa pentari. Vihet re se toka bujqësore është e mirë organizuar nga koha e socializmit. Tarracat e pjerrta janë gjëresisht të përhapura dhe të mbjella me ullinj, dhe vihet re edhe sot prezenca e sistemit të kullimit përgjatë tokës bujqësore (me kanale, rezervuare etj). Tokat bujqësore në fshatrat e luginës së Drinos në jug (Vranisht, Kallarar) janë kryesisht në formën e kultivimit të organizuar. Në pjesën bregdetare të bashkise këto zona janë më të pakta dhe në afërsi me vendbanimet, kryesisht përreth Palasë-Dhërmi dhe Himarë-Pilur.

Zona paraqitet si një sistem tarracash me pemishte, një teknikë tradicionale që është përdorur gjëresisht nga regjimi i peridhës komuniste. Këto tarraca shtrihen përgjatë zonave bregdetare përreth Himarës së vjetër dhe veçanërisht në kodrat e Piqeresit, nga Borshi në Lukovë dhe janë të pasura me ullinj dhe agrume. Monitorimi i saj është mjaft i rëndësishëm sidomos në kushtet kur presioni i zhvillimit po e redukton atë në mënyrë konstante. Grupi i ekspertëve ka vendosur dy objektiva lidhur me gjendjen aktuale të tokës bujqësore me qëllim përmirësimin e gjendjes së saj pas aprovimit të Planit.

Tabela 57: M10: Monitorimi i tokës bujqësore		
Parime	Objektiva	Viti
Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore nën ujë	Me 10%	2019
Rritja e sipërfaqes së tokës me bonitetit të lartë	Me 10%	2020

6.3 Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Himarës

Në tabelat e mësipërme shpjegohet se si një numër monitorimesh dhe vlerësimesh është i nevojshëm gjë e cila kërkon dhe një seri sistemesh dhe metodash matjeje që duhen të implementohen në zonë. Ndër më kryesoret mund të përmendim:

1. Sistemi i monitorimit GIS i PPV. Kjo do të monitorojë të dhënat hapësinore, parametrat peizazhit, pyjet, kullotat bregdetin, zhvillimi dhe pasqyrimi, hapësira të gjelbëria, zonën industriale.
2. Matjet e specializuara teknike përcaktohen nga bashkia për tu realizuar nga palët e treta të specializuara, të tilla si cilësia e ujit të pijshëm, cilësia e ujit të detit, cilësia e ajrit, matje të cilësisë tokës.
3. Metoda e gjetjes së të dhënave nga burimet ekzistuese brenda Bashkisë Himarë, ose regjistrat kombëtare, siç janë licencat e strehimit, të dhënat e popullsisë, urbanistikes, të dhënat studentëve dhe kompanive, të dhëna mbi pronësinë.
4. Hartimi i rregulloreve në përputhje me ligjin nga ana e bashkim për përdorimin e pesticideve, plehrave kimike etj.
5. Sondazhet bashkiake dhe statistikat mbi çështje që lidhen me kushtet e strehimit, kontrollet ndaj ndërmarrjeve për normat mjedisore që duhen respektuar, sondazhe të pasurive natyrore të tilla si përrenj, lumenj etj.
6. Këshilli bashkiak dhe veprimet, investimet e vendimet administrative që zgjidhin në mënyrë përfundimtare, problemet kryesore, apo zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuere, projekteve pilot mbi “energjinë e gjelbër”, për riciklimin, etj.
7. Kontrolli mbi numrin e guroreve në hapësirën e bashkisë por pa e kaluar këtë numër përtej nevojës që ka bashkia, duke llogaritur nevojat për ndërtimet në zonë.

Grupimi i detajuar i objektivave dhe treguesve, së bashku me metodat e nevojshme të matjes për secilën nga objektivat e VSM-se është paraqitur më poshtë.

OBJEKTIVAT, INDIKATORËT & SYNIMET për VSM-në e Himarë

Tabela 58: M.10: Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Himarë

Nr.	OBJEKTIVAT e VSM-se	ZONAT KRYESORE & PARAMETRAT	QËLLIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJEVE
1	Mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit, zonat e mbrojtura dhe zonat e gjelbra, speciet dhe habitatet	Biodiversiteti, Fauna & Flora, zonat e mbrojtura <ul style="list-style-type: none"> • Kushtet e jetesës se popullatës, • Standardet e ajrit & mjedisit • Kushtet shëndetësore • Tërheqja turistike 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbjajta nën kontroll e biodiversitetit ekzistues dhe hapësirat e gjelbra • Rritja me 25% të të gjithë sipërfaqes së mbrojtur 	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i specieve endemike dhe atyre të rrezikuara • Madhësia e sipërfaqeve te gjelbra dhe te mbrojtura 	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i PPV Sistemi GIS • Regjistrimi i të dhënave • Përditësimi i biodiversitetit (sidomos për specie endemike dhe ato të rrezikuara) dhe zonat e mbrojtura
2	Menaxhimi i tokave në një mënyrë të qëndrueshme dhe parandalimi i ndotjes së tokës dhe erozioni	Toka <ul style="list-style-type: none"> • Produktet bujqësore -Bio • Cilësia e ujerave nëntokësore • Kushtet e jetesës së popullatës dhe ato shëndetësore 	<ul style="list-style-type: none"> • Zonat e rrezikut (rrëshqitjet, erozionin) nën kontrollin e planifikuar • Gjelbërim 100% te karierave dhe ripyllëzimin e tyre • Masa administrative qe ndihmon rehabilitimin dhe mbrojtjen e dherave • Rehabilitimin e ish tokave bujqësore 	<ul style="list-style-type: none"> • Zonat e Sipërfaqeve te Ripyllëzuara (Ha) • Numri i guroveve të mbyllura • Rritja në % të ish tokave bujqësore 	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimi bashkiak • Përditësimi dhe Monitorimi GIS sipas PPV

Tabela 58: M.10: Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Himarë

Nr.	OBJEKTIVAT e VSM-se	ZONAT KRYESORE & PARAMETRAT	QËLLIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJEVE
3	Mbrojtja dhe përmirësimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	<p>Cilësia e jetës & shëndeti publik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli i përdorimit të pesticideve • Prodhimet bujqësore-bio • Menaxhimi i mbetjeve 	<ul style="list-style-type: none"> • Rritjen me 20% të sipërfaqes së kultivuar me produkte -bio • Kontrolli 100% të hedhjes së mbeturinave • Trajtimi 100% të mbetjeve industriale • Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve dhe gropave septike sipas rregulloreve kombëtare dhe standardeve të BE 	<ul style="list-style-type: none"> • Treguesit e cilësisë së ujërave të përrrenjve dhe lumenjve • Puse me ujë cilësor • Zgjatja e rrjetit të kanalizimeve 	<ul style="list-style-type: none"> • Metodat laboratorike të analizave të Ujit • Përditësimi • Investimet bashkiake në rrjetin e kanalizimeve dhe gropat septike
4	Mbrojtja, përmirësimi dhe zhvillimi i mjedisit te marinës dhe zonave bregdetare	<p>Shëndeti publik & turizmi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Biodiversiteti • Erozioni • Menaxhimi i mbetjeve • Tragete dhe mjete detare 	<ul style="list-style-type: none"> • Konservim 100 % të biodiversitetit • grumbullim 100% te mbetjeve • mbrojtjen e plazheve • Zbatimi i plote i rregullores Shqiptare për mbrojtjen e mjedisit detar dhe 11 përshkrimeve (Direktiva BE) 	<ul style="list-style-type: none"> • % e Poseidonia oceanica, leshterikëve detar • Formën e bregut • Grumbullimin e mbetjeve 	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi GIS te PPV • Monitorimi i ujërave nën tokësor • Analizat e ujërave detare • Analizat e sedimenteve detare • Fushata ndërgjegjësimi publik

Tabela 58: M.10: Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Himarë

Nr.	OBJEKTIVAT e VSM-se	ZONAT KRYESORE & PARAMETRAT	QËLLIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJEVE
5	<p>Reduktimi i ndotjes së ajrit dhe emetimeve të gazeve serre, nxitja e një lëvizshmërie të qëndrueshme urbane dhe përmirësimi i efikasitetit të energjisë</p>	<p>Cilësia e jetës & shëndeti publik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cilësinë e klimës & Ajrit (energjinë e rinovueshme, shkarkimin e gazrave sere) • Kohezionin social • Transporti 	<ul style="list-style-type: none"> • automjete të reja për transportin publik për të mbuluar territorin bashkiak • Respektimin e standardeve të cilësisë se ajrit standardet (kombëtare, BE) • Shmangen e trafikut ne zonat rezidenciale • Përdorimin e pajisjeve pozitive për energjinë • Përdorimin e energjisë diellore • Eliminimin 100% te djegies se mbetjeve 	<ul style="list-style-type: none"> • Matjet e standardeve te cilësisë se Ajrit • Numrin e mjeteve te transportit publik • Numrin e pajisjeve kursyese të energjisë, instalimin e paneleve diellor dhe voltaik 	<ul style="list-style-type: none"> • Matjen e cilësisë se ajrit ne zona te përcaktuara • Fushata ndërgjegjësimit publik • Vlerësimin e faturimit te energjisë • Sasinë e energjisë nga burime te tjera
6	<p>Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta</p>	<p>Cilësia e jetës & Shëndetit Publik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Evidentimin e mbetjeve industriale • Cilësinë e trupave ujore • Peizazhin • Imazhin turistik 	<ul style="list-style-type: none"> • Eliminimi 100% të depozitimeve ilegale të mbetjeve ne territorin e bashkise • Mbledhjen e diferencuar te mbetjeve 	<ul style="list-style-type: none"> • Reduktimin e numrit te vend grumbullimeve • Shtimin e numrit te koshave ne territorin e bashkise • Cilësinë e peizazhit • Cilësinë e trupave ujqor 	<ul style="list-style-type: none"> • Analizat e trupave ujqor • Përditsimi • Volumi i vend grumbullimit

Tabela 58: M.10: Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Himarë

Nr.	OBJEKTIVAT e VSM-se	ZONAT KRYESORE & PARAMETRAT	QËLLIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJEVE
7	Përmirësimi i trajtimit të ujrave të zeza	Cilësia e Jetës & Shëndetit Publik <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimin e mbetjeve industriale • Cilësinë e trupave ujore • Peizazhin • Imazhin turistik 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimin e Infrastrukturu rës sipas standardeve te BE • Reduktimin me 100% për shkarkimet pa trajtim paraprak • Deri në vitin 2020, të grumbullohen 100% shkarkimet me metoda mjedisore të përshtatshme 	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i pajisjeve të trajtimit paraprak (aktivitetit industrial, Aktivitetit tregtar etj) • Cilësinë e trupave ujor • Gjatesia e rrjetit të grumbullimit të ujerve te ndotura • % e trajtimit të ujerve te ndotur • % e shtëpive me gropa te rregullta septike • % e aktiviteteve industrial qe kane sistemin e tyre te përpunimit 	<ul style="list-style-type: none"> • Projektet Bashkiake ne rrjetin e ujerave te ndotur • Matja e cilësisë se ujerve e vende te caktuara • Vëzhgimet
8	Kontrollimi i niveleve te zhurmës, ne kuadër te rritjes se nivelit shëndetësor te popullatës	Cilësinë e Jetës & Shëndetin Publik <ul style="list-style-type: none"> • Baret dhe restorantet • Transportin • Industrinë e ndërtimit 	<ul style="list-style-type: none"> • Reduktimin e nivelit te zhurmave min 45 dB (natën) max ne 56 dB(ditën) • Reduktimin e numrit te vend parkimeve pran plazheve dhe trafikun. • Kufizim i orëve të punës pranë zonave rezidenciale 	<ul style="list-style-type: none"> • Mjediset e parkimit • Masat e marra nga bashkia • Opinioni i turistëve dhe i banorëve 	<ul style="list-style-type: none"> • Matjen e nivelit të zhurmave • Vëzhgimet • Vendimet e Këshillit Bashkiak

Tabela 58: M.10: Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Himarë

Nr.	OBJEKTIVAT e VSM-se	ZONAT KRYESORE & PARAMETRAT	QËLLIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJEVE
9	Mbrojtja, përmirësimi dhe rivendosja e cilësisë dhe karakterit të peizazhit, promovimi i dallueshmërisë lokale dhe vlerës piktoreske	Cilësia turistike dhe peizazhit <ul style="list-style-type: none"> • Vendet e mbrojtura dhe natyra • Peizazhi (restaurimin e peizazhit të degraduar) 	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e zonave të mbrojtura me 30 % • Nuk jep leje ndërtimi në zonat e mbrojtura dhe zonat me vlera pamore • Krijimi i infrastrukturës për turistët 	<ul style="list-style-type: none"> • Madhësia e sipërfaqes së mbrojtur • Numri i lejeve të ndërtimit • Numri i turistëve në vend • Ripyllëzimi 	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi GIS të PPV • Sasia e biletave për vizitoret • Vendimet e Këshillit Bashkiak
10	Mbrojtja, përmirësimi dhe restaurimi i monumenteve kulturore dhe trashëgimisë arkitekturore; Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së formës urbane, modelit të vendbanimeve, identitetit pamor të qytetit	Trashëgiminë kulturore (mbrojtjen & restaurimin e ansambleve arkitekturale) <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimin e shtëpive të reja • Restaurimin e shtëpive të vjetra • Nxiti investimet e emigrantëve në zonë 	<ul style="list-style-type: none"> • Shton restaurimin e shtëpive me 10% çdo vite • 100% e ndërtimeve të reja Brenda fshatrave të vjetër të ndjekin të njëjtën formë dhe identitet • Shtone lehtësirat e shërbimit (respekton traditën) brenda fshatit • Kontroll të plote bashkiak për ndërtimet pa leje 	<ul style="list-style-type: none"> • Numrin e shtëpive të restauruara • Numrin e shërbimeve baret (tradicionale, restorantet, dyqanet) brenda fshatit • Numrin e ndërtimeve ilegale dhe të restauruara 	<ul style="list-style-type: none"> • Shërbimi Bashkiak • Vëzhgim monitorim nga Ministria e Kulturës dhe Sporteve • Fotografi

Tabela 58: M.10: Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Himarë

Nr.	OBJEKTIVAT e VSM-se	ZONAT KRYESORE & PARAMETRAT	QËLLIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJEVE
11	Përmirësimi i cilësisë së projektimit dhe mbështetja ekologjike dhe favorshme me metodat e ndërtimit në zhvillimin e ri	Mbrojtja mjedisore & Shëndeti <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimet e shtëpive • Mbrojtje mjedisore 	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i materialeve ndërtimore mjedisore (dru, suvatim/lyerje me VOC te ulet, etj) • Restaurimin dhe krijimi i korridoreve të rinj mjedisore në zonat e reja në zhvillim • Përdorimin e burimeve të pastra të energjisë • Depozitim dhe trajtim të plote të mbetjeve • Përdorimin e pajisjeve mjedisore 	<ul style="list-style-type: none"> • Sasinë e kësë të energjisë së instaluar • Sipërfaqen e zonave të gjelbra dhe numrin e pemëve për frymë • Standardet vendosur si kusht për materialet që përdoren në ndërtim nga bashkia • Zbatimin e rregulloreve 	<ul style="list-style-type: none"> • Numrin paneleve diellor dhe fotovoltaike • Monitorimi GIS i PPV • Numri i gropave septike apo gjatësia e rrjetit të përdorur të kanalizimeve • Kontroll të vazhdueshëm nga Bashkia në materialet e përdorura

Tabela 58: M.10: Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Himarë

Nr.	OBJEKTIVAT e VSM-se	ZONAT KRYESORE & PARAMETRAT	QËLLIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJEVE
12	Reduktimi dhe parandalimi i zhvillimit të shpërndare dhe përmirësimi i strukturës së vendbanimit	Infrastruktura e shëndetit publik / Mjedisin <ul style="list-style-type: none"> • Riciklimin e mbetjeve te ngurta, reduktimin e mbetjeve, mbetjeve te rrezikshme, trajtimin e mbetjeve • Peizazhi 	<ul style="list-style-type: none"> • Rehabilitimi i zhvillimeve te shpërndara ekzistuese • Riciklimin e sasisë se mbetjeve (2%-5% rritje p.sh. letra) • Shtimin e koshave ne vendbanime ne 30% ne 2017 • Reduktimin e ndërtimeve ilegale me 95% brenda vitit 2017 • Ndërtimin e gropave te reja septike sipas standardeve ose lidhjen me rrjetin e kanalizimeve deri ne vitin 20120 (100%) 	<ul style="list-style-type: none"> • Programe investimesh nga bashkia • Numri i gropave septike ose gjatësia e rrjeti i kanalizimeve (synimi 100% i grumbulluar) • Programe riciklimi ne zbatim 	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi GIS i PPV • Vëzhgim bashkiak • Matje te cilësisë se Ujerave
13	Reduktimi dhe parandalimi i zhvillimit te papajtueshëm te përdorimit te tokës ne zonën bregdetare, te sistemit bujqësor dhe natyror	Peizazhet, Biodiversitetin, Vendet natyrale <ul style="list-style-type: none"> • Zonat bregdetare • Token bujqësore • Vendet natyrale 	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrollin 100% te territorit deri ne vitin 2019 • Zbatimin e zonimit te tokës sipas PPV • Nuk lejon ndërtime te reja 100m nga bregu 	<ul style="list-style-type: none"> • % e sipërfaqes totale bujqësore • Numrin e ndërtimeve te reja ilegale • % e tokës te restauruar 	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimin GIS i PPV • Te dhënat Bashkiake • Vëzhgimin

Tabela 58: M.10: Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Himarë

Nr.	OBJEKTIVAT e VSM-se	ZONAT KRYESORE & PARAMETRAT	QËLLIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJEVE
14	<p>Përmirësimi i kushteve dhe sigurimi i aksesit te barabarte ne rrjetet e shërbimeve dhe infrastrukturës sociale, përmirësimi i aksesueshmerise</p>	<p>Cilësia e jetës & kohezioni social</p> <ul style="list-style-type: none"> • Uji i pijshëm • Rrjeti i kanalizimeve • Energjia • Infrastruktura sociale • Menaxhimi i mbetjeve 	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimin e furnizimit me ujë për ndërtesat private dhe publike • Ndërtimin e rrjetit te kanalizimeve ose gropave septike • Adaptimin e teknikave për kursimin e energjisë • Krijimin e vendeve te reja për turistet dhe banoret 	<ul style="list-style-type: none"> • Sasia e ujit për person/dite • Matja e numrit te orëve te përdorimit / adaptimit te energjisë se pastër • Numri i qendrave argëtuese 	<ul style="list-style-type: none"> • Vendimet bashkiake • Sondazhet bashkiake • Konsumin e ujit
15	<p>Mbështetja e rritjes demografike nëpërmjet zhvillimit te sektorit te turizmit ne një mënyre qe te gjeneroje punësim te qëndrueshëm dhe mundësi biznesi për komunitetin lokal</p>	<p>Turizëm dhe industri te tjera te lidhura me te.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cilësinë e jetës • Infrastruktura 	<ul style="list-style-type: none"> • 24 ore furnizim me ujë • 24 ore furnizim me energji • Rrjet kanalizimesh • Rritjen e ndërgjegjes publike për mjedisin • Shërbime te reja te transportit publik • Lehtësi shërbimesh te reja • Biznes i ri agro-bujqësor 	<ul style="list-style-type: none"> • Investime ne infrastrukture • Fushata ndërgjegjësimit • Numër restorantesh, baresh dhe hoteleve qe shërbejnë gjate gjithë vitit • Sasinë e produkteve bio ne vit 	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimet bashkiake • Vëzhgimi / sondazhi bashkiak • Sipërfaqja e tokës se kultivuar

Tabela 58: M.10: Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Himarë

Nr.	OBJEKTIVAT e VSM-se	ZONAT KRYESORE & PARAMETRAT	QËLLIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJEVE
16	<p>Promovimi i zhvillimit te qëndrueshëm te turizmit, i cili do te veproje si një katalizator i një ekonomie te larmishme lokale te qëndrueshme gjate te gjithë vitit</p>	<p>Cilësinë e jetës & Kohezionin social</p> <ul style="list-style-type: none"> • Problemet mjedisore • Tërheqjen turistike 	<ul style="list-style-type: none"> • Rritjen e ndërgjegjes publike për mjedisin • Shërbime te reja te transportit publik • Shërbime te reja ambiente për fëmije • Biznes te ri agro-bujqësor për produktet bio • Përmirësim infrastrukture • Kontroll i Peshkimit, Gjuetisë • Pishina te mbyllura dhe terrene sportive 	<ul style="list-style-type: none"> • Infrastruktura • Fushat ndërgjegjësimit • Numër restorantesh, baresh dhe hoteleve qe shërbejnë gjate gjithë vitit • Sasinë e produkteve bio për vit • Numri vizitoreve jashtë sezonit veror 	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimet bashkiake • Vëzhgimi/sondazhi bashkiak • Sipërfaqja e tokës se kultivuar • Prenotimi i hoteleve
17	<p>Zyrtarizimi i sektorit te turizmit, zhvillimi i infrastrukturës se turizmit me mjete publike dhe private, financimi i strukturës lokale dhe gjenerimi i asetëve si pjese e procesit te zhvillimit te pasurisë se paluajtshme</p>	<p>Turizmin dhe industri te tjera bashkëvepruese</p> <ul style="list-style-type: none"> • Infrastruktura • Qasje mjedisore 	<ul style="list-style-type: none"> • Energji dhe furnizim me ujë 24 ore ne ndërtimet e paligjshme • Ndërtim te rrjetit te kanalizimeve dhe gropave septike • Rritjen e ndërgjegjes publike për mjedisin 	<ul style="list-style-type: none"> • Investime ne infrastrukture • Rritje te ndërgjegjësimit 	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i pasurive te legalizuara • Vëzhgime bashkiake

Tabela 58: M.10: Objektivat, indikatorët & synimet për VSM-në e Himarë

Nr.	OBJEKTIVAT e VSM-se	ZONAT KRYESORE & PARAMETRAT	QËLLIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJEVE
18	Rritja e ndërgjegjësimit mjedisor dhe nxitja e veprimeve pilote dhe iniciativave	Cilësia e parametrave mjedisor <ul style="list-style-type: none"> • Problemet mjedisore • Tërheqja turistike 	<ul style="list-style-type: none"> • Rritjen e ndërgjegjes publike për mjedisin • Biznes i ri bujqësor bio • Përmirësim infrastrukture • Menaxhim i mbetjeve dhe veprime pilot ne një fshat 	<ul style="list-style-type: none"> • Infrastrukture • Rritje te ndërgjegjësimit • Grumbullim i mbetjeve ne një zone pilot 	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrime bashkiake • Vëzhgime bashkiake

7. STUDIMET REFERUESE KRYESORE

- **PLANI I INTEGRUAR NDE RSEKTORIAL I BREGDETIT 2030 (Qershor 2016);** zonimi i territorit; integrimi dhe ndërlidhja e zonimit territorial; struktura e planit të bregdetit; përkufizimi i zonës bregdetare; organizimi hapësinor)
- **PLANI I PËRGJITHSHËM K OMBËTAR S HQIPËRIA 2030 (Qershor 2016) ;** zhvillim i qëndrueshëm i territorit për 15 vitet e ardhshme; zhvillim i balancuar ekonomik e social i vendit; menaxhim i përgjegjshëm i burimeve natyrore të tij; mbrojtja e mjedisit; përdorimi racional i tokës.
- **RAPORTET MJEDISORE 2014-2015** (Monitorimi i Cilësisë së Ajrit, biodiversiteti, pyjet, ujrat.monumentet e natyrës)
- **INSTAT – census 2011** (Demografi, Ekonomi) Njësitë ekonomike familjare; Individët; Bashkëjetesat kolektive; Banesat (të banuara ose jo), dhe tipe të tjera banesash;Të huajt (prezentë në momentin e Censurit)
- **STRATEGJIA ND ËRSEKTORIALE E M JEDISIT 2015-2020** (Kushtet aktuale, sfidat për të ardhmen, ndryshimet klimatike, Vizioni Politikat dhe Qellimet e Politikave, Objektivat e politikës dhe produktet madhore, Burimet finaciare).
- **STRATEGJIA K OMBËTARE S EKTORIALE E S HËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJ Ë DHE K ANALIZIMEVE 2011 -2017** (Gjendja Aktuale e Sektorit, Vizioni, misioni dhe objektivat prioritarë, Politikat dhe Planet e Veprimit, Përgjegjshmëria, Monitorimi dhe Vlerësimi)
- **2011-2017 PLANI KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE 2010-2025** (marrëveshjet aktuale per mbetjet bashkiake, Kuadri Aktual Ligjor, Prioritetet në Programin e Qeverisë, Prioritet strategjike dhe politikat)
- **METABOLIZMI I SHQIPERISE. AKTIVIZIMI I P OTENCIALIT TË TERRITORIT SHQIPTAR (2016)**

Libri "Metabolizmi i Shqipërisë" parashtron tërësine e sfidave me te cilat perballet Shqipëria duke u përpjekur te realizoj kalimin drejt ekonomisë se te ardhmes si një ekonomi e gjelbër dhe me nivel të ulët të karbonit.

8. VËSHTRËSITË E HASURA

Vështirësitë e hasura gjatë hartimit të VSM-së së Bashkisë Himarë janë të lidhura me një sërë problematikash që i referohen kryesisht: mungesës në disponueshmërinë e të dhënave dhe matjeve shkencore, komunikimit të dobët ndër institucional dhe dobësive administrative, mungesës së teknologjisë së duhur dhe sistemit të monitorimit. Më konkretisht, në lidhje me disponueshmërinë e të dhënave mund të përmendim:

- Të dhëna jo të plota të marra nga database i AKPT-së, të cilat, edhe pse ishin të organizuara për çdo Bashki, mbeten jo të plota, me mangësi të pa identifikuar si dhe me cilësi jo të mirë, mbi 50% e datave ishin në PDF.
- Në shumë sektorë/fusha mungojnë të dhënat nga Ministrinë e linjës, ka mos përputhje të informacionit ekzistues me azhurnimet e fundit të kërkuara nga legjislacioni si edhe mungesë masive të database GIS për çdo Ministri apo Institucion Qëndror.
- Mungojnë masivisht planet sektoriale nga të cilat duhej të përfitohej informacion i detajuar nga GIS përkatës.

Përsa i përket Institucioneve Lokale, përfshirë këtu Agjencitë Rajonale, Qarkun dhe Bashkitë, përmbajnë informacion i cili nuk mund të referohet sipas natyrës së të dhënave të INSTAT dhe ky përbën një problem të vçantë. Në shumë raste, edhe pse informacioni është referuar si i përftuar nga Bashkia, në fakt të dhënat janë gjetur jashtë kontributit të tyre.

Ne çdo rast ne kemi arritur të krijojmë një sistem GIS duke u përparuar të mbledhim të dhëna të ndryshme për një kohë shumë të shkurtër në dispozicion.

Gjatë realizimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Himarë, pavarësisht kohës së kufizuar për realizimin e çdo etape (4+2 javë) është dashur t'i rikthehem vazhdimisht produkteve përkatëse me kërkesën e AKPT që është institucioni përgjegjës. I tillë është rasti i përgatitjes së raportit të Vizionit dhe Strategjisë Territoriale si dhe i Planit dhe Rregullores përkatëse, për të cilat grupi i punës, përtej vështirësive specifike, i është rikthehej disa herë kërkesave për plotësime që vinin nga vlerësimi i raportit të Analizës. E gjithë kjo ka kërkuar kohë dhe energji shtesë.

Fusha e monitorimit dhe mbrojtjes së mjedisit është ende mjaft e pazhvilluar në Shqipëri, me gjithë hapat pozitive të ndërmarra në vitet e fundit drejt përmbushjes së standardeve të BE -se, siç është miratimi i Strategjisë Kombëtare të Mjedisit. Matjet shkencore të aspekteve bazë janë ende të pakta dhe jo të rregullta në kohë. Monitorimi kërkon një përpjekje të koordinuar dhe angazhim të dy palëve, në nivel kombëtar e lokal, në mënyrë që të prodhohë të dhëna të besueshme. Konsulenti ka hasur vështirësi si në marrjen e të dhënave të përditësuara nga institucionet si dhe ndërlidhjen midis institucioneve, në mënyrë që të arrihte konkluzione të vlefshme. Dokumentet e përdorura për draftimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Himarë, pavarësisht spektrit të gjerë të referencave bazuar në intervistat dhe institucionet e kontaktuar, reflektojnë dobësi në të dhënat dhe mungesën e informacionit në disa aspekte, veçanërisht në

rrjetin e ujësjellës kanalizimeve, mungojnë indikatorë që matin cilësinë e mjedisit dhe ka të dhëna të pakta për turizmin.

Procesi i zbatimit të VSM-se është një përpjekje kolektive që duhet të zhvillohet me kalimin e kohës, në etapa të rëndësishme, por edhe si pjesë e veprimeve rutinë të autoriteteve bashkiake. Ndërtimi i kapaciteteve lokale është një faktor shumë i rëndësishëm, i cili është evidentuar qartë në objektivat e Planit. Kjo përpjekje ka filluar, por mbetet akoma për t'u bërë. Trajnimi i administratës bashkiake në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, duhet të shoqërohet me angazhimin dhe investimet në pozicionet e tyre të punës. Ndryshimet e shpeshta në postet administrative janë një pengesë e madhe në këtë përpjekje për të krijuar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri.

Teknologjia është gjithashtu një faktor shumë i rëndësishëm për monitorimin e VSM-se. Zbatimi i Planit në vetvete përmban një mjet shumë të vlefshëm, që është përditësimi i bazës së të dhënave të GIS, i cili mundëson përditësimin e vazhdueshëm të ndryshimit të përdorimit të tokës dhe të procesit të zhvillimit. Gjithashtu, leja e zhvillimit të procesit, sipas Ligjit me Nr. 107/2014 Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, e cila kërkon transferimin e vendimeve të zhvillimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, përbëjnë mjetet, që sipas përkufizimit, lejojnë monitorimin e vazhdueshëm të procesit të zbatimit të planit.

Ende të dyja këto mjete teknologjike nuk mund të zbatohen para se bashkitë të marrin softëare-in e duhur GIS. Sistemi mbështetës aplikohet në nivel kombëtar për të mbuluar të gjithë territorin e vendit.

Deri sa këta faktorë të maturohen, procesi VSM do të vazhdojë të zbatohet me vështirësi në hapat e tij të para dhe është i bazuar në angazhimin dhe përkushtimin e stafit bashkiak.

9. PERMBLEDHJA JOTEKNIKE

9.1 Hyrje

Qëllimi i këtij Raporti Mjedisor është:

- Të sigurojë informacion mbi procesin e Vlerësimit Strategjik të Mjedisit (VSM) në lidhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Himarës
- Të identifikojë, të përshkruajë dhe të vlerësojë efektet e mundshme të rëndësishme të Planit
- Të sigurojë mundësi për Këshillin Bashkiak, autoritetet në nivel kombëtar (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit) dhe publikut në përgjithësi, për të ofruar pikëpamje mbi Raportin Mjedisor.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor kërkohet nën Ligjin Nr.107/2014 për “Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, dhe Ligjit Nr. 91/2013 për "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor". Ai synon të integrojë vendimet mjedisore në përgatitjen e planit dhe vendimmarrjes me qëllim që:

- Të përmirësojë planet dhe të përmirësojë mbrojtjen e mjedisit
- Të rrisë pjesëmarrjen publike në vendim-marrjen mjedisore

9.2 Konteksti i Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit

Studimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Territorin e Bashkisë Himarë u përgatit në periudhën Prill -Nëntor 2016, si pjesë e realizimit të objektivave të programit të qeverisë dhe në një moment të rëndësishëm të riorganizimit territorial për Shqipërinë. Ky plan u mbështet në Planin e Përgjithshëm Kombëtar që mundëson zbatimin cilësor të reformës administrative territoriale në vend. Plani i Përgjithshëm Vendor u realizua nga Bashkia Himarë në bashkëpunim me studiot Dea dhe Thymio Ppayoanis- Athine. Ky Plan u realizua sipas përcaktimeve të kuadrit të ri ligjor Nr.107/2014 për “Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe në përshtatje me Planin e Integruar Ndërsektorial për Bregdetin (PINS bregdeti). Për realizimin e tij Plani ndjek rekomadimet e drejtëpërdrejta të Agjencisë Kombëtare të turizmit, në përshtatje të Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin brenda kontekstit të Planifikimit dhe zhvillimit të Territorit si dhe të Planit të Përgjithshëm Kombëtar duke u organizuar sipas një ndarje në pesë sistemet kryesore të zhvillimit të territorit. Përkatësisht këto janë: sistemi urban, sistemi natyror, sistemi ujqor, sistemi bujqësor, sistemi infrastrukturor.

Plani i Përgjithshëm Vendor, i cili parashikon një vizion afatgjatë për zhvillimin e ardhshëm dhe rregulloret e detyrueshme për 15 vitet e ardhshme, është dorëzuar për konsultim publik në faza të ndryshme duke ndjekur udhëzimet e ligjit. Plani është ndjekur nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit AKPT në tre faza specifike të zhvillimit të tij. Duke filluar me Vlerësimin dhe Raportin e Analizës, janë lënë në dispozicion 6+2 javë përgatitje të materialit për të katërta Bashkitë e LOT-it 6. Me pas, realizimit të Vizionit dhe Strategjisë Territoriale, si dhe projekteve strategjike të investimeve infrastrukturore dhe turistike të lidhura me strukturën

hapësinore për zhvillimin e zonës, i janë lënë në dispozicion 4+2 jave gjatë të cilave ka vijuar gjithashtu edhe korrigjimi mbi bazën e vlerësimit dhe komenteve të Agjencisë. Pas dorëzimit të Vizionit dhe Strategjisë Territoriale është vijuar me përgatitjen e fazave përfundimtare të Planit, Rregullores dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Për të treja këto faza është lënë në dispozicion një kohë e përbashkët, 4+2 javë, me një shtesë prej 6 javësh të lejuar nga Ministria e Zhvillimit Urban. Duhet theksuar se AKPT ka qënë një Agjenci me një rol kyç për drejtimin e punës në funksionin e Institucionit përgjegjës për vlerësimin e produkteve.

9.3 Sfidat kryesore mjedisore te zonës se studimit

Analiza e gjendjes ekzistuese së situatës gjatë Studimit ka trajtuar këto çështje kyçe mjedisore dhe problematika qe duhet të adresohen nga Plani:

1. Problemet socio-ekonomike si rezultat lëvizjeve demografike.
2. Mungesa e investimeve dhe infrastrukturës.
3. Aktivitetet e paqëndrueshme ekonomike dhe cilësia e ulët e produktit turistik.
4. Ndërtime informale dhe zhvillim informal.
5. Zhvillimi sporadik dhe i shpërndarë që çon në përdorim të paqëndrueshëm të tokës dhe urbanizimit.
6. Cilësia e dobët e ndërtimeve ekzistuese dhe të objekteve të turizmit.
7. Dëmtimi i trashëgimisë kulturore e cila mbetet e pambrojtur.
8. Mangësi në shërbimet publike dhe infrastrukturë.
9. Degradimi i peizazhit.
10. Keqpërdorimi i resurseve natyrore dhe tokës.
11. Cilësia e detit dhe burimeve ujore.
12. Sistem i papërshtatshëm i vendgroposjeve dhe largimit të mbeturinave të ngurta.
13. Guroret dhe aktivitetet industriale.
14. Ndotja akustike.
15. Përkeqësimi i cilësisë së ajrit.
16. Mungesa e ndërgjegjësimit mjedisor të bizneseve, popullsisë dhe vizitorëve.

9.4 Objektivat e veçanta te VSM-se

VSM-ja duhet të marrë në konsideratë:

- Objektivat e mbrojtjes se mjedisit natyror dhe përmirësimit te shëndetit publik;
- Objektivat e zhvillimit te qëndrueshëm te territorit dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së përditshme te popullsisë;
- Objektivat e zhvillimit te qëndrueshëm social-ekonomik;
- Objektivat e pergjitheshem te rritjes se vetëdijes mjedisore te popullsisë lokale.
- Përmbledhja e objektivave kombëtare te planifikimit te territorit
- Përmbledhja e objektivave rajonal te planifikimit te territorit

Konsulenca e VSM-se ka përpiluar një grup prej 18 Objektivash gjithë përfshirës te VSM-se, te cilat janë përdorur ne vazhdim ne mënyre qe te:

- Vlerësoj efektet e pritshme mjedisore dhe shëndetësore te skenarëve alternative
- Vlerësoj ne detaje efektet e pritshme mjedisore dhe shëndetësore te politikave te Planit Lokal dhe projekteve
- Strukturoje sistemin e propozuar te monitorimit te VSM-se

9.5 Skenarët Alternative

Gjatë kryerjes së VSM-se, ekipi duhet të vlerësojë efektet e mundshme mjedisore, sociale dhe ekonomike të Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe të alternativave të arsyeshme që mund të kishin ndjekur pa ekzistencën e këtij Plani specifik. Kapitulli 4 përshkruan vlerësimin e katër alternativave në lidhje me ndikimin e tyre mbi objektivat e VSM:

- Skenari Zero, shembull për këtë është rasti kur nuk implementohet asnjë Plan ose propozim për zbatim, në të cilën zhvillimi hapësinor për zonën në studim zbaton praktikat ekzistuese.
- Skenari i tërheqjes së investimeve të jashtme nëpërmjet zhvillimit të ndërtimeve rezidenciale, i cili e sheh Bashkinë Himarë të hapur ndaj influencave të jashtme nëpërmjet investimeve në pasuritë e patundshme (kryesisht rezidenciale) dhe shtëpi sekondare nga kompanitë e ndërtimit, etj.
- Skenari i zhvillimit i një forme të zbutur të turizmit masiv, i cili mbështet promovimin e turizmit masiv të organizuar si bazë për zhvillimin ekonomik lokal, duke u përqendruar në zhvillimin bregdetar me hotele me kapacitete të mesme deri te ato më të mëdha si dhe resorte, duke lejuar të behet diferencimi i standardeve të akomodimit.
- Skenari i zhvillimit të turizmit të interesit të veçantë, i cili kapitalizon trashëgiminë natyrore dhe kulturore, si bazë e identitetit të zonës si destinacion turistik, duke përfshirë llojet e ndryshme të turizmit dhe duke tërhequr kryesisht turistët e huaj nga Evropa dhe një përqindje të vogël të shqiptarëve me nivel të lartë jetese.

9.6 Vlerësimi i Planit Vendor

Kapitulli 5 përfshin vlerësimin e ndikimeve të pritshme mjedisore të skenarëve të përzgjedhur dhe masat e parandalimit / zbutjen. Procesi Vlerësimit është bazuar në një korrelacion matricor dhe metodologji vlerësimi, që krahason 18 VSM-të të zhvilluara në kapitullin 3, kundrejt një sërë nen-veprimesh, programesh dhe projektesh për secilin prej 3 komponentëve të Planit të Zhvillimit Urban.

OS1: Përmirësimi i aksesueshmërisë dhe promovimi i turizmit të qëndrueshëm

OS2: Përmirësimi i konkurrueshmërisë dhe cilësia e produktit turistik

OS3: Forcimi i ekonomisë rurale dhe lidhjeve me turizmin

OS4: Reduktimi i periferialitetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së komunitetit

OS5: Rritja e kapaciteteve lokale, promovimi i sipërmarrjes, bashkepunimi ndër rajonal

9.7 Masat zbutëse Mjedisore

Raporti Mjedisor duhet të tregojë masat e parashikuara për të parandaluar, zvogëluar dhe kompensuar çdo efekt negativ në mjedis nëpërmjet zbatimit të Planit. Disa masa zbutëse janë ndërtuar në politikat e planit, deri aty sa i kërkon zhvilluesve të adresojnë çështje të ndryshme mjedisore. Do të jete ne dore te Bashkise për të siguruar, për aq sa është e mundur, se këto kërkesa janë plotësuar, për të minimizuar ndikimet mjedisore që rrjedhin nga zhvillimi. Për më tepër disa nga propozimet e Planit, kryesisht projekte të infrastrukturës, të tilla si rehabilitimi i sistemeve të ujit, përmirësimi i infrastrukturës së transportit, etj përbëjnë masat zbutëse për ndikimin mjedisor e masave të tjera zhvillimore dhe politikat hapësinore të Planit. Vlerësimi i

propozimeve specifike të Planit identifikuan masa lehtësuese të nevojshme për propozimet e zhvillimit individual, të cilat janë të përcaktuara në tabelat e Kapitullit 5.

9.8 Monitorimi

VSM kërkon që Bashkia të monitorojë efekte të rëndësishme mjedisore të zbatimit të çdo Plani ose programi kualifikues, për të cilën ai ka kryer një vlerësim mjedisor dhe të identifikojë efekte të paparashikuara negative në një fazë të hershme, si dhe të ndërmarrë veprime korrigjuese të përshtatshme. Një proces monitorimi dhe rishikimi është projektuar për t'u drejtuar paralelisht me zbatimin e Planit, duke qenë një pjesë integrale e tij. Ky është fokusi i nënkomponentit 3.9 në formën e një Plani të Menaxhimit Mjedisor, i cili është përpunuar në detaje në kapitullin 6. Të gjitha të dhënat, synimet dhe shifrat janë të bazuara në objektivat aktuale të Planit, në kërkesat e standardeve kombëtare dhe pritet të përmirësohen gjatë të njëjtës rrugës që Shqipëria po ndërmerr për të aplikuar standarde që propozohen nga BE apo marrëveshje të tjera ndërkombëtare. Matjet do të bazohen në metoda dhe burimeve të ndryshme, duke përfshirë sistemin e GIS të aplikuar të PPV, të dhënat kombëtare, statistikat lokale, matjet shkencore dhe të këshillit bashkiak, si dhe vendimet administrative (të tilla si lejet e zhvillimit).

9.9 Konkluzioni i Raportit

Procesi VSM është një pjesë integrale e procesit të përgatitjes së planit. Ndërsa elemente të procesit të vlerësimit mjedisor janë miratuar gjatë përgatitjes së Planit, ato nuk janë regjistruar formalisht. Plani i VSM, duke identifikuar disa ndikime negative mjedisore, duhet të ketë efektin e përmirësimit të përgjithshëm të kushteve mjedisore në të gjithë zonën në studim, veçanërisht në ato zona të cilat do të hasin presione të larta nga zhvillimi i turizmit të tilla si në zonat e plazheve Dhërmi-Palasa dhe zona e Himares qytet. Kjo do të adresojë disa nga objektivat mjedisore që mund të monitorohet me kalimin e kohës. Kudo që të jetë e mundur, masat zbutëse duhet të paraqiten në skemat zhvillimore, të cilat kanë potencial për të ndikuar negativisht mbi mjedisin, në mënyrë që të minimizohet ndonjë ndikim i pafavorshëm, duke synuar të reduktoje “gjurmët ekologjike” në Bashki.

10. BIBLIOGRAFIA

- Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. PINS Bregdeti 2015
- Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015
- Banka Botërore (2008), *Plan i Zhvillimit të Bregdetit Jugor*.
- Banka Botërore (2007), *Shqipëri, Rishikimi i Sektorit Urban*, Raport Nr.37277-AL. Departamenti i Zhvillimit të Qëndrueshëm në Rajonet e Evropës dhe Azisë Qendrore, 19 Janar 2007.
- Banka Botërore (2006), *Status i reformës së Tokës dhe tregjet e pasurive të paluajtshme*, Banka Botërore, Zyra, Tirane.
- Banka Botërore (2004), *Shqipëri: Decentralizimi në Tranzicion (Volumi II)* Raport Analitik.
- Bashkimi Evropian i Këshillit të Ministrave (2007), Karta e Leipzig në qyteteve të qëndrueshme evropiane.
- Direktiva 2001/42/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 qershor 2001 mbi vlerësimin e efekteve të planeve të caktuara dhe programeve për mjedisin.
- Këshilli i Ministrave, Vendim 88 i 1993, “Për Miratimin e Zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit”.
- Hamilton, I.F.E., Dimitrovska, A.K. & Pichler-Milanovic N., (eds.) (2005). *Transformimi i qyteteve në Evropën Qendrore dhe Lindore, drejt globalizmit*, Tokio: Kombet e Bashkuara Botime Universitare.
- Këshilli i Ministrave, Vendim 722 i 1998, “Për Miratimin e Rregullores së Urbanistikes”.
- Këshilli i Qytetit i Glasgow (2008), Raporti i VSM e Mjedisit i Glasgow Planit të Qytetit 2.
- King, Russell and Vullnetari, Julie. *Migracioni dhe Zhvillimi në Shqipëri*. Sussex Qendra për Kërkim dhe Migracionin. Dhjetor 2003.
- Kolegjit Imperial të Londrës (2005), Lidhja ndërmjet direktivave të VNM dhe VSM. Raporti përfundimtar për Komisionin Evropian.
- Komisioni Evropian, DG Mjedis (2003), Implementimi i Direktivës 2001/42 mbi vlerësimin e efekteve të planeve të caktuara dhe programeve për mjedisin.
- Komisioni Evropian, DG Regio (2009), Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm urban në Evropë. Arritjet dhe mundësitë.
- Morris, Peter dhe Therivel, Riki (botuar) (2009), “Metodat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Vëllimi III.
- Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit “Draftstrategjia Kombëtare për Turizmin 2014-2020”
- Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) & Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT). *Metabolizmi i Shqipërisë* (2016).

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave. “Programi kombëtar i monitorimit për vitin 2012”

Nientied, Peter. Pyetje *Planifikimi Rajonal i Qytetit në Shqipëri*. Instituti i Studimeve të Zhvillimit Urban dhe Strehimit. Rotterdam 1998

Nurja, Ines and Dhrimaj, Hairije. Treguesit sipas Qarqeve 2005-2006. Instat, Tirane 2007.

Nurja, Ines, Shqipëria në Shifra 2007. Instat, Tirane, 2007.

Organizimi i Planit Rregullues të Athinës (2011), Raporti i VSM e Mjedisit i Planit të Ri Rregullues të Athinës 2021.

Qeveria e Irlandës (2004), Për Zbatimin e VSM Direktiva (2001/42/EC): Vlerësimi i efekteve të planeve të caktuara dhe programeve në mjedis; Udhëzime për Autoriteteve Rajonale dhe Autoriteteve Planifikimit.

Qeveria e Shqipërisë. Ligj Nr.9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqesore”

Qeveria e Shqipërisë. Ligji nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar”

Qeveria e Shqipërisë. Ligji nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

Qeveria e Shqipërisë. Ligj Nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”

Qeveria e Shqipërisë. VKM Nr. 321, datë 28.5.2014, “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”

Qeveria e Shqipërisë. Ligji 8906 i 2002, “Për Zonat e Mbrojtura” ndryshuar me ligjin 9868.

Qeveria e Shqipërisë ligj për “Mbrojtjen e Mjedisit” nr. 10 431, datë 9.6.2011

Qeveria e Shqipërisë. Ligji 9048 i 2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” ndryshuar Nr. 9882, datë 28.02.2008 .

Qeveria e Shqipërisë. Ligji 9424 i 2005 “Për Ratifikimin e Protokollit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor”.

Qeveria e Shqipërisë. Ligj nr. 68/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar

Qeveria e Shqipërisë. Ligji nr.107/2014 për “Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”

Qeveria e Shqipërisë. Ministria e Mjedisit, Draft-Strategjia Kombëtare Mjedisore (2015-2020).

Qeveria e Shqipërisë. Ligj nr. 92/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar”

Qeveria e Shqipërisë. Udhëzim 3 i 2006 “Për Planet e Rehabilitimit të Sipërfaqeve të Dëmtuara nga Guroret”.

Qeveria e Shqipërisë. Ligj nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”

Qeveria e Shqipërisë. VKM Nr. 587 datë 07.07. 2010 ” Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”

Rrjeti i Programeve të Zhvillimit të Gjellbërimit Rajonal (2006), Manual për VSM për politikën e kohezionit 2007-2013.

Stanilov, K. (ed.) (2007) *Qyteti Post-Socialist. Forma dhe Hapësira Urbane, Transformimet në Evropën Qendrore dhe Lindore pas Socializmit*, Dordrecht: Springer

UN-Habitat (2009). Njëzet vjet Tranzicion: Evolucioni i Planifikimit Urban në Evropën Lindore dhe Qendrore dhe në ish-Bashkimin; 1989-2009, Vendbanimet Njerëzore Global Dialogu Series, Nr.5, Nairobi: UN Habitat Publications.

Zbatimi i Direktivës 2001/42 mbi Vlerësimin e Efekteve të Planeve të Caktuara dhe Programeve për Mjedisin, Komisioni Evropian, DG i Mjedisit.

Projekti "Ndërtimi i kapaciteteve për zbatimin e kuadrit kombëtar të biosigurisë", mbështetur nga (UNEP-GEF) Maj 2011- Qershor 2015

Projekti "Rishikimi dhe Përditësimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për biodiversitetin (2011-2020)

Projekti IPA 2013 për fillimin e procesit Natura 2000.

Konventa "Për ruajtjen e jetës së egër dhe të habitateve natyrore Evropiane" (konventa e Bernës) e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8294, datë 2.3.1998 "Për ratifikimin e Konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (konventa e Bernës)"

Strategjia 2020 e Evropës Jug-Lindore – Punësimi dhe prosperiteti në një këndvështrim Evropian (BE/ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal)